**Komuna e Gjilanit**

Opstina Gnjilane – Municipality of Gjilan

*Komuna – Opstina – Municipality*

Zyra e Kryetarit

# 1 VIT QEVERISJE

1 VIT TRANSPARENCË, PROFESIONALIZËM, LLOGARIDHËNIE

# 4. Hyrje

Ky raport paraqet punën 1-vjeçare të Komunës së Gjilanit, gjatë periudhës Janar – Dhjetor të vitit 2022.

Raporti fillon me fjalën e Kryetarit të Komunës, Alban Hyseni për të vazhduar me raportin e Drejtorive, Zyreve dhe Njësive komunale.

## 5. Përmbajtja

Hyrje 2
Përmbajtja 2
I. 1
II. 4
III. 12
IV. 18
V. 26
VI. 34
VII. 37
VIII. 41
IX. 44
X. 48
XI. 55
XII. 65
XIII. 72
Zyret dhe Njësitë 99
I. 82
II. 84
III. 86
IV. 87
**V.** 90
VI. 94
VII. 94
VIII. 95

IX. 96
**X.** 101



# I. Fjala e Kryetarit të Komunës së Gjilanit

Të dashur qytetarë,

Raporti 1 vjeçar i punës në drejtimin e institucioneve lokale, përmban gjetjet dhe angazhimin tonë drejt përmbushjes së zotimeve dhe objektivave qeverisëse.

Po bëhet një vit, nga kur morëm detyrën për të drejtuar institucionet lokale.
Viti ishte i mbushur me aktivitete, punë e projekte për sigurimin e kushteve më cilësore për jetë në Komunën tonë.

1. Në "Arbëri" filloi ndërtimi i Qendrës së Re të Mjekësisë Familjare me sipërfaqe 373 m2 dhe 8 dhoma kontrolli. Aty do t'i shtojmë shërbimet për pacientë, duke filluar me shërbimin stomatologjik, rëntgenin dhe shërbime tjera. Projekti ka vlerë - 340 000 €
2. Duke i përmbushur zotimet tona për edukimin e hershëm, në Miresh nisëm ndërtimin e Çerdhes së Re. Rreth 300.000€ (297 070.535 €) është vlera e projektit dhe financimin e bën Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
   - Çerdhe e re edhe në Miresh për më shumë përfshirje në arsimin dhe edukimin para fillor.
   - Çerdhja në Zhegër në prag të funksionalizimit.
   - Po punohet edhe në çerdhen në lagjen "Arbëria".

Katër çerdhe shtohen në Komunën tonë, dy në qytet dhe dy në fshatrat: Zhegër dhe Miresh.
3. Në Shkollën e Mesme Profesionale Teknike dhe Shkollën Fillore Rexhep Elmazi janë realizuar punime në:
   - Fasadimin dhe izolimin e jashtëm,
   - Rregullimin e kulmit
   - Rregullimin e nyjeve sanitare dhe dyshemeve të klasave
   - Është bërë instalimi i ri i sistemit të ngrohjes.
4. Kemi shtuar numrin e laboratorëve të shkencave: fizikë, kimi dhe biologji. Në vlerë rreth 30,000 € kemi siguruar pajisjet për laborator të teknologjisë në shkollën profesionale Teknike "Mehmet Isai". Këto pajisje moderne të dirigjimit për makina kompjuterike CNC të pranuara si donacion, sigurojnë mundësi më të mëdha për nxënësit, për realizimin e projekteve inovative dhe zhvillim profesional e avancimin në fushën teknologjisë.
5. Tri dhoma burimore në tri shkollat " Selami Hallaqi" dhe "Musa Zajmi " në Gjilan dhe në shkollën "Skënderbeu" në Përlepnicë, për stimulimin dhe zhvillimin e fëmijëve me nevoja të veçanta.
6. Janë trajtuar 32,066 m2 gjatësi rrugë, në kuadër të mirëmbajtjes verore të rrugëve në Dardani.
7. Në gjatësi 53, 655 m2 kemi ndërtuar rrugë me standarde. Si në lagje të qytetit: rruga "15 Qershori", "Arbëri", po ashtu edhe në fshatrat Llashticë, Demiraj, Nasalë, Haxhaj.
8. 3520m është gjatësia sistemit të rrjetit të kanalizimit fekal, që kemi shtrirë në qytet dhe fshatra
9. Kemi funksionalizuar sistemin e ujësjellësit në fshatin Verbicë të Kmetocit duke siguruar ujin e pijshme për banorët.
10. Kemi shtrirë rrjetin e ndriçimit publik në disa lokalitete:
   - "Tregu i veturave", në fshatin Përlepnicë;
   - "Tregu i gjelbërt"
   - Largimi i mbeturinave në qendër (teK përmendorja Mulla Idrizi);
   - Lagja Iliria;
   - Liqeni i Livoçit;
   - Deponia në fshatin e Zhegër (livadhet e verdha).

11. Palestrën në Zhegër po e bëjmë në mandatin tonë të parë.
Projekti i nisur në vitin 2016  ka mbetur në fazën fillestare të punimeve për 5 vite rresht. Dinamika e shpejtuar e punës, bënë që ky projekt të përfundoj shumë shpejtë.
12. Fushat ndihmëse të futbollit po i funksionalizojmë.
Fusha afër palestrës është funksionalizuar, po punojmë në ndërtimin e fushës në “Zabel”.
Mbështetjen për sportin e kemi rritur për 40.000 €.
13. Bursat për studentë i kemi dyfishuar për këtë vit.
Nga 60.000€ sa ishin të planifikuara e rritëm në 150.000€. Fondin për bursa për studentë.
14. Subvencionet në Bujqësi i rritëm për 50.000€.
Bujqit dhe fermerët i ndihmuam me :
- Farë gruri
- Farë misri

Për vitin 2023 kemi në planifikim edhe subvencionimin me mekanizëm bujqësor.
15. Tregun e kemi funksionalizuar me Infrastrukturë të kompletuar dhe veprimtari të shtuara. Kemi rritur numrin e hapësirave duke i harmonizuar ato me nevojat e tregtarëve. Kushte më të mira për tregtarë.
16. Rritëm pagat e 205 punëtorëve të mirëmbajtjes dhe sigurimit të Objekteve Komunale, të shëndetësisë dhe Arsimit. Trajtim të dinjitetshëm për punëtorë, shërbime më të mira dhe kursime mbi 200.000€ për buxhetin e Komunës.
17. Rritja e të hyrave – planifikimi i të hyrave për këtë vit ishte 2 milion e 199 mijë e 454 €, ndërsa vetëm për nëntë muaj kemi realizuar  inkasimin e 1 milion e 993 mijë e 475 €, shprehur në përqindje – 91% . Apo krahasuar me vitin paraprak 7. 34% më shumë.
18. Kursimet në komunë janë në shifra të larta, ndërsa projektet në realizim në numër dhe cilësi si asnjëherë më parë.
Po punojmë për:
Infrastrukturë më të mirë në çdo lokalitet, lagje e fshat të komunës.
Kushte më të mira për arsim më cilësor dhe transparencë në procese të rekrutimit.
Objekte të reja, restaurim të atyre ekzistuese dhe riorganizim e shërbime cilësore në shëndetësi.
Këto ishin vetëm disa nga projektet e shumta.

Alban Hyseni



Kryetar i Komunës së Gjilanit

# Drejtoria për Administratë të Përgjithshme

## II. Drejtoria për Administratë të Përgjithshme

### Sektori i Gjendjes Civile

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme (DAP), bazuar në Planin e Punës për vitin 2022, objektiv kryesor ka mbarëvajtjen dhe zhvillimin e administratës publike komunale, përmes reformimit të sistemit administrativ, me qëllim që qytetarëve t'iu ofrohet qasje e barabartë në shërbime administrative.

Në kuadër të DAP-it, funksionon Sektori i Gjendjes Civile, Qendra për Shërbime me Qytetarë, Shërbimi i Autoparku dhe Shërbimi i TI-së.

### Dokumentet e gjendjes civile

Gjatë kësaj periudhe të raportimit, kemi lëshuar gjithsej: 94,803 dokumente të gjendjes civile, respektivisht 52417 dokumente të gjendjes civile për përdorim të jashtëm dhe 42,386 dokumente të gjendjes civile për përdorim të brendshëm.

Bashkangjitur tabelat me listën e dokumenteve të lëshuara:

| Dokumentet e lëshuara nga Sektori i Gjendjes Civile | |
|---|---|
| Data prej | Data deri |
| 01.01.2022 | 30.09.2022 |
| Lloji i dokumentit: | |
| Ekstrakt lindje | 28576 |
| Certifikatë lindje | 1824 |
| Certifikatë martese | 4346 |
| Certifikatë vdekje | 2268 |
| Certifikatë vendbanimi | 1030 |
| Certifikatë të bashkësisë familjare | 2004 |
| Certifikatë të gjendje martesore | 1081 |
| Certifikatë shtetësie | 447 |
| Vërtetim nga Arkivi | **1509** |
| Totali | 2,593 |

### Veprimet/Procedurat e zhvilluara administrative

Ashtu siç është e paraparë me legjislacionin në fuqi, në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, zhvillohen procedura të caktuara administrative.

Bashkangjitur tabela me llojet e dokumenteve/procedurave të zhvilluara:

| Veprimet/Procedurat e zhvilluara administrative | |
|---|---|
| Data prej | Data deri |
| 01.01.2022 | 30.09.2022 |
| Lloji i dokumentit : | |
| Martesat e rregullta dhe jashtë vendit | 453 |
| Rishkrim martese brenda dhe jashtë vendit | 209 |
| Shkurorëzime | 25 |
| Martesa me element të huaj | 119 |
| Vdekjet e rregullta, brenda dhe jashtë vendit | 303 |
| Vdekje të regjistruara me vonesë, brenda dhe jashtë vendit | 40 |
| Lindje të rregullta, brenda dhe jashtë vendit | 814 |
| Lindje të regjistruara me vonesë, brenda dhe jashtë vendit | 109 |
| Verifikime me numër personal paraprak | 353 |
| Rishkrime të lindjes | 111 |
| Regjistrim i qytetarit me vendim të komisionit për shtetësi, me nenin 31, me dekret të Presidentit dhe me nenin 32 | 56 |

| Totali | 2,592 |
| --- | --- |

## Qendra për Shërbime me Qytetarë (QSHQ)

Në kuadër të QSHQ-së në vazhdimësi janë pranuar kërkesat e qytetarëve të cilat janë përcjell në Drejtoritë përkatëse, si dhe pas marrjes së përgjigjeve për lëndët e shqyrtuara nga Drejtoritë, janë njoftuar qytetarët përmes SMS-ave.

Gjatë periudhës nga dt. 01.01.2022, e deri më datë: 17.06.2022, janë pranuar: 69,176 lëndë, prej të cilave: 63,982 janë miratuar, ndërkaq 5,194 lëndë janë në proces, respektivisht janë kryer 92.5% e lëndëve.

Tabela me specifikacionet e trajtimit të lëndëve, sipas organeve përkatëse komunale:

**Raporti sipas departamenteve dhe statusit te zgjidhjes:**

| Pershkrimi | Pranuar | Ne Proces | Miratuar | Refuzuar | Hedhur Poshte | Pezulluar | Ceduar | Anuluar | Perfunduar | Totali |
| --- | --- | --- | --- | --- | --- | --- | --- | --- | --- | --- |
| Drejtoria e Administratës së Përgjithshme | 12 | 5 | 3,870 | 1 | 0 | 0 | 0 | 3 | 37,802 | 41,693 |
| Drejtoria për Arsim | 3 | 772 | 589 | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1,367 |
| Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë | 2 | 243 | 7,922 | 14 | 0 | 1 | 0 | 6 | 0 | 8,188 |
| Drejtoria e Buxhetit dhe Financave | 0 | 69 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 70 |
| Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim | 1 | 2 | 48 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 52 |
| Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit | 2 | 204 | 234 | 4 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 444 |
| Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim | 5 | 193 | 9,811 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4 | 0 | 10,013 |
| Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale | 2 | 59 | 1,529 | 231 | 1 | 0 | 0 | 3 | 0 | 1,825 |
| Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë | 0 | 0 | 1,695 | 50 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1,745 |
| Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | 0 | 5 | 11 | 4 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 20 |
| Kuvendi i Komunës | 0 | 63 | 15 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 78 |
| Kryetari i Komunës | 8 | 2,576 | 167 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4 | 0 | 2,755 |
| Drejtoria e Inspeksionit | 2 | 25 | 426 | 4 | 1 | 0 | 0 | 6 | 0 | 464 |
| Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport | 0 | 359 | 54 | 49 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 462 |

| Gjithsej | 37 | 4,575 | 26,371 | 360 | 3 | 1 | 0 | 27 | 37,802 | 69,176 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|

## Shërbimi i Autoparkut

Autoparku funksionon në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme dhe në kuadër të tij ka udhëheqësin dhe katër (4) vozitës.

Automjetet zyrtare të Komunës, janë duke u përdorur në përputhje me procedurat e parapara dhe në shërbim të kryerjes së detyrave zyrtare.
Tabela në vijim, pasqyron gjendjen e kilometrave të kaluara, për periudhën raportuese, nga muaji Janar deri më dt. 17.06.2022:

| Numri i automjeteve | Kilometrat e kaluara | Sasia e derivateve |
|---|---|---|
| 31 | 152352 | 12963.18 |

Të gjitha automjetet janë shfrytëzuar gjatë orarit të punës, nga ora: 08:00-16:00, me përjashtim të rasteve të kujdestarisë, rasteve emergjente, servisimeve të automjeteve dhe kur është pamundësuar arritja me kohë e zyrtarit për shkak se aktiviteti është kryer jashtë komunës. Edhe në rastet përjashtuese, gjithmonë është njoftuar paraprakisht përgjegjësi i Autoparkut.

Tanimë kemi vendosur edhe sistemin e navigimit, GPS, në të gjitha automjetet e administratës komunale përpos Skuterit.

Gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur aksidente me lëndime apo pasoja në njerëz.

## Shërbimi i TI-së

Në Komunën e Gjilanit janë të angazhuar dy Zyrtarë të Teknologjisë Informative, me bazë në DAP, e që ofrojnë shërbime profesionale në të gjitha institucionet komunale përfshirë: Drejtoritë Komunale, shkollat, çerdhet, ambulancat, QKMF-të etj.

Të gjitha shërbimet jepen në të gjithat institucionet komunale (drejtoritë komunale, shkollat fillore e të mesme, çerdhet, ambulancat, QKMF-të etj.)

Gjatë kësaj periudhe, zyrtarët e TI-së, ndër të tjerash kanë realizuar një vizitë në zyrat e Gjendjes Civile në fshatra, me qëllim të verifikimit të funksionimit të kamerave.

Është instaluar certifikata digjitale në e-kioskë te objekti i DAP-it për komunikim me ARC përmes platformës G2G. Po ashtu, është realizuar vizitë në katër e-kiosqe për konstatim të nevojave për ri-funksionalizim të tyre si dhe raportim.

Janë rregulluar kamerat e sigurimit në Zyrën e Kryetarit dhe Bibliotekën e Qytetit.

Është përgatitur specifikimi teknik për inicimin e procedurës së prokurimit për pajisjen e automjeteve të Komunës me sistemin GPS.

Janë aktivizuar për punë kompjuterë të rinj (formatim, konfigurim, instalim i printerëve dhe fotokopjuesve) dhe janë riaktivizuar disa kompjuterë të vjetër.

Asistim zyrtarëve në largimin e defekteve të ndryshme në printerët dhe fotokopjuesit (largimi i letrës së bllokuar/shqyer, ndërrimi i tonerëve dhe DRUM, konfigurimi i madhësisë së shtypit, pastrimi i waste, etj.).

Asistim teknikut të OE-së që bën mirëmbajtjen e printerëve dhe fotokopjuesve, si dhe menaxhim i kontratës për shfrytëzimin e fotokopjuesve dhe printerëve.

Asistim në mirëmbajtjen e web-faqes zyrtare komunale (dhënie e instruksioneve dhe këshillave, përditësimi i linqeve, ngarkimi i raporteve dhe dokumenteve të ndryshme etj.).

Asistimi në shfrytëzimin e sistemit të Intranet-it si dhe hapja e llogarive të reja.

Asistim në shfrytëzimin e versionit të ri të sistemit të intranetit si dhe rregullimi i roleve/qasjeve në sistem. Rregullimi i UNIREF-eve si dhe kodeve ekonomike për faturimet përmes Intranetit.

Përkrahje teknike për transmetim live të mbledhjes së kuvendit.

Riparimi i defekteve të natyrave të ndryshme (kabllot e ndryshme, kabllimet e rrjetit dhe telefonisë, telefonat lokal në centralet nëpër drejtoritë, instalime dhe konfigurime të driver-ëve dhe programeve të ndryshëm etj.) mirëmbajtja e rrjetit qeveritar si dhe linqeve mikrovalore.

Kontaktet e rregullta me ASHI, Telkos dhe PTK mbi mirëmbajtjen dhe lidhjet e reja të rrjetit qeveritar, internetit dhe telefonisë fikse.

Krijimi i qasjes në rrjet për auditorët gjeneral. Rregullimi i raporteve për auditorin gjeneral.

Asistim auditorit të brendshëm për auditimin e DAP si dhe ndihmë në raportet e Excel.

Ndihmë zyrtarëve gjatë shfrytëzimit të Excel dhe Word – formulat, tabelat, logot, fotografitë etj.

Pjesëmarrje në grupin punues për plotësimin e formularit të vetëvlerësimit të Komunës.

Riaktivizimi i Inverter në server room – montimi i akumulatorëve të ri.

Asistim në mirëmbajtjen e ueb faqes zyrtare komunale (dhënie e instruksioneve dhe këshillave, përditësimi i linqeve, ngarkimi i raporteve dhe dokumenteve të ndryshme etj.).

Asistimi në shfrytëzimin e sistemit të intranet-it si dhe hapja e llogarive të reja.

Asistim në shfrytëzimin e versionit të ri të sistemit të intranetit si dhe rregullimi i roleve/qasjeve në sistem. Rregullimi i UNIREF-eve si dhe kodeve ekonomike për faturimet përmes Intranetit.

Riparimi i defekteve të natyrave të ndryshme (kabllot e ndryshme, kabllimet e rrjetit dhe telefonisë, telefonat lokal në centralet nëpër drejtoritë, instalime dhe konfigurime të driver-ëve dhe programeve të ndryshëm etj.), mirëmbajtja e rrjetit qeveritar si dhe linqeve mikrovalore. Ri-funksionalizimi i aparateve telefonike VoIP (update i firmware).

Kabllimet e reja të rrjetit tek kompjuterët ekzistues dhe printerët-fotokopjuesit.

Kontaktet e rregullta me ASHI, Telkos dhe PTK mbi mirëmbajtjen dhe lidhjet e reja të rrjetit qeveritarë, internetit dhe telefonisë fikse.

Asistim për kyçje të AKI-së në rrjet qeveritar.

Funksionalizimi i rrjetit dhe të gjitha pajisjeve teknologjike përcjellëse në objektin e ri të QKMF.
Funksionalizimi i rrjetit dhe të gjitha pajisjeve teknologjike përcjellëse në lokacionin e ri (konvikti i qytetit) të Drejtorisë së Arsimit.

Ri-funksionalizimi (në rrjetin qeveritar) i platformës digjitale rpa.rks-gov.net

## Të hyrat dhe shpenzimet

Në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, funksionon Zyra e Financave, e cila kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë financiare sipas rregullave juridike të aplikueshme.

Realizimi i të hyrave vetanake për periudhën raportuese është: 142,705.40 Euro.

Shpenzimet arrijnë lartësinë prej: 378,983.66 Euro gjithsej, respektivisht për mallra dhe shërbime: 308,727.97 Euro, për shpenzime komunale: 12,097.80 Euro, si dhe shpenzime kapitale: 58,157.89 Euro.

## Aktivitete të tjera

Kemi vizituar të katër E-Kioskat në Komunën e Gjilanit dhe është konstatuar se që të gjitha prej tyre janë jo-funksionale për shkaqe nga më të ndryshmet. Me qëllim të ri funksionalizimit të këtyre pajisjeve, kemi përgatitur dokumentacionin për inicimin e procedurës së prokurimit për mirëmbajtje të E-Kioskave, si dhe procedurave përkatëse për investim në pjesë të pajisjes që është konstatuar se kanë defekte.

Më datën 15.02.2022, kemi finalizuar koordinimin e përgjegjësive institucionale me Spitalin e Përgjithshëm të Gjilanit, me ç’rast të njëjtit kanë marrë përsipër obligimin që fletë statistikat të dorëzohen tek Zyrtarja e Gjendjes Civile në zyrën që funksionon brenda objektit të Spitalit, me qëllim që asnjë fëmijë të mos mbetet i paregjistruar dhe që të evitohet shqiptimi i gjobave ndaj qytetarëve për regjistrimet pas kalimit të afatit ligjor.

Më datën 16.03.2022, brenda Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, kemi vendosur Kutinë e Ankesave, në mënyrë që të kemi qasje direkët në të gjitha vërejtjet, sugjerimet dhe ankesat e qytetarëve dhe që të bashkë qeverisim.

Nga data 25.03.2022, pas kërkesës sonë drejtuar ARC-së, është mundësuar regjistrimi i lindjeve të fëmijëve me njërin prind që nuk posedon pasaportë apo numër identifikues, por që identifikohen me dokumente të tjera relevante.

Më datën 28.03.2022, kemi sjellur në Gjilan dosjet dhe librat e zyrës së gjendjes civile të Kishna Poles, për arsye të sigurisë dhe organizimit më efikas.

Administrata ka punuar me palë nga ora: 8:15-15:30, me pauzë nga ora 12:00-13:00, ndërkaq duke filluar nga dt. 04.04.2022, jemi duke punuar pandërprerë dhe pa pauzë nga ora: 08:00  deri në ora: 16:00.

Pas pranimit të rekomandimit nga Agjencioni për Regjistrim Civil (ARC), që funksionon në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, jemi në fazën e rishikimit funksional të zyrave të gjendjes civile në fshatra, me ç ‘rast tanimë kemi realizuar takime konsultative me përfaqësuesit e fshatit Kishna Pole, Llashticë dhe Shurdhan.

Në fillim të muajit Maj kemi filluar procesin e digjitalizimit të Arkivit, me zero kosto për Komunën - përmes mbështetjes së donatorëve, si dhe angazhimit të zyrtarëve të drejtorisë.

Më datën 14.06.2022, kemi mbajtur konsultim publik lidhur me Planin e Transparencës Komunale 2022-2026, plan i cili është aprovuar me shumicë votash nga Kuvendi Komunal i Gjilanit.

Së bashku me grupin punues, kryesuar nga Drejtoria e Administratës, kemi përgatitur planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe Raportin për zbatimin e këtyre rekomandimeve për pasqyrat financiare për vitin 2021.

Kemi iniciuar procedurën disiplinore ndaj tre zyrtarëve, si dhe kemi shqiptuar vërejtje me shkrim ndaj një zyrtari të Drejtorisë së Administratës.

Më datën 23.08.2022, pas kërkesës sonë, na është mundësuar qasja në rrjetin kompjuterik shtetëror përmes fibrit optik në objektin e administratës, që nënkupton se është krijuar mundësia e dhënies së shërbimeve edhe gjatë kohës së reduktimeve të energjisë elektrike.

# Drejtoria për
# Bujqësi dhe Pylltari

## III. Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari

Nga fillimi i muaji shkurt së bashku me zyrtarët e drejtorisë në dy sektorët e bujqësisë dhe pylltarisë jemi angazhuar për skanimin e gjendjes në drejtori, kompletimin dhe implementimin e projekteve të parapara për vitin 2022.
Stafi i pa kompletuar, mungesa e zyrtarit ligjor e zyrtarit financiar të cilët kanë probleme shëndetësore, pozita e lirë e zyrtarit për prodhimtari blegtorale si dhe mungesa e hapësirës brenda objektit për zyrtarët e drejtorisë, por edhe frekuentimi i fermerëve të gjitha profileve e sidomos kur të aplikojnë për subvencione e grande bëhet tollovi e madhe, ne ja kemi dalë të kryejmë të gjitha detyrat me përgjegjësi.

Të gjithë fermerët njoftohen përmes ftesave publike për skemën e subvencioneve dhe granteve si për drejtori po edhe për MBPZHR. Katër zyrtarë nga drejtoria janë trajnuar në ministri për digjitalizimin e parcelave duke punuar në kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për aplikim të fermerëve për subvencione për programin e pagesa direkt nga MBPZHR për vitin 2022.

Kemi shqyrtuar ankesat e qytetarëve nga qentë endacak, sepse që nga viti 2019 nga ish qeverisja nuk ka pas të planifikuar buxhet për trajtimin e tyre, është rritur numri i qenve dhe rreziku nga kafshimi i tyre është evident e sidomos fëmijëve në lagje, por edhe në çerdhe e shkollë.

Ne si drejtori kemi marrë hapa konkret dhe kemi dorëzuar në Zyrën e Kryetarit projektin dhe inicimin e procedurave për trajtimin e qenve endacak me datë 02.02.2022.

Për shkak te gjendjes jo të mirë financiare që është përballur Komuna e Gjilanit, me përkrahjen e kryetarit të Komunës dhe drejtorive tjera, kemi siguruar mjete për trajtimin e 250 qenve, e cila ka filluar të implementohet nga muaji Korrik nga operatori i cili ka fituar tenderin.

Projekti do të realizohet duke ndërmarrë të gjitha aktivitetet sipas kontratës: kapja, transportimi, trajtim dhe kujdes, identifikim dhe regjistrim, kastrim/sterilizim, vaksinim dhe dehelmetizim si dhe kthimi në vendin e kapjes.

Vizitat në terren tek fermerët të cilët merren me kulturën e fidanëve të llojeve të ndryshme dhe ngritjen e tyre, blegtore, pemishte etje. Agronomët në kuadër të drejtorisë ju ofrojnë mbështetje të vazhdueshme për çdo kërkesë të tyre.
Planifikimi për vitin 2022 për drejtorin e bujqësisë dhe pylltarisë për paga kemi 144,865 euro, mallra dhe shërbime 20,000 euro shpenzime komunale 5,000 euro, subvencione 190,000 euro, shpenzime kapitale 30,000 euro në total buxheti për vitin 2022 është 389,865 euro.

Të gjitha planifikimet në periudhën Janar – Shtator 2022 janë kryer në afatin e duhur, nuk kem pasur as një vërejtje e reagim të fermerëve.

1. Fidane të arrës - kanë aplikuar 46 fermer për 15 ha për 3570 fidanë, janë përzgjedhur nga komisioni 20 fermer nga 0.40 deri 1 ha. Vlera financiare 13,600 euro (e realizuar);
2. Furnizimi me farë misri, të gjithë fermerët e komunës së Gjilanit të cilët janë kultivues të rregullt dhe mbjellin më pakë se 1 ha. Është kontraktuar blerja e 1000 paketimeve me farë misri ku do të mbillen afër 500 ha të cilët kanë pas vlerën financiare 23,600 euro. Përfitues janë 465 fermer (e realizuar);
3. Kanë përfunduar procedurat e prokurimit “Trajtimi i qeneve endacak’’, fituesi i tenderit do të nënshkruaj kontratën me zyrën e prokurimit;
4. Inicimi i procedurave për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me shtëpiza për bletë tre katërshe” në procese;
5. Data bazën e të dhënave për sektorin e bujqësisë ju kemi dërguar (e realizuar);
6. Shpërndarja e gjashtë gjedhëve të racës ‘’Simental’’ për gjashtë fermer, të cilët janë donacion nga shkolla e mesme e Agrobiznesit ( e realizuar) ;
7. Shtatëqind e nëntëdhjetë e dy fermerë(792) nga komuna e Gjilanit kanë aplikuar në drejtorin e bujqësisë dhe pylltarisë për programin e pagesave Direkte / Subvencioneve 2022 në MBPZHR (e realizuar)

Vizita e ministrit të bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimi rural, Faton Peci në Gjilan.

Vullneti dhe përkushtimi i përbashkët me Ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Faton Peci, po i sjell Gjilanit një bashkëpunim konkret në sektorin e bujqësisë dhe turizmit.
Në takimin informues, Ministrin e njoftova me prioritetet dhe projektet që tashmë i kemi identifikuar pas analizave në terren, e të cilat kërkojnë mbështetje.

U koordinuam për bashkëpunim ndër-institucional për monitorim dhe kontrollim në terren gjatë implementimit të programeve mbështetëse të kësaj ministrie; Programit për Pagesa Direkte dhe Programit për Zhvillim Rural; ashtu që procesi i përfitimit për bujqit e fermerët tanë të jetë sa më transparent.

Diskutuam gjithashtu për fushën e agroturizmit, veprimet specifike që duhet ndërmarrë, si dhe potencialin që Gjilani ka për zhvillimin e tij.

Si përfundim, ram dakord për konkretizimin e këtij bashkëpunimi përmes një memorandumi mirëkuptimi, për krijimin e kushteve të volitshme e cilësore për prodhuesit dhe përpunuesit e produkteve bujqësore.

Fushata e korrje-shirjeve në Gjilan filloi me 10 korrik.

Me vendim të Kryetarit z. Alban Hyseni, është formuar komisioni për të përcjellë dhe monitoruar fushatën e korrje-shirjeve për këtë vit në komunën e Gjilanit. Komisioni ka për detyrë të koordinojë punën në mes të fermerëve kultivues të grurit, qendrave grumbulluese të grurit dhe pronarëve të autokombajnave e po ashtu në baza javore në Ministrinë e BPZHR-së.

Fermerët që dorëzojnë grurin në Silose dhe qendra grumbulluese duhet të pajisen me dëshmi mbi sasinë e dorëzuar të grurit, në mënyrë që të përfitojnë nga programi për pagesa direkte, ku këtë vit 1 kg grurë do të subvencionohet 0.03 euro.

Komuna ka bërë përgatitjet e nevojshme për përcjelljen dhe monitorimin e korrje-shirjeve duke formuar kështu komisionin i cili ka për detyrë koordinimin në mes të fermerëve kultivues të grurit, qendrave grumbulluese të grurit dhe pronarëve të autokombajnave; dhe po ashtu në baza javore me Ministrinë e BPZHR-së.

Fermerët që dorëzojnë grurin në Silose dhe qendra grumbulluese duhet të pajisen me dëshmi mbi sasinë e dorëzuar të grurit, në mënyrë që të përfitojnë nga programi për pagesa direkte, ku këtë vit 1 kg grurë do të subvencionohet 0.03 €.

Kemi organizuar sesion informues për fermerët për të aplikuar për grantet e sivjetme në kuadër të programit për zhvillim rural të organizuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Rritja e mbështetjes financiare për fermerë përmes Programit për Pagesa Direkte – Subvencioneve 2022, ka bërë që kjo rritje të reflektojë edhe në rritjen e sipërfaqeve të mbjellura me misër.

Në këtë vit në gjithë territorin e Republikës së Kosovës janë mbjellë 36,901 ha me misër, apo mbi 17 mijë hektarë më shumë se viteve të kaluara. Shprehur në përqindje, kemi një rritje të sipërfaqeve me misër me 91%.

Nga 150 euro për hektarë, këtë vit kultura e misrit, subvencionohet me 329 euro apo 119% më shumë. Përpos kësaj, në mënyrë që t'ua lehtësojmë bujqve barrën e shkaktuar nga rritja e çmimeve, për herë të parë, subvencionojmë naftën në vlerë prej 54 euro/ha dhe plehërimin pranveror për kulturën e misrit prej 100 e/ha.

Po ashtu, këtë vit, procedurat për aplikim kanë qenë tërësisht të thjeshtuara dhe aplikimi ka zgjatur më pak se 30 minuta.
Kontrolla administrative e lëndëve të aplikuarve është në finalizim, ndërsa po vazhdon super-kontrolli në terren.
Mbështetje konkrete dhe efikasitet.

Gjilani shpërndanë 300 shtëpiza të bletëve për 54 bletarë

Kemi shpërndarë 300 shtëpiza të bletëve për 54 bletarë.

Kemi organizuar dy dëgjime publike për bujqësinë.

Fillon vjelja e mollëve në pemishtet e Kravaricës.

Komuna e Gjilanit ka fermerë e pemtarë të mrekullueshëm, ne duhet të angazhohemi që t'u japim përkrahje vazhdueshëm, në mënyrë që të zhvillohet bujqësia edhe më tutje në komunën tonë.

## Sektori i Pylltarisë

Nga raportet mujore në sektorin e pylltarisë të hyrat dhe derdhja e mjeteve në buxhet:
Nga taksat për shitjen e masës drunore në këmbë për muajin Qershor janë: 14.047.86 €
Për periudhën Janar – Qershor janë: 42.182.85 €
Taksat nga shërbimet nga pyjet private për muajin Qershor janë: 4.239.74 €
Për periudhën Janar - Qershor të hyrat janë: 11.144.01€
Taksat për verifikimin e masës drunore në pyjet private në total: 94.20€
Totali nga këto të hyra vetëm për muajin Qershor: 18.287.00€
Totali nga këto të hyra për periudhën Janar – Qershor: 53.421.06€

| Data | Operatori | Kodi | Nr.serik | Shuma |
|---|---|---|---|---|
| 23.06.2022 | SH.P.K "MALI SH.1 " | 50214 | 003329 | 5.076.00 € |
| 23.06.2022 | SH.P.K "MALI SH.1 " | 50214 | 003329 | 7.479.05 € |

Specifikacioni i konfiskimit të masës drusore Janar – Qershor

| Muaji-viti | Raste | Sasia kon.D.Zjarri | Sasia -Totali | Totali |
|---|---|---|---|---|
| Janar | 0 | 0 | 0 | |
| Shkurt | 1 | 2.25 | 2.25 | |
| Mars | 1 | 2.35 | 2.35 | |
| Prill | 3 | 6.55 | 6.55 | |
| Maj | 8 | 27.95 | 27.95 | |
| Qershor | 4 | 6.55 | 6.55 | |
| TOTAL | 17 | 45.65 m³ | 45.65m³ | 45.65 m³ |

Realizimi për muajin QESHOR

| Emërtimi | Nj.Matëse | Realizimi mujor Qeshor |
|---|---|---|
| Kërkesa shqyrtimi | | 39 |
| Vulosja e druve-dru zjarri | m³ | 1.707.05 |
| Gjithsej Vulosje | m³ | 1.730.05 |
| Fletë dërgesa të dhëna | Copë | 242.00 |
| Fletë dërgesa në m³ | m³ | 1.730.05 |

Pasqyra e Aktgjykimeve për muajin Prill:

| Kundërvajtje | | | |
|---|---|---|---|
| Penale | Kundërvajtje | 34 | 38.63 |
| Totali | Penale | 2 | 7.76 |
| Sasia në m³ | Gjithsej | 36 | 46.39 |

DERDHJA MJETEVE BUGJETORE SHTATOR DHE JANAR-SHTATOR

| Të Hyrat | Shtator | Janar Shtator | Të Hyrat | Shtator |
|---|---|---|---|---|
| Taksa për shitjen e masës drunore në këmbë | 774.00 € | 50.610.85€ | Taksa për shitjen e masës drunore në këmbë | 774.00 € |
| Taksa nga shërbimet pyjet private | 3.826.89 € | 22.698.79€ | Taksa nga shërbimet pyjet private | 3.826.89 € |

Të hyrat nga pyjet private për muajin shtator - 2022 janë 3.826.89€

Në muajin shtator duke u bazuar në përvojat e mëparshme sektori i Pylltarisë ka qëndruar më i përgatitur me kontrolle dhe vizita në terren. Kemi parandaluar shumë raste dhe nga kujdesi i shfaqur nga pylltarët në muajin Shtator nuk është evidentuar asnjë rast i zjarrit.

RAPORTI I FLETËPARAQITJEVE NË MUAJIN SHTATOR

| Lloji i Fletëparaqitjes | Nr. Fletëparaqitje | Vëllimi në m³ | Dëmi në € |
|---|---|---|---|
| **Kundërvajtje** | 35 | 48.83 | 6.341.31 € |
| **Penale** | - | - | |
| **Transport** | 15 | 26.55 | 3.551.40 € |
| | 50 | 75.38 | 9.892.71 € |

Rritja e madhe e qimeve të lëndëve djegëse ndikoi që pyjet tona të pësojnë sulme të shumta nga prerësit ilegal. Kjo ndikoi që sektori Pylltarisë të mobilizohet dhe me datën 06.09.2022 Sektori Pylltarisë në bashkëpunim me policinë e shtetit organizon një aksion 4 javor me qëllim të parandalimit të prerjes ilegale të pyjeve. Në aksion për parandalimin e prerjes ilegale nga ana sektorit të pylltarisë është formuar një taks forcë e cila ka vepruar 24.00 h në tërë regjionin e Gjilanit.

Veprimi i përbashkët ka qenë i koordinuar në atë mënyrë që një polic ka vepruar në polici(në bazë, zyre) dhe dy policë kanë qenë së bashku me dy pjesëtarë të Sektorit të policisë në terren. Me këtë veprim janë koordinuar në çdo kohë me qendrën e policisë dhe sektorin e Pylltarisë, nëse ka pas nevojë për asistencë plotësuese, përforcime në rast nevoje. Koha e veprimit ka qenë e koordinuar sipas nevojës në terren para dite dhe pasdite deri në ora 24.00 h. por në disa raste është vepruar edhe në orët e hershme të mëngjesit.

Fushëveprimi ka qenë i koordinuar në këto zona:

| **Karadaku II** | **quajtur.Meqav** |
|---|---|
| **Karadaku II** | v.quajtur Pod |
| **Zhegoc** | vq.Durull |
| **Zhegoc** | v.quajtur. Ponesh |
| **Karadak** | v.quajtur. Qupur |
| **Kardak** | v.quajtur.Dafina gurzin |
| **Zhegoc** | v.quajtur.Durullan |
| **Karadaku.II** | vq.shk.Bukovik |
| **Karadaku II** | Skolla .Bukovik |
| **Zhegoc** | v.quajtur. palev-Ponesh |
| **Zhegoc** | v.quajtur.Mallapadina |
| **Zhegoc** | v.q.rezja Ajvazvë |
| **Zhegoc** | v.q.rezja Ajvazvë |
| **Karadaku II** | v.quajtur.Meqav |
| **Karadaku II** | v.quajtur Pod |

**Përveç këtyre zonave aksioni është shtrirë edhe në zonën brenda qytetit nëpër lagje. Një numër i prerësve dhe shitësve ilegal shfrytëzojnë rrugët alternative në lagjet e Gjilanit për të depërtuar sa më afër blerësve.**

Vendosja e punkteve kontrolluese në rrugë magjistrale:

**Me qëllim të kontrollimit të automjeteve transportuese të cilat bartin masën drunore janë vendosur 8 pika kontrolluese në rrugët magjistrale për kontrollin e lejeve të lëshuara nga AP. Gjatë këtyre kontrolleve është vërejtur se një numër I madh I transportuesve posedonin leje adekuate për transportin e druve nga Komuna e Kamenicës për Gjilan.**

**Gjatë muajit Janar- Shtator të vitit 2022 -Sektori Pylltarisë ka proceduar**

- **210 fletëparaqitje për Kundërvajtje**
- **16 fletëparaqitje penale në total 226.**

**Prerësit ilegal kanë shkaktuar dëm në sasi drunore prej 323.57 m³ ose në vlerë prej 56.050.79 €**

**Prerësit ilegal të pyjeve nuk zgjedhin mënyra dhe metoda për prerjen dhe transportimin e masës drunore, gjatë kontrollit kemi hasur prerës ilegal të cilët prejnë masën drunore në sasi më të vogla nga 1. metër hapësinor dhe bartin me anë të kafshëve dhe automjete private.**

**Gjatë aksionit të ndërmarrë nga ana e Sektorit të Pylltarisë me asistencë të Policisë është konfiskuar një sasi e konsiderueshme e druve të cilat janë dërguar në depon e Pylltarisë në fshatin Zhegër viza vijë me policinë. Masa drunore e cila pas konfiskimit kalon në pronë të K.K Gjilanit.**

**Aksioni me policinë e Kosovës është treguar mjaftë i suksesshëm për shumë arsye:**

- **Krijimi i pasigurisë te prerësit e pyjeve**
- **Krijimi disiplinës tek rojet e pyjeve duke marrë parasysh se do të monitorohen pa orare**
- **Kontrollet në rrugët magjistrale (punktet ) tregon përkushtimin e dy organeve për vendosjen e rendit**
- **Shqiptimi dhe inicimi procedurave për kundërvajtje**
- **Inicimi procedurave penale**
- **Konfiskimi druve dhe mjeteve transportuese**

**Këto fakte kanë ndikuar që për një vit të kemi mbi 430 kërkesa për prerjen e pyjeve në pronësi private.**

**Sektori Pylltarisë ka bërë kërkesë në Komiteti për Zhvillim Ekonomik dhe Agrikulturë të bëjë plotësim ndryshimin e Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së Subvencioneve në Bujqësi Nr.2/2018,01.Nr.01628468 të datës 22.03.2018. Neni.20 Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione në bujqësi të futet edhe një paragraf:**

1.11 - Të drejtë aplikimi për grande dhe subvencione kanë personat që në sektorin e Pylltarisë nuk kanë procedura Juridiko-penale, ose kanë shlyer detyrimet juridiko financiare në këtë sektor.

Ky paragraf në Sektorin e Pylltarisë do të ndikonte si masë parandaluese për prerësit ilegal, masë edukative tek prerësit ilegal se ata që dëmtojnë dhe prejnë pyllin si pasuri nacionale e shtetit, nuk munden të përfitojnë grande dhe subvencione nga e njëjta drejtori.

Sektori pylltarisë, ka iniciuar procedura përmbarimore për një pjesë të prerësve ilegal të pyjeve, të cilat lëndë janë të plotfuqishme dhe të njëjtat kanë të shqiptuara dënim të ekzekutueshëm nga Gjykata. Sipas shënimeve tona kemi identifikuar një person që për vitin 2020-21 ka mbi 60 fletëparaqitje të plotfuqishme që vlera e dënimeve arrijnë mbi 20.000.00 €. Jemi në përpilim të inicimit të kallëzimit penal (personi i njëjtë ) për dëmin e shkaktuar vlera e të cilit është mbi 11.000.00 €.

# Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës dhe Banimit

## IV. Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës dhe Banimit

Bazuar në obligimet e drejtorisë dhe kompetencat e saj, Ligjet e Kosovës, Rregulloret dhe Udhëzimet e ndryshime administrative të cilat i përkasin Fushë veprimtarisë së vet, **Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim** konform buxhetit të projektuar - synim të vetin ka pasur arritjen e këtyre objektivave:

- Ngritja e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve;
- Kompletimi dhe harmonizimi i infrastrukturës ligjore nga fushëveprimi i Drejtorisë, me Ligjet dhe Rregulloret në fuqi;
- Realizimin e sa më tepër projekteve me interes për qytetarët dhe Komunën në përgjithësi;
- Mirëmbajtja e projekteve të realizuara që kanë të bëjnë me shërbimet publike - infrastrukturën;
- Identifikimi i problemeve të infrastrukturës në përgjithësi dhe inicimi, ofrimi i zgjidhjeve të mundshme;
- Krijimi i një ambienti më të sigurt dhe më të shëndoshë për qytetarët.

### I. Statusi i lëndëve në procedurë administrative

Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim në procedurë administrative ka shqyrtuar një numër të kërkesave konform legjislacionit të aplikueshëm. Gjatë kësaj periudhe dhe brenda afatit ligjor janë trajtuar:

| Përshkrimi | Nr. |
|---|---|
| Të arritura | 1059 |
| Në proces | 101 |
| Të dalura nga DSHPI-ja | 51 |
| Lëndët e miratuara (nga 01.01.2022 deri 01.12.2022) | 846 |
| **Gjithsej:** | **1,110** |

### II. **Transporti**

Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e transportit brenda territorit të saj duke përfshirë edhe transportin e rregullt të udhëtarëve me taksi dhe me autobus.

| Përshkrimi | Numri |
|---|---|
| Numri i taksistëve legal të cilët janë të pajisur me leje për operim brenda territorit të Komunës së Gjilanit deri më datën 01.12.2022 | 200 |
| Numri i kompanive që operojnë në transportin urbano - periferik (autobus) | 14 |

### III. Të hyrat financiare

Në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Infrastrukturë dhe Banim gjatë kësaj periudhe janë realizuar të hyra financiare në vlerë (shih tabelën 3.3):

| Përshkrimi | Vlera € (euro) |
|---|---|
| **Taksa rrugore, tërheqja e automjeteve, infrastrukturë rrugore, hapësirat publike dhe qiraja** | 124,557.96 € |
| **Qiraja Komunale** | 60,688.46 € |
| **Infrastrukturë rrugore,** | 44,453.31€ |
| **Tërheqja e automjeteve** | 18,825.00 € |
| **GJITHSEJTE** | 335,577.77€ |

**IV.** Shpenzimet ndaj operatorëve për punët e kryera gjatë vitit 2021-22, që janë proceduar për pagesë gjatë periudhës deri më datën 01.12.2022, janë në vlerë prej: 1,892,141.47 Euro.

## V. Tërheqja e automjeteve me Merimangë nga parkingjet ilegale

| Përshkrimi | Numri i automjeteve |
|---|---|
| **Gjatë kësaj periudhe janë tërhequr** | 541 |

## 2. Projektet/Kontratat që kanë vazhduar nga vitet paraprake janë:

Shërbimi i varrimit është kryer konform kontratës dhe pozicioneve të parapara në të. Për 1 vjeçarin e parë kemi paguar: 149,764.00€.

Mirëmbajtja dimërore e rrugëve

Operatori Ekonomik "Avag Group", SH.P.K, Kontratë Pune, me nr. Identifikimi: GL 652-20-5015-5-2, gjatë kësaj periudhe ka mirëmbajtur rrugët në qytet dhe fshatra me pastrimin dhe largimin e borës deri në përfundimin e kontratës 15.04.2022 me vlerë prej 60,000.00 €.

**Mirëmbajtja verore e rrrugëve nr. 651-21-34922**

Operatori ekonomik "El-Bau" SH.p.k Mirëmbatja verore e rrrugëve nr. 651-21-34922, ka bërë rregullimin e ujëmbledhësve, dhe sanimin e gropave nëpër disa rrugë dhe trotuare të qytetit : Rr."Pajazit Ahmeti" (rruga Pireva deri te zalli), rruga Nëna Tereza dhe rruga Medllin Ollbrait", rr. Muharrem Ibrahimi dhe Beqir Musliu, te Kodra e Dëshmorëve rrugët lidhëse ndërmjetë rrugës së Pireva , janë sanuar, rruga "Abdullah Presheva", rruga "Vëllezrit Frashëri" dhe " Fatmir Ibishi",rruga për fshatin Malishevë, rr"Hamdi Kurteshi", rr." Mërgimtarët e Gjilanit", rr. " Ibrahim Pacolli", rr." Nijazi Kryeziu", rr." Naser Azemi", rr." Haki Myderizi", rr."Skenderbeu", rr." Ali Aliu", rr."'Lidhja e Prizrenit", rr." Ibrahim Popovica",rr"Halim Agaj", rr." Alban Ajeti",rr. "Nora Kelmendi", rr."Zija Shemsiu", në të gjitha këto rrugë është intervenuar dhe sanuar, ku prej rrugëve të cukura që janë rrugë kryesore të lagjeve janë sanuar edhe rrugët lidhëse të tyre. Ndërtimi,rregullim i ujëmbledhësëve dhe kanilizimit atmosferik si dhe rregullimi i Trotuarit në rrugën 15 Qershori(nga rrethi i rrugëse së Prishtinës deri te Aroma").

- Rekonstruimi dhe asfaltimi i Rrugës "15 Qershori" vazhdim nga: furra "Aroma" deri te udhëkryqi te "S. Hallaqi" dhe hapja e kanalit e futja e gypit $ /400, dhe vendosja e ujëmbledhsëve për ujrat atmosferik për gjatë gjithë aksit rrugor. Rekonstruimi dhe asfaltimi i 2 rrugëve anësore te rr. "Beqir Musli " te Menakoni (të cilat lidhen me sheshin mbi lumin Mirusha.
- Rekonstruimi dhe asfaltimi i Rrugës "Liman Staneci" ne DARDANI II, në gjatësi: L = 200.
- Asfaltimi rrugës te Tregu i Kafshëve fshatin Velekincë ; L = 32,066 m2 ,
- Asfaltimi i parkingjeve në Tregun e Gjebërt në sipërfaqe prej: L = 7000 m2.

**Mbjellja e drunjëve dekorativ:**

**Gjatë muajit Nëntor për nderë të festës së 28 nëntorit janë mbjellë :**

- **70 drunjë dekorativ në hapësirën përrreth QKMF-së, në Gjilan, rruga "Ibrahim Rugova" donacion nga Banka "Finca" dhe**
- **73 drunjë dekorativ donacion nga shkolla fillore "HELLO" Academy Education , të cilët janë mbjellë në stazën që i ndanë rrugët në rr. "Ibrahim Rugova", Gjilan.**
- **20 drunjë dekorativ donacion nga Let's Do It Kosova, për nder të dites Boterore te Vullnetarizmit (5 Dhjetor 2022), në Rr. "Fehmi Agani" Gjilan,**

**Largimi i deponive ilegale**

- **Te tregu i veturave;**
- **Në fshatin Përlepnicë;**
- **Te tregu i gjelbërt;**
- **Largimi i mbeturinave në qender (te përmendojrja Mulla Idrizi);**
- **Te lagjia Iliri (ish Kamniku);**
- **Te Liqeni i Livoçit;**
- **Deponia në fshatin e Zhegër (livadhet e verdha).**

- **Operatori Eknomik “El Bau” SHPK, me kontratën Punë Publike, kemi ndërtuar kanalizimin fekal me gjatësi L= 820 m’ ne rr. “Daut Haziri” fshatin  Bresalc (sipas kërkesave dhe nevojave të banorëve );**
- **Kanalizimi në rrugën Shyt Maresci L = 400 m;**
- **Gjithashtu është intervenuar ne rr.” Bahrije Bloshmi”**
- **Operatori “ Zuka Commerce“ sh.p.k Kontratë Publike Kornizë, nr. Identifikimit 651-21-4819-5-2-1/C265; Në bazë të përshkrimit të kontratës për shtruarjen me zhavor për rrugët e rendit të tretë, në gjashtë (6) mujorin e parë të jan rregulluar me zhavor këto rrugë**

Kemi bërë rregullimin e ujëmbledhësve dhe sanimin e gropave nëpër disa rrugë dhe trotuare të qytetit, si: Rr. “Pajazit Ahmeti”, Rr. “Nëna Tereza” dhe Rr. “Medllin Ollbrait”, Rr. “Muharrem Ibrahimi” dhe Rr. “Beqir Musliu”, te Kodra e Dëshmorëve rrugët lidhëse ndërmjet rrugës Pireva janë sanuar, Rr. “Abdullah Presheva”, Rr. “Vëllezërit Frashëri” dhe Rr. “Fatmir Ibishi”, rruga për në fshatin Malishevë, Rr. ”Hamdi Kurteshi”, Rr. “Mërgimtarët e Gjilanit”, Rr. “Ibrahim Pacolli”, Rr. “Nijazi Kryeziu”, Rr. “Naser Azemi”, Rr. “Haki Myderizi”, Rr. “Skënderbeu”, Rr. “Ali Aliu”, Rr. “Lidhja e Prizrenit”, Rr. “Ibrahim Popovica”, Rr. “Halim Agaj”, Rr. “Alban Ajeti”, Rr. “Nora Kelmendi” dhe Rr. “Zija Shemsiu”. Po ashtu, jemi duke vazhduar me sanim dhe rregullim të infrastrukturës si trotuarin, ndriçimin në një anë, ujëmbledhësit e rrugës 15 Qershori (nga rrethi i rrugës së Prishtinës deri te shkolla “Selami Hallaqi”).

Kemi ndërtuar kanalizimin fekal me gjatësi L= 820 m, në Rr. “Daut Haziri”, në fshatin  Bresalc, sipas kërkesave dhe nevojave të banorëve.

Gjithashtu është intervenuar në Rr. “Bahrije Bloshmi” (rruga për Prishtinë).

**POZIOCIONET QË JANE PUNUAR NË MIRËMBAJTJEN E RRUGËVE - RENDIT 3  GJILAN (VITI 2022)**

| NR. | Emërtimi i  fshatrave dhe lagjeve | Njësia Matëse | Sasia |
|---|---|---|---|
| 1 | Rruga te Tregu i veturave (L=1200m', b=4.5m) | L= 1200m, b=4.5m | 5,400.00 |
| 2 | Rruga në fshatin Llashticë ( L=150m, b=3.5m), Rruga tek Muzeu i Qytetit | L=150m, b=3.5m , | 525.00 |
| 3 | Rruga në Fshatin Kufcë (L=459m, b=4.5m) | L=459m, b=4.5m | 2,065.50 |
| 4 | Rruga mbrapa stadionit Sansiro (L=340m, b=4m) | L=340m, b=4m | 1,360.00 |
| 5 | Rruga mbrapa stadionit Sansiro (L=420m, b=4.5m) | L=420m,  b=4.5m | 1,890.00 |
| 6 | Rrugica mbrapa stadionit Sansiro (L=120m, b=4m) | L=120m, b=4m | 480.00 |
| 7 | Rruga te Gjykata në Gjilan (L=350m, b=4.5m) | L=350m, b=4.5m | 1,575.00 |
| 8 | Rruga Albanika Gjilan (L=355m, b=5m) | L=355m, b=5m | 1,755.00 |
| 9 | Rr. e Kumanovës 1 (L=250m, b=3.5m) | L=250m,  b=3.5m | 875.00 |
| 10 | Rr. e Kumanovës 2 (L=290m, b=4m) | L=290m,  b=4m | 1,160.00 |
| 11 | Rr. Shyt Marevci, Dheu i Bardhë (L=130m, b=4.5m) | L=130m,  b=4.5m | 585.00 |
| 12 | Rr. Bregu i djegur "N. Azemi" (L=600m, b=4m) | L=600m ,  b=4m | 2,400.00 |
| 13 | Rr. Bregu i djegur "N. Azemi" (L=230m, b=3.5m) | L=230m,  b=3.5m | 805.00 |
| 14 | Rr. Lagjja Vishnjet Gjilan (L=600m, b=5m) (3 rrugica) | L=600m,  b=5m | 3,000.00 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 15 | Rrugicat ne lagjen Vishnjet (3rrugica) | | |
| 17 | Rruga në Fshatin Kufc (L=100m, b=5m) | | 500.00 |
| 18 | Rruga në fshatin Llashticë (L=120m, b=4m) | L=100m, b=5m | 480.00 |
| 19 | Rruga e deponisë në Velekincë (L=200m, b=4m) | L=120m, b=4m | 800.00 |
| 20 | Lagjja "Dheu i Bardhë" (L=280m, b=4m) | L=200m, b=4m | 1,120.00 |
| 21 | Rr. te Kombinati i Duhanit në Gjilan (L=100, b=4m) | L=280m, b=4m | 400.00 |
| 22 | Rruga në fshatin Bresalc (L=600m, b=3.5m) | L=100, b=4m | 2,100.00 |
| 23 | Rr. e vjetër e Kumanovës (L=200m, b=3.5m) | m² | 700.00 |
| 24 | Rruga në Lagjen Poredin (L=300m, b=4m) | m² | 1,200.00 |
| 25 | Rruga në fshatin Kokaj, lagja Kocabaq (L=4000m, b=4m) | m² | 16,000.00 |
| 26 | Rruga në fshatin Zhegër, Livadhet e Verdha (L=1500m, b=4m) | m² | 6,000.00 |
| 27 | Fsh. Zheger-Rr.H.e sporteve deri te guri | L= 1800m, b=4m | 29,736.00 |
| 28 | Fsh. Zheger Rr." Karadakut" | L= 650m, b=4.5m | 4,095.00 |
| 29 | Fsh. Zhegr Rr.Te Shkolla | L= 100m, b=4m | 560.00 |
| 30 | Fsh. Zhegr-Rr. Te Xhamia | L= 120m, b=4.5m | 756.00 |
| 31 | Fsh. Zhegr-Rr. Te ura | L= 100m, b=3.50 | 490.00 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 32 | Eleminimi i deponive të egra Fsh.Zheger | | 2,704.80 |
| 33 | Fsh Capar- Pogragjë (L=826m, b=4m) | L= 826m, b=4m | 13,050.80 |
| 34 | Fsh. Pogragjë te Kalaja- te lumi | | 11,105.20 |
| 35 | Fsh. Kravaricë –Fruto Mania | L= 650m, b=4m | 3,640.00 |
| 36 | Fsh. Bresalc | L= 200m, b=4m | 1,160.00 |
| 37 | Fsh. Bresalc, Rr. E Qazimeve-Te Ambulanta. | L= 800m, b=3m | 5,320.00 |
| 38 | Fsh. Bresalc- lagja e Uruqeve | | 2,034.00 |
| 39 | Fsh. Bresalc- lagja e Uruqeve-Rr. E Qesoviqeve | L= 90m, b=5.5m) | 441.00 |
| 40 | Fsh. Bresalc | L= 85m, b=3.5m | 416.50 |
| 41 | Fsh. Bresalc | L = 90m, b = 3.5m | 441.00 |
| 42 | Fsh.Bresalc-Lagjia e Xhamisë,Rr.Hasan Sefa | L = 100m, b = 4m, | 303.60 |
| 43 | Fsh.Bresalc Rr.Zejnullah Muji- Te rruga Fehmi Haziri | L = 58m, b = 3.4m | 336.00 |
| 44 | Fsh.Bresalc Rruga e Miftareve | L = 80m, b = 3.5m | 2,695.00 |
| 45 | (Te Kodra) | L = 550m, b = 3.5m | 360.00 |
| 46 | Fsh.Bresalc Lagjia Xhamise | L = 100m, b = 3m | 168.00 |
| 47 | Ferma e dhive Avni Syla | L = 35m, b = 4m | 1,120.00 |
| 48 | Fsh.Dunav -Kisha katolike | L= 200m, b=4m | 1,900.00 |
| 49 | Fsh.Dunav te Xhamia e Re | | 300.00 |
| 50 | Gjilan rruga e Prishtines universal | L= 200m, b=5m | 1,400.00 |
| 51 | Fsh.Perlepnice | L= 1,400m b=5.50m | 23,520.00 |
| 52 | Rruga e Irfanit | L= 115m, b=4m | 644.00 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 53 | Fsh . Haxhaj ( Rr e kullës ) | L=85m b=4m | 1244.00 |
| 54 | Fsh . Haxhaj ( përball kullës ) | L=80m b=4m | 1088.00 |
| 55 | Fsh . Haxhaj (afër kullës ) | L=57m b=4m | 319.20 |
| 56 | Fsh . Haxhaj (Pastrimi i pronit te shkolla ) | L=60m b=5m | 600.00 |
| 57 | Fsh . Shurdhan ( lagja Xhel Guri ) + Sanim | L=4804m b=4m<br>L=500m b=3m | 7056.00 |
| 58 | Fsh . Dunav ( prej Xhamis te shtëpia xhevdes ) | L=330m b=4m | 580.00 |
| 59 | Fsh . Verbice-Zhegovc | L=1800m b=4m<br>L=770m b=4m | 450.00 |
| 60 | Fsh. Livoq i Poshtem (te Eltoni) | L=320m b=3.5m<br>L=99m b=3m | 4965.00 |
| 61 | Rr . Verbica e Kmetovcit (Valon Surdulli ) | L=100m b=4m | 460.00 |
| 62 | Fsh . Gumnishte e epërme (ka restoranti ) | L=1185m b=4m | 5467.00 |
| 63 | Fsh . Gumnishte e epërme (rr te kumllat ) | L=982m b=4m | 7511.6 |
| 64 | Fsh . Sllakovc (rr Arif Terstena ) | L=4000m b=4m | 5850.00 |
| 65 | Fsh . Sllakovc i poshtëm – Sanim | L=800m b=4m | 840.00 |
| 66 | Fsh . Zhegovc ( te Shabani ) | L=680m b=4m | 3950.00 |
| 67 | Fsh . Cernice-Gumnishte e poshtme | L=600m b=4m | 3360.00 |
| 68 | Lagj . Rozaleta – Gjilan – Sanim | | 140.00 |
| 69 | Fsh . Malisheve –Verbice e kmetovcit | | 3500.00 |
| 70 | Fsh . Malisheve ( te hoxha ) | L=1885m b=4m | 13268.00 |
| | Gjithsej | 791,54.00 m | 79.154 km |
| | Totali | | 230,059.00€ |

**Pastrimi i lumenjve dhe hapja e shtretërve të tyre nën ura:**

- **Lagja Poredin**
- **Afër restaurant "Pëllumbi", Gjilan**
- **Ura e Kufcës**

**Largimi i deponive ilegale:**

- **Te tregu i veturave**
- **Në fshatin Përlepnicë**
- **Te tregu i gjelbër**
- **Largimi i mbeturinave në qendër (te përmendorja "Mulla Idrizi")**
- **Te lagja Iliria (ish-Kamniku)**
- **Te liqeni i Livoçit**
- **Deponia në fshatin Zhegër (livadhet e verdha).**

- Operatori ekonomik El-Bau me nr. 651-18-4706-2-1-1 ka bërë **pastrimi dhe larja e të gjitha përmendoreve, shtatoreve dhe busteve në qendër të qytetit**, po ashtu prioritet i veçantë iu është kushtuar pastrimit të varrezave të dëshmorëve dhe varrezave në qytet, si dhe është bërë pastrimi dhe larja e rrugës sipas kalendarit të pastrimit të rrugëve sipas kontratës. po ashtu është bërë largimi i mbeturinave nëpër disa pjëse të qytetit.

- Grupi i operatorëve Ekonomik: "AVAG GROUP" SH.P.K DHE "EL-BAU" SH.P.K nga Gjilani me nr. identifikues 651-19-1328-2-1-1 dhe nr. Brendshëm GL 651 026 211.
- Gjatë kësaj periudhe është intervenuar përmes operatorit kontraktues për **mirëmbatjen e sinjalizimit horizontal dhe vertikal** për rregullimin dhe mirëmbajtjen e shenjave të komunikacionit, është bërë riorganizimi i rrugëve në lagjen Dardania ku jan kthyer nga lëvizja e automjeteve prej dy kahjet të kundërta në një kahore, si dhe është rregulluar shfrytëzimi iparkingut mbrapa objektit të soliterit me sinjalizim vertikal, shenjëzimi horizintal në rr. 15 qershori dhe ri-organizimi i parkingjeve.

- **Grupi i operatorëve ekonomik me nr. 651-20-7966-2-1-1 për ndriçimit publik në qytet** - ka intervenuar sipas nevojës dhe kërkesave të qytetarëve. Për sanimin e rrjetit ekzistues po ashtu është bërë edhe zgjerimi i rrjetit si më poshtë:s

- Zgjerimi i rrjetit në është bëre prej - 1889 metra gjatësi në Qytet , është bër zgjerim i rrjetit : Rr." Medlin Olbrait " 175 m', rr."28 Nëntori" 260 m', lagjja "Zabel" 62 m', Te Sheshi në qendër 230 m' rr."Uskana" 263 m', rr. "Murat Kelmendi" 175 m',rr"28 Nëntori " rrugët Lidhëse 180 m', rr."Kalaja" 182 m', rruga e Prishtinës(përballë Meridianit) 80 m', rruga e Pishtinës te tunelli 50m', rr."Mustaf Kokaj" 42m', rr."Murat Kryeziu " 110 m' dhe te Kodra e Dëshmorëve " 80 m'. Vazhdon implementimi i projektit sipas nevojës dhe kërkesave të qytetarëve.

- **Ndriçimi publik në fshatra,** Grupi i Operatorëve Ekonomik N.T.P i Toni - Goni: EL-BAO, SH.P.K : EING COM SH.P.K., F.SH. Malishevë Gjilan, Kontrata Publike Kornizë Nr.Identifilkimi : 651-21-5456-1-1-1, ka intervenuar pas identifikimit nga zyrtarët përgjegjës dhe sipas kërkesave të banorëve është bërë sanimi në rrjetit ekzistues ndërsa zgjerim të rrjetit kemi pasur si më poshtë:

- Në fshatra janë bërë zgjerim i rrejtit prej 1685 metra gjatësi : si në fshatrat: Maslishevë, Llashticë, LLadovë, Bresalc, Zhegër, Stublinë, Mireshë, Livoç i Ulët, Përlepnicë, Muhaxherët e Malishevës, Uglar, vazhdon implementimi i projektit sipas nevojës dhe kërkesave të qytetarëve .

Planifikimet për vitin 2022

Ne muajin mars kemi bërë planifikimin e prokurimit publik për investime kapital si dhe shërbimet që jane të domosdoshme për Komunën e Gjilanit.

| | |
|---|---|
| **1. Mirëmbajtja dimërore e Rrugëve në KK Gjilan** | **100,000.00 €** |
| **2. Sinjalizimi horizontal dhe vertikal në KK Gjilan** | 100,000.00 € |
| **3. Pastrimi i rrugëve, trotuarve, mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave gjelbreuese KK Gjilan** | 250,000.00 € |
| 6. Tërheqja e automjeteve | 10 000,00 |
| 7. Kontrata në vepër | 12 000,00 |
| **Grand Totali** | 472 000,00 |

**PROJEKTET E PLANIFIKUARA NGA BUXHETI I KOMUNËS:**

| | | |
|---|---|---|
| **1. Rikonstriumi i rrugës " Adem Jashari" Dhe "Zija Shemsiu"** | **Nuk kanë filluar punimet për arsyje teknike** | **400,000.00 €** |
| **2. Asfaltimi i rrugëve në fshatin Nasalë** | Ka përfunduar projekti | 105,623,00 € |
| **3. Asfaltimi i rrugëve ne fshatin Llashticë** | Në implementim të projektit | 118,195,62 € |
| **4. Asfaltimi i rrugëve lidhëse me rrugën Qarkore** | Nuk kanë filluar punimet për arsyje teknike | 174,085,00 € |
| **5. Asfaltimi i rrugëve në lagjen "Arbëria"** | Në implementim të projektit | 165,106,00 € |

| | | |
|---|---|---|
| **6. Asfaltimi i rrugë ne lagjen e Vishnjeve Pjesa I** | Në implementim të projektit | 194,672,95 € |
| **7. Rruga në lagjen Porodin/kanalizimi fekal dhe ujësjellësi** | Në implementim të projektit | 84,003,98 € |
| **8. Asfaltimi i rrugëve në Bresalc në gjatësi prej L= 150m+62m=212 m** | Ka përfunduar, shtresa e pare | 30,272.00 €. |
| **Gjithsej vlera:** | | 1,271958.55 € |

| | | |
|---|---|---|
| **Kanalizimi fekal Livoç i Epërm - Livoç i Ulët dhe një pjesë e lagjës Kodra e Thatë** | **Nuk kanë filluar punimet për arsyje teknike** | **455,610.88 Euro** |
| **Terrenet Sportive** | Në implementim të projektit | 359,889.75 Euro |
| **Asfaltimi i rrugëve në fshatin Cërrnicë** | Në implementim të projektit | 89,851.03 Euro |

**Ndërsa projektet e Grantit të Përformances 864,000 euro:**

| | | |
|---|---|---|
| **Kanalizimi fekal Livoç i Epërm - Livoç i Ulët dhe një pjesë e lagjës Kodra e Thatë** | **Nuk kanë filluar punimet për arsyje teknike** | **455,610.88 Euro** |
| **Terrenet Sportive** | Në implementim të projektit | 359,889.75 Euro |
| **Asfaltimi i rrugëve në fshatin Cërrnicë** | Në implementim të projektit | 89,851.03 Euro |
| **Asfaltimi i rrugëve në fshatin Haxhaj** | Në implementim të projektit | 122,767.75 Euro |
| **Gjithsej vlera:** | | 1,028,119.41Euro |

**Në thirrje nga MAPL-ja për aplikim me një projekt për bashkëfinancim në infrastruktur rrugore, kemi aplikuar:**

Ndërsa lidhja e marrëveshjes për bashkefinancim nga Ministria e infrastrukturës për 8 projektet kapital **2.317,271.83 euro**

| | | |
|---|---|---|
| **1.** | **Asfaltimi i rrugëve në Malishevën e Ulët** | **Procedur të tenderimit** |
| **2.** | Asfaltimi i rrugëve ne fshatin Gadish | Procedur të tenderimit |
| **3.** | Asfaltimi i rrugës: Jonuz Terstena dhe 28 Nentori, Krahet 1-5 dhe kanalizimi fekal | Procedur të tenderimit |
| **4.** | Asfaltimi i rrugëve "Qefsere Salihu" dhe "Blerim Halili": | Procedur të tenderimit |
| **5.** | Asfaltimi i rrugëve ne lagjen "Vishnjet": | Në implementim të projektit |
| **6.** | Asfalltimi i rrugëve në lagjen "Livadhet e Arapit": | Procedur të tenderimit |
| **7.** | Rikonstruktimi i rrugës "Nena Tereze": | Procedur të tenderimit |
| **8.** | Trotuari nga Demiraj - Haxhaj | |
| **9.** | Rruga në fshatin Burincë /AVAG-2021/-Burincë | |
| | Gjithësej vlera: | 2 317, 271.83 € |

Është  duke u hartuar projekti i rrugës së Malishevës, i trotuarit në fshatin Uglar në gjatësi rreth 1500m dhe trotuari në fshatin Bresalc prej Xhamis deri te shkolla në gjatësi rreth 1900m.

Aktivitet e inicuara për tenderim në prokurim.

# Drejtoria e Arsimit

## V. Drejtoria e Arsimit

Drejtoria e Arsimit gjatë periudhës nëntëmujore ka arritur me sukses t'i realizojë objektivat e planifikuara të cilat kanë qenë të bazuara në planin e veprimit, si dhe angazhime të shtuara në përmbushjen e kërkesave dhe obligimeve të paparashikuara.

Në sektorin e arsimit, aktivitetet e planifikuara kanë derivuar nga Plani i Veprimit të DKA-së për periudhën kohore janar-shtator për vitin shkollor 2021/22.

Objektivat zhvillimore të planifikuara në sektorin e arsimit janë:

- Menaxhimi efikas i arsimit;
- Krijimi i mekanizmave për ngritjen e cilësisë në arsim;
- Zbatimi i suksesshëm i kurrikulës;
- Krijimi i kushteve për arsim cilësor;
- Zhvillimi i arsimit profesional për t'iu përshtatur tregut të punës;
- Zbatimi i legjislacionit primar dhe sekondar.

### Aktivitetet e zbatuara për periudhën raportuese gjashtëmujore Janar –Qershor 2022

Duke marrë parasysh trendet e mbështetjes nga Komuna e Gjilanit, në politikat e zhvillimit të sistemit arsimor në Komunën tonë, deri më tani janë ndërmarrë hapa konkret sipas PV të DKA-së për të fuqizuar trajtimin e gjitha niveleve të arsimit para universitar ku gjendja pritet të ndryshojë konsiderueshëm përmes realizimit të aktiviteteve në fushën e infrastrukturës:

Krijimi i Hapësirave fizike për përfshirjen sa më të madhe të fëmijëve në nivelin e arsimit parashkollor përmes ndërtimit të objekteve të reja të destinuara për qëndrim ditor. Më datën 15.03.2022 kemi marrë aprovimin nga MASHTI për ndërtimin e çerdhes së re në lagjen "Qarku 1", me kapacitet për 120 fëmijë të moshës 9 muaj deri në 5 vjeç.

Më datë 17.03.2022, DKA në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Urbanizmit, ka deponuar dosjen me dokumentacion plotësues në MASHTI, për ndërtimin e çerdhes e cila ka filluar punimet gjatë këtij viti.

Bazuar në planifikimin e Qeverisë së Kosovës, miratuar në Kuvendin e RK, për ndërtimin e çerdhes së re në fshatin Miresh, si hap i parë kemi realizuar një analizë të gjendjes së numrit të fëmijëve nga mosha 0-6 vjeç. Përveç analizave jemi angazhuar edhe në procesin e grumbullimit të të dhënave dhe dokumentacionit plotësues për zbatimin e projektit në fjalë.

Aktualisht jemi në fazën e analizave për mundësinë e ndërtimit të objekteve, anekseve apo edhe mundësinë e shndërrimit të objekteve ekzistuese të pashfrytëzuara në pronësi të komunës në çerdhe me qëndrim ditor në dy zonat rurale të cilat janë targetuar si potenciale të synuara për DKA, njëra në fshatin Bresalc dhe tjetra në fshatin Përlepnicë.

Me inicimin e DKA-së në bashkëpunim me qendrën e vaksinimit në kuadër të QMF kemi marrë të dhëna statistikore për numrin e përgjithshëm të fëmijëve për moshën 0-5 vjeç në komunën tonë, këto të dhëna statistikore do të na shërbejnë për planifikimin e ndërtimit, zgjerimit apo ndërtimit të objekteve të reja të çerdheve si dhe qendrave me bazë në komunitet, për ngritjen e numrit të përfshirjes së fëmijëve nën moshën 5 vjeç.

Angazhime në përfundimin e të gjitha aktiviteteve për hapjen e qendrës me bazë në komunitet (QBK).

Në muajin prill 2022, ka filluar punën Qendra me Bazë në Komunitet në fshatin Ponesh, për fëmijët e moshës 3-5 vjeç në kuadër të SHFMU 'Vesel Muji'. Aktualisht këtë qendër e frekuentojnë gjithsej: trembëdhjetë (13) fëmijë. Projekti është mbështetur nga UNICEF dhe QHZHFH, ku përmes hapjes së këtyre qendrave synohet të arrihet qëllimi kryesor, rritja e shkallës së përfshirjes së fëmijëve në ofrimin e shërbimeve në edukimin e hershëm dhe lehtësimin e qasjes në këto shërbime nga të gjithë fëmijët pa dallim.

Për krijimin e kushteve më të mira të ambienteve të klasave përgatitore, janë pajisur dy klasa përgatitore me inventar dhe pako didaktike, në kuadër të SHFMU "Ramiz Cërrnica" dhe "Vatra e Diturisë" për fëmijët e moshës 5-6 vjeç, të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të punës edukative në nivelin

e edukimit të hershëm, si dhe përmirësimin e infrastrukturës për ofrimin e shërbimeve për edukim të hershëm në bashkëpunim me Caritasin Zviceran në Kosovë.

Kompletimi i dokumentacionit për nëntë (9) terrene sportive, në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik.

DKA është në proces të zbatimit të projektit për efiçiencë. Projekti në fjalë ka filluar së zbatuari në IAAP "Mehmet Isai" dhe në SHFMU "Rexhep Elmazi".

Renovimi i sallës së Edukatës Fizike në Gjimnazin Shoqëror "Zenel Hajdini" aktualisht është në fazën përfundimtare.

Janë adaptuar dy tualete në shkollat "Nazmi Hoxha" dhe "Musa Zajmi" në Gjilan për qasje më të lehtë fëmijëve me nevoja të veçanta (FNV) të financuara nga donatori "AR Katana".

Rregullimi i dhomës miqësore për FNV në IAAP'' Arbëria'' – e mbështetur nga IPKO Fondacion.

DKA ka shqyrtuar kërkesat e deponuara nga IEA për nevojat për renovime dhe ndërhyrje infrastrukturore për të gjitha IEA. Bazuar në vizitat vlerësuese, ka klasifikuar nevojat urgjente për ndërhyrje.

Angazhime në realizimin e dezinfektimit, dezinsektimit dhe deratizimit (DDD) në bashkëpunim me IEA-të.

Angazhime në plotësimin e formularëve, për Vlerësimin e Performancës Komunale për vitin 2021, në fushën e arsimit para universitar e drejtuar nga MAPL dhe USAID.

Angazhime permanente në mbështetje të udhëheqësve të IP për menaxhimin dhe krijimin e kushteve të shërbimeve më cilësore, në aspektin e zhvillimit profesional të edukatoreve, grumbullimin dhe sistematizimin e të dhënave të ndryshme dhe mentorim në qasje për tejkalimin e sfidave në baza ditore.

Në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit dhe me mbështetjen e MASHT-it, janë përzgjedhur disa pako me libra për fëmijë, me qëllim të nxitjes së mësimit përmes lojës, të cilat janë në dispozicion të shpërndahen nëpër institucione parashkollore për Komunën e Gjilanit.

### Angazhime në përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2022/2023

- Shpallja e konkurseve për pranimin e nxënësve:
- Konkursi për regjistrimin e fëmijëve në Institucionet Parashkollore Publike 9 muaj deri 5 vjeç;
- Konkursi për nivelin e arsimit para fillor të fëmijëve 5-6 vjeç, në kuadër të SHFMU;
- Konkursi për nivelin arsimit fillor, klasa e parë.
- Organizimi i aktivitetit "Java e Dyerve të Hapura" për nxënësit e klasave të 9 – ta;

Shpallja e listës për fëmijët e pranuar dhe listave të fëmijëve në pritje në kuadër të IP

- Hartimi i planit të veprimit për inicimin e hapjes së dy grupeve të reja të fëmijëve të moshës 9 muaj -3 vjet në kuadër të dy institucioneve parashkollore njëra në IP Integj, dhe tjetra në IP Dardania

Rekomandimi i DKA për Rishikimin e plan programit edukativ 0-6 vjeç nga Aktivet e IP dhe planifikimi për vitin 2022/23

- Planifikimi i paraleleve dhe profileve për nxënësit e SHML për vitin shkollor 2022-2023;
- Përgatitja e konkursit për regjistrimin e nxënësve në klasën e (10), në Gjimnaze dhe Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP)" për vitin shkollor 2022-2023;
- Shpërndarja e ditarëve si dhe dokumenteve pedagogjike 2022-2023.
- Shpërndarja e teksteve shkollore nga klasa e I-rë deri në klasën e IX-të.

- Shpërndarja e lëndëve djegëse (drunjëve) në IEA
- Sistemimi i nxënësve në klasën e dhjetë, përmes vendimit për rritjen e nr. të nxënësve nga 24 në 32, në profilet e Gjimnazit natyror dhe të shkollës së mjekësisë.
- Mbulimi i të gjitha pozitave përmes zëvendësimeve të përkohshme
- Grumbullimi i protokolleve të institucioneve parashkollore me datën 06.07.2022 ora 15:00 të aplikuesve për regjistrimin e fëmijëve në pesë IP të Komunës.
- Grumbullimi dhe përpunimi i listave të fëmijëve sipas grup moshave të ndara në grupe dhe bartësve të grupeve me edukatore.
- Hartimi i specifikacionit të listës potenciale për lodra druri dhe tjera me materiale të ndryshme për aktivitetet eksploruese për çerdhen në fshatin Zhegër, nga UNICEF.
- Grumbullimi i raporteve nga komisioni për shqyrtimin e ankesave të prindërve në kuadër të institucioneve parashkollore.
- Grumbullimi dhe analiza e Aktvendimeve nga institucionet parashkollore për shfrytëzimin e pushimit vjetor kolektiv, në bazë të planit për shfrytëzimin e pushimit vjetor për punëtorët e arsimit, Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-212 neni 33 paragrafi 1 dhe 2.
- Hartimi i mini projektit, fushëloja me rekuizitat për hapësira të jashtme në SHFMU “ Selami Hallaqi” për fëmijët e moshës 5-6 vjet.

## Angazhimet profesionale në zbatim të aktiviteteve gjithëpërfshirëse në ngritjen e cilësisë për nivelin e arsimit parauniversitar

- Hartimi i planit të veprimit (PV) të DKA-së.
- Në kuadër të vizitave në IEA, drejtoresha e DKA-së e shoqëruar me zyrtarët për periudhën kohore shkurt-qershor 2022, ka vizituar rreth 75% të shkollave në tërë komunën e Gjilanit sipas planit dinamik të planifikuar.
- Vizita monitoruese në IEA.
- Komunikim të përditësuar individual dhe grupor me IEA-të për menaxhimin e gjendjes pandemike (riorganizimet e brendshme, përcjellja e vijueshmërisë së fëmijëve, rekomandimet për menaxhimin e virusit Covid-19, me theks të veçantë, higjiena dhe dezinfektimi i shtuar, bazuar në udhëzuesit dhe protokollet në fuqi nga Qeveria e Kosovës, delegimi i zëvendësimeve, monitorimi i takimeve me task forcat në nivel të IEA-ve.
- Komunikim të përditësuar me udhëheqësit e IEA-ve në mënyrë të vazhdueshme.
- Në bazë të detyrave dhe përgjegjësive DKA ka themeluar Këshillin e Prindërve në Nivel Lokal. Në kuvendin e mbajtur më datë 14.03.2022, është zgjedhur kryesia e re prej shtatë anëtarëve, nënkryetari dhe kryetari.
- Në kuadër të fuqizimit të rolit të këshillave drejtuese të IEA-ve, është kërkuar plotësimi i këshillave drejtuese të shkollave dhe organeve drejtuese të shkollave si dhe monitorimi i punës së këshillave drejtuese të në kuadër të IEA- ve përmes procesverbaleve.
- Takime të rregullta me udhëheqësit e IEA-ve, rreth identifikimit dhe mbështetjes së nevojave për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të punës edukative në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.
- Është bërë planifikimi dhe realizimi për testin e arritshmërisë dhe maturës shtetërore (caktimi i qendrave të testimit, administruesve dhe vëzhguesve si dhe ndarja e nxënësve bazuar në udhëzuesin e MASHTI-t.
- Janë organizuar dhe realizuar testet ndërkombëtare: PISA, TIMSS dhe ICIRLS.
- Janë organizuar dhe mbështetur garat shkollore në nivel të Komunës dhe Republikës si: Olimpiada matematikore e Gjilanit 2022, Garat e Fizikës dhe Garat KANGAROO etj.
- Pjesëmarrje në takime punuese me MASHTI-n, rreth UA- ‘Granti Specifik i Arsimit për Komuna’.
- Takime me KEDS, rreth zgjidhjes së çështjes së trafos për shkollën e Artit Pamor,
- Puna përgatitore rreth vlerësimit të performancës së drejtorëve dhe zv. drejtorëve.
- Kemi bërë përgatitje rreth nevojave të furnizimit të shkollave me gjeneratorë.

## Planifikimi dhe plotësimi i normave mësimore

- Angazhime në stabilizimin e normave për të gjitha nivelet e arsimit në komunën tonë,  e cila është njëra nga objektivat e tona si DKA, bazuar në planin e veprimit si dhe strategjinë  tonë të udhëheqjes për vitet në vazhdim. Gjatë kësaj periudhe të shkurtër, kemi skanuar gjendjen ekzistuese dhe jemi në fazën e përgatitjeve të normave të mësimdhënësve për vitin shkollor 2022/23, duke i respektuar të gjitha aktet ligjore në fuqi.
- Për t'i plotësuar vendet e lira dhe të nevojshme  për staf në IEAA, kemi shpallur konkurset si në vijim:
- Konkursi për asistentë për fëmijë me nevoja të veçanta;
- Konkursi për stafin mbështetës teknikë në shkolla;
- Konkursi për drejtorë dhe zëvendësdrejtorë në IEAA;
- Konkursi i brendshëm për mësimdhënës.

## Trajnimet dhe zhvillimi profesional i stafit në IEA

- Përmes angazhimeve permanente, në periudhën dy mujore janar dhe shkurt 2022,  në adresimin e kërkesave në organizatat e ndryshme  ndërkombëtare dhe vendore, për nevojat e trajnimeve të edukatoreve në komunën e Gjilanit, kemi arritur që të përfitojmë gjashtë module të akredituara të trajnimeve për njëzet e shtatë (27) edukatore të klasave përgatitore në kuadër të shkollave, nga organizata ndërkombëtare Caritasi Zviceran në Kosovë, si dhe gjashtë module të aprovuara dhe mbështetura nga organizata Unicef  dhe Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Edukimit, për gjithsejtë: pesëdhjetë (50) edukatore në kuadër të institucioneve parashkollore dhe shkollave fillore, të cilat gjatë muajve në vijim do të fillojnë të zbatohen.
- Me datë 11.06.2022, në kuadër të projektit "Forcimi i kapaciteteve të vendimmarrësve në nivel komunal, për planifikimin dhe koordinimin për të zgjeruar mbulimin dhe cilësinë e shërbimeve të edukimit në fëmijërinë e hershme", janë realizuar trajnime për edukatoret e nivelit të arsimit parashkollor në kuadër të shkollave dhe institucioneve parashkollore, nga organizata QHZHFH.
- Me datë 21.05.2022, është realizuar trajnimi me temën "Roli dhe ndikimi i baballarëve në rritjen dhe zhvillimin e fëmijërisë së hershme" për edukatoret e klasave parafillore dhe edukatoret në kuadër të institucioneve parashkollore.
- Punëtori kreative me prindërit e fëmijëve dhe edukatoret në dy institucione parashkollore, mbështetur nga Save the Children dhe DKA.
- Punëtori një ditore me kryetaret e aktiveve profesionale të edukatoreve, në kuadër të shkollave dhe institucioneve parashkollore.
- Pjesëmarrje e vazhdueshme e mësimdhënësve në trajnime të licencuara nga MASHTI në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.
- Përfundimi i trajnimit për kurrikulë, si dhe vlerësimi i njëqind (100) mësimdhënësve të të gjitha niveleve në arsimin parauniversitar.
- Grumbullimi i nevojave nga institucionet e arsimit parauniversitar për zhvillim profesional dhe trajnime për personelin arsimor në bashkëpunim me MASHTI.
- Organizimi i punëtorive me nxënës të shkollave të mesme të larta.
- Organizimi i punëtorisë virtuale "UPSHIFT- punëtoria për ndikim social".
- Dizajnimi i databazës së trajnimeve për mësimdhënësit në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Sipas PV janë ndjekur të gjithë hapat drejt krijimit të një databaze në kuadër të DKA-së. Jemi në fazën e plotësimit të  databazës me të dhëna të detajuara nga IEA-të. Përmes këtyre të dhënave, DKA për herë të parë do t'i ketë në dispozicion informatat e detajuara individuale rreth trajnimeve të ndjekura dhe nevojat për mbështetje të mësimdhënësve të komunës sonë.

## Pjesëmarrja e zyrtarëve në punëtori

- Pjesëmarrje në dy punëtori dy ditore me zyrtarët e nivelit për arsimin parashkollor të DKA-ve në nivel të  Republikës, në kuadër të projektit SHPRESË- të mbështetura nga Caritasi Zviceran në Kosovë.

- Punëtori e organizuar nga rrjeti ballkanik i gazetarisë hulumtuese me temë "Procesi i ri-integrimit dhe ri-socializmit të personave që kanë rënë ndesh me idetë radikale".
- Organizimi i sesioneve informuese nga ekipi vlerësues pedagogjik për shënimin e datave 21 mars – Dita e Doën Sindrom dhe 2 prill – Dita e Autizmit.
- Pjesëmarrja në takim me forumin e aftësisë së kufizuar dhe institucionet komunale ku u diskutua për të arriturat, sfidat dhe përgjegjësitë ndaj FNV.
- Në kuadër të projektit "Forcimi i kapaciteteve të vendimmarrësve në nivel komunal, për planifikimin dhe koordinimin për të zgjeruar cilësinë e shërbimeve të edukimit në fëmijërinë e hershme në komunat e Gjilanit mbështetur nga UNICEF dhe implementuar nga Qendra për Shërbime Humane dhe Zhvillime" më datë 17.03.2022 është mbajtur punëtoria për hartimin e Planit të Veprimit të Komunës së Gjilanit për fëmijërinë e hershme.
- Punëtori për ndryshimin e Udhëzimet Administrative (Granti Specifik i Arsimit) dhe UA raporti nxënës-mësimdhënës.
- Pjesëmarrje në punëtorinë dy ditore me zyrtarët e arsimit gjithëpërfshirës të DKA-ve në nivel të Republikës në kuadër të projektit "INCLUDE" të organizuar nga Këshilli i Evropës në Kosovë.
- Pjesëmarrje në eventin - MARSHI I FËMIJËVE PËR TË SHËNUAR DITËN GLOBALE TË AKSIONIT KLIMATIK
- Me datën 11-12.05.2022, pjesëmarrje në punëtorinë dy ditore me fokus në punën e saj në zbatimin e programeve zhvillimore në fushat e "Edukimit në Fëmijërinë e Hershme", mbrojtjes së fëmijës, qeverisjes së të drejtave të fëmijës, dhe shëndetit e ushqyeshmërisë. Bartëse e aktivitetit është organizata "Save the Children" në bashkëpunim me MASHTI-n, ku është bërë prezantimi i programeve për periudhën 2022+." në Brezovicë,
- Pjesëmarrje në punëtorinë me Mekanizmin Referues e organizuar nga BIRN, me temë: "Menaxhimi në raste të krizave".
- Pjesëmarrje në punëtorinë e organizuar nga Programi i USAID-it "Përkrahje Adoleshentëve pas Mësimit të Rregullt"- ASSET, me qëllim të diskutimit për qëndrueshmërinë e aktiviteteve pas përfundimit të programit.
- Pjesëmarrje në punëtorinë e organizuar nga BIRN, në publikimin e raportit "Sfidat e procesit të Riintegrimit dhe Risocializimit në Kosovë".
- Pjesëmarrje në takimin me MASHTI-in, me qëllim të informimit lidhur me ZHPM me bazë në shkollë, dokumentacionin si dhe procedurat me shpenzimet buxhetore nga MASHTI dhe DKA.
- Pjesëmarrje në takim lidhur me projektin: "Mbështetja e Bashkimit Evropian për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (AAP), rikualifikimet profesionale dhe profesionet ("ESVET PRO") me temën "Digjitalizimi i Sistemit të AAP-së: Roli i mjeteve digjitale në procesin e të nxënit dhe të vlerësimit" dhe certifikimi i mësimdhënësve të cilët e kanë përfunduar me sukses trajnimin e ofruar nga projekti.

### Marrëveshjet dhe bashkëpunimi me organizatat vendore dhe ndërkombëtare - donacionet

- Marrëveshje mirëkuptimi ndërmjet DKA-MASHTI-EYE (Projekti - rritja e punësimit për të rinjtë) - themelimi i Qendrës së Karrierës në IAAP "Mehmet Isai" në Gjilan.
- Memorandum i mirëkuptimit mes KEC dhe SHFMU "Abaz Ajeti" për projektin "Transformimi shoqëror inovativ në Kosovë",
- Eulex ka mbështetur me pajisje elektronike SHFMU "Musa Zajmi".
- Donacion nga shkolla e Wetzikonit – Cyrih për Gjimnazin "Zenel Hajdini" me pajisje teknologjike.
- OSBE ka mbështetur nxënësit e Komunitetit RAE me pajisje elektronike.
- Projekti Connected-Through Mobility në SHMLAT "Arbëria"-përzgjedhja e tre nxënësve për praktikë një mujore në Slloveni.
- Në muajin maj 2022, Save the Children ka mbështetur dy institucione parashkollore me materiale didaktike dhe lodra demonstruese të konsiderueshme për fëmijët 9 muaj - 5 vjet.
- Marrëveshje partneriteti mes: Save the Children-Drejtorisë Komunale të Arsimit-Drejtorisë Komunale të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të Gjilanit për realizimin e projektit "Përmirësimi i qasjes dhe cilësisë në

Kujdesin dhe Zhvillimin gjatë Fëmijërisë së Hershme në Kosovë-Zgjerimi Medikal”.
- Memorandum Mirëkuptimi në mes DKA-së dhe IPKO Fondation, me qëllim të mbështetjes së inovatorëve të rijnë dhe zhvillimit të brezit të ardhshëm të liderëve me vizion digjital për Kosovën.
- Si rezultat i bashkëpunimit në mes të Organizatës Gjermane GIZ - Qeveri e Kosovës-GFA dhe DKA është arritur të angazhohet një asistent për bashkëpunimin ndërmjet shkollës-dhe bizneseve, në IAAP “Mehmet Isai” për periudhën dy vjeçare, i cili do të bëjë ndërlidhjen në mes të shkollës dhe bizneseve të cilat operojnë në komunën tonë.

### Organizimi dhe realizimi i eventeve për nder të shënimit të datave të rëndësishme

- Organizimi, menaxhimi, monitorimi dhe shënimi i eventit - “7 Marsi – Dita e Mësuesit”.
- Organizimi dhe shënimi i ditës ndërkombëtare të Sindrom Doën, më 21 mars.
- Organizimi dhe shënimi i ditës ndërkombëtare të Autizmit, më 2 prill.
- Pjesëmarrje në organizime – evente të ndryshme të shkollave.
- Organizimi, menaxhimi i eventit “1 Qershori Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve’’ me pjesëmarrës aktiv gjithsej: gjashtëqind e tetëdhjetë ( 680) fëmijë të moshës 5-6 vjeçare, në platonë e Teatrit të Qytetit.
- Shënimi i ditës së 3 qershorit- “Dita Botërore e Biçikletës”, në bashkëpunim me FSK-në.
- Shënimi i 15 Qershorit – “Dita e Çlirimit” të Qytetit të Gjilanit, në bashkë organizim me kabinetin e Kryetarit të Komunës dhe DKRS.
- Pjesëmarrje aktive me të gjitha shkollat në zbatim të projektit për pastrimin e ambientit “Green and Clean” nga data 22 prill – 5 qershor 2022 .
- Realizimi i aktivitetit me Kryqin e Kuq të Kosovës-Dega në Gjilan.
- Realizimi i projektit “Kampi Rinor” të organizuar nga UNDP.
- Realizimi i projektit me Kompaninë për Operacione Civile, Forca e Sigurisë së Kosovës.
- Për nder të “Javës së Psikologjisë’, psikologët e Gjimnazit Natyror “Xhavit Ahmeti” organizuan aktivitetet si në vijim:
- Debat me tri tema si: trashëgimia pronësore, pabarazia gjinore dhe mentaliteti patriarkal;
- Meditim, terapi grupore me qëllim të promovimit dhe ruajtjes së shëndetit mendor si dhe bartjen e mesazheve vetëdijësuese për parandalimin e dukurive negative;
- Dy shfaqje teatrale, me tematikë nga fusha e drejtësisë.
- Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave me shkrim të palëve, edukatoreve, mësimdhënësve, prindërve, studentëve për vijimin e praktikës nga kolegjet private, organizatave vendore dhe ndërkombëtare, drejtorive të linjës në kuadër të komunës dhe mediave.
- Formimi i komisionit në kuadër të DKA-së për shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave të palëve nga marrëdhënia juridike e punës, i cili i ka shqyrtuar shtatë lëndët të cilat i janë adresuar komisionit.

### Sektori për Punë të Përgjithshme Juridike dhe Personel në Arsim

- Vendime/Aktvendime të ndryshme 124;
- Hartimi dhe përgjigjet në kërkesa/parashtresa ndaj palëve dhe subjekteve të tjera, 185
- Hartimi i kontratave të punës 236;
- Hartimi i akteve të tjera shkresore 175;
- Hartimi i shkresave të ndryshme, drejtuar Institucioneve brenda dhe jashtë Komunës së Gjilanit, 67;
- Hartimi dhe shpallja e konkurseve 7;
- Përgatitja, plotësimi dhe procedimi i formularëve për ndryshimet në listat e pagave, drejtuar thesarit në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve 412;
- Përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë janë pranuar dhe protokolluar 397 lëndë, drejtuar Drejtorisë Komunale të Arsimit;
- Hartimi i Projekt Rregullores për Marrëdhënien Juridike të Punës në Institucionet Edukativo Arsimore dhe Aftësuese.

- Hartimi i Projekt Rregullores për Përgjegjësinë Disiplinore dhe Materiale të Punonjësve në Institucionet Edukativo Arsimore dhe Aftësuese.
- Hartimi i Projekt Rregullores për mbështetjen financiare - bursave të posaçme për studentët e shkëlqyer të Komunës së Gjilanit, që studiojnë jashtë shtetit të Republikës së Kosovës (Fondi i Ekselencës).
- Organizimi i brendshëm i dëgjimeve publike për Projekt Rregulloret.
- Mbajtja e një takimi me sekretarët dhe administratorët e të gjitha Institucioneve Edukativo Arsimore dhe Aftësuese lidhur me çështjet ligjore, administrative të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë ndërmjet DKA-së dhe IEA-ve.
- Ofrimi i dokumentacionit dhe bashkëpunimi me auditorin e jashtëm dhe të brendshëm.
- Asistimi në aspektin organizativ dhe ligjor për përzgjedhjen e Këshillit të Prindërve në nivel të Komunës.

Raporti i zyrës së financave, për periudhën kohore Janar - Maj 2022

| Përshkrimi | Kategoria | Planifikimi | Alokimi | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| | Paga | 11,385,304.00 | 8,980,414.38 | 78.88 |
| | Shërbime dhe mallra 10-21-22 | 2,218,085.00 | 1,225,158.17 | 55.23 |
| | Komunali 10-21 | 153,000.00 | 122,239.69 | 79.90 |
| | Subvencione 10-21 | 150,000.00 | 149,394.00 | 99.60 |
| | Kapitale-10-21 | 200,000.00 | 131,844.37 | 65.92 |
| | Totali | 14,106,389.00 | | 5,067,541.38 |

1. Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme.
2. Janë proceduar aktivitete të ndryshme në Prokurim.
3. Kërkesat për furnizim, tridhjetë (30).
4. Pranimi i faturave dhe regjistrimi në sistemin E-financa, njëqind e njëzet e shtatë (127) lëndë.
5. Janë regjistruar njëmijegjashtëqindenëntëdhjeteshtatë (1697) lëndë në kontabilitet,
6. Janë kryer barazimet me shkollat dhe DKA si dhe specifikacionet e alokimit të mjeteve nga shkollat.
7. Alokimi i mjeteve nga donacionet.
8. Monitorimi i shkollave - pushimet mjekësore.
9. Auditimi i brendshëm dhe i jashtëm.

# Drejtoria
# për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

## VI. Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

Gjatë kësaj periudhe (01 Janar – 30 Shtator ) në DGJKP janë kryer këto punë dhe aktivitete tjera si në vijim:

- Janë pranuar nga Qendra për shërbim me qytetar 4847 lëndë- kërkesa të ndryshme, për regjistrime të pronave, masa të përkohshme, barra tatimore, vlerësime të pronave për shqyrtimin e trashëgimisë, kontrata të ndryshme, kërkesa për matje, shënime për përmbaruesit privat, servitute, parcelime, legalizime të objekteve, ndërrim të kulturës së parcelave, regjistrime të objekteve etj.

1. Janë kthyer në Qendrën për shërbim me qytetar si të përfunduara: 4403 lëndë.
2. Janë kthyer në Qendrën për shërbim me qytetar si të përfunduara: 4403 lëndë.
3. Në procedurë janë: 444 lëndë.
4. Nga sistemi On-line Bankat kanë aplikuar për regjistrim, modifikim dhe fshirje të hipotekave

Përveç kërkesave të palëve janë kryer edhe këto punë sipas detyrës zyrtare:

**5.**Përveq kërkesave të palëve janë kryer edhe këto punë sipas detyrës zyrtare:

| Përshkrimi i aktivitetit | Periudha e raportimit |
|---|---|
| | Janar – Qershor 2022 |
| **Certifikata të pronës** | 5250 |
| **Certifikata të gjendjes ekonomike** | 445 |
| **Certifikata që nuk posedon pronë** | 120 |
| **Kopje plani** | 1192 |
| Totali: | 7007 |

Përveç lëndëve përmes QSHQ - së, DGJKP-ja ka kryer edhe lëndë/kërkesa sipas detyrës zyrtare lidhur me:

- Janë iniciuar 165 lëndë, sipas detyrës zyrtare për shqyrtimin, verifikimin, identifikimin dhe korrigjimin e të dhënave dhe sipërfaqeve në RDPP.
- Sponzorizimi i Vendimeve për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin Komunal, si : Dhënia në shfrytëzim e pronës komunale për rastet e veçanta; Shpallja e interesit publik të pronave për nevoja të Komunës e të cilat administrohen nga Institucionet Qendrore si AKP-ja dhe Drejtoria e Pyjeve ZK Malishevë dhe ZK Stublinë ; Propozimi për themelimin e Komisionit për Vlerësimin e ofertave për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim;
- Propozimi për themelimin e Komisionit të Ankesave nga procedurat e ankandit publik për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër.
- Regjistrimin e Objekteve të legalizuara në procedurën e legalizimit të objekteve pa leje.
- Parcelimi dhe regjistrimi i pronave në procedurën e shpronësimit sipas projekteve të nivelit qendror e në të cilat interferohet Komuna e Gjilanit;
- Janë kryer 91 historiate të pronave për nevoja të Gjykatës Themelore në Gjilan, Policisë së Kosovës, Prokurorisë së Shtetit si dhe personave fizik ;
- DGJKP-ja i është drejtuar me 25 kërkesa të ndryshme subjekteve të ndryshme komunale dhe institucioneve tjera në lidhje me problematikat pronësore.
- Janë nxjerr 12 Aktvendime për korrigjimin e emërtimit të titullarit të pronave komunale në 12 Zona të ndryshme kadastrale;
- Themelimi i fondit të veçantë për projektin e impiantit të ujërave të zeza.
- Matje me dron tek kalaja e Pogragjës, si dhe përgatitje e situacionit gjeodezik të terrenit dhe paraqitje 3D e objektit të kalasë së Pogragjës.
- Përcaktimi i lokacionit për zonën ekonomike në Gjilan, përveç përcaktimi të lokacionit, kemi mbajtur takim me zyrën e kryeministrit ku kemi prezantuar projektin e komunës për zonën ekonomike, përveç projektit janë prezantuar edhe matjet gjeodezike të realizuara me dron gjeodezik.
- Angazhim në lidhje me projektin e realizimit të sheshit në qytetin e Gjilanit, skicat në lidhje me projektin e rrugës së Malishevës.
- Angazhim në lidhje me lokacionin e hapjes së terminalit doganor në qytetin e Gjilanit.
- Përcaktimi i lokacioneve dhe takimi me qytetarë në disa fshatra dhe qytete për përpunimin e projekteve në lidhje me ndërtimin e disa mini-parqeve në këto zona.

- Përcaktimi i lokacionit për Shtëpinë e Kulturës në lagjen Dardania, në bazë të kërkesës nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
- Angazhim në lidhje me krijimin e një projekti të përbashkët Gjilan-Preshevë-Likovë, propozimi i pikës së vend-takimit, krijimi i shtegut të hikingut dhe propozimin e një parcele për krijimin e një zone agro-turistike në territorin e Gjilanit.
- Takim me agjensionin kadastral të Kosovës, në lidhje me problemet dhe mundësin e rritjes së bashkëpunimit në mes drejtorisë dhe agjensionit kadastral të Kosovës, si dhe realizimin e projektit të sistemit të adresave dhe propozimin e inkuadrimit të disa zonave në projektin e ri-ndërtimit të kadastrit, projekt i cili financohet nga banka botërore
- Janë realizuar të hyra vetanake për këtë periudhë (Janar – Shtator ): 186,830.00 €.
- Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, gjatë kësaj periudhe ka pasur bashkëpunim të ngushtë me drejtoritë dhe zyrat tjera komunale, me institucionet dhe agjencitë qeveritare: MAPL-në, Ministrinë e Financave, Agjencionin Kadastral të Kosovës, Agjencionin Kosovar të Privatizimit, Agjencionin Kosovar të Pronave, Agjencinë Pyjore të Kosovës, Arkivin Ndërkomunal, Gjykatat e rangut të ndryshëm, etj. si dhe me Organizatat Ndërkombëtare të cilat veprojnë në Kosovë : OSCE, USAID, KFOR etj.

# Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

## VII. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Kemi shpërndarë mbi 900 pako ushqimore për familjet në nevojë. Këto pako janë dhuruar nga organizata e individë të ndryshëm. Gjithashtu përmes grantit qeveritar, masa për rimëkëmbje, komuna jonë ka përfituar 950 pako të tjera ushqimore. Me këto shpërndarje ne kemi mbuluar në tërësi listën e përfituesve të asistencës sociale, por edhe të kategorive të tjera në nevojë. Personat me aftësi të kufizuar, nënat vetushqyese, kategoritë e dala nga lufta, etj., kanë përfituar gjithashtu.

Janë pajisur me veshmbathje 40 fëmijë të familjeve në nevojë, donacion nga KFOR-i Turk.

Pesë familje strehuese janë subvencionuar nga Kryetari i Komunës përmes drejtorisë së shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, me nga 750 Euro, që në total i bie 3750 euro.

Kemi shqyrtuar kërkesat për barëra për muajt janar, shkurt, mars, prill dhe maj. Në janar nga 79 kërkesa, janë aprovuar 52 sosh, ku vlera totale e subvencionimit të tyre arrin 5 mijë e 290 euro. Në muajin shkurt kanë aplikuar 125 persona, ndërsa janë aprovuar 72. Vlera totale është 7 mijë euro. Ndërkaq në muajin mars kanë aplikuar 144 persona, 75 prej tyre janë përfitues, ndërsa 69 janë refuzuar. Në total vlera është 7720 euro. Gjatë muajit prill kanë aplikuar 77 persona, ndër ta përfitues janë 61. Vlera totale është 6440 euro. Ndërkaq në muajin maj, janë aprovuar 51 kërkesa, nga gjithsej 83 aplikantë, dhe shuma totale është 5550 euro. Për këtë muaj, pra qershorin, aplikimet vazhdojnë deri në përfundim të muajit.

Të gjitha kërkesat për subvencionim të qirasë janë shqyrtuar. Nga 85 në total janë aprovuar 57.28 % prej tyre janë nëna vetushqyese. Pagesa për muaj të këtyre familjeve arrin në 4 mijë e 930 euro.
Është në procedurë të prokurimi projekti për dezinfektim, dezinsektim e deratizim (DDD) të hapësirave publike.
Ka filluar kompensimi i orëve të kujdestarisë për punëtorët social, në qendrën për punë sociale. Kjo e drejtë ligjore nuk është zbatuar më herët.

Është pranuar donacioni nga Bashkimi Evropian, implementuar nga UNDP, për rregullimin e arkivës në QPS. Gjithashtu është rimobiluar dhoma e kontaktit prind-fëmijë nga po ky donacion.

Janë ndihmuar 5 familje në nevojë me dru për ngrohje.

Në thirrjen publike për mbështetje financiare për projekte-programe të OJQ-ve, që kontribuojnë në përmirësimin e mirëqenies sociale të qytetarëve, kanë përfituar 6 sosh. (Shoqata Handikos, Shoqata e të Verbërve, Qendra për Hulumtime Psiko-Sociale, NGO Inkluzioni, Organizata për Fëmijë pa Kujdes Prindëror dhe Qendra Edukative për Fëmijë me Nevoja të Veçanta).

Shërbimet e tyre do t'i ofrojnë në sferat e lartcekura, duke ofruar mbështetje profesionale kategorive të parapara në projekte.

Kemi pranuar donacion nga Rotary Klub Gjilani, pajisje shpenzuese mjekësore, për QKMF-në e QMF-të.

Është rikthyer disiplina në institucionet shëndetësore. Vërehet qartazi vijueshmëria e respektimi i orarit. Këtë fakt e konfirmojnë pacientët.

Janë ndaluar orët shtesë të paarsyeshme. Kryerja e çdo inspektimi duhet bërë gjatë orarit të punës.

Është marrë vendim për furnizim të rregullt me barëra dhe mjete të tjera shpenzuese mjekësore për të gjitha QMF-të dhe AMF-të e komunës. Në rast mungese të tyre, përgjegjësia bie mbi shefat e shërbimeve.

Është bërë vendosja e kutive të ankesave në çdo Qendër dhe Ambulantë të Mjekësisë Familjare. Gjithashtu është formuar edhe komisioni për shqyrtimin e tyre.

Janë bërë intervenime teknike, në QMF e AMF. Kemi ndërruar dyer e dritare të demoluara, e gjithashtu jemi në proces intervenimi nëpër rrethoja e fasada të objekteve përkatëse.

Kanë përfunduar kontrollet sistematike nëpër shkollat e qytetit dhe fshatrave për nxënësit e klasave të nënta. Në vitin e ri shkollor, në shtator, fillojmë me kontrollet e rregullta.

Kemi bërë e po bëjmë punë shtesë në funksionalizimin e objektit të ri të QKMF-së. Kemi realizuar shtrimin e asfaltit, ndarjen e parkingjeve, ndarjen e nyjave sanitare. Gjithashtu po punojmë në vazhdimësi për ndarjet e tjera nëpër katet e shërbimeve, si pasojë e keq planifikimit të mëparshëm.

Është nënshkruar memorandum bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi për ndërtimin e një QMF-je në lagjen Arbëria dhe ndërtimin e tetë shtëpive.

Vizita të shumta nëpër QMF-të e qytetit e fshatrave, takime të ndryshme me përfaqësues të OJQ-ve e akterë të tjerë.

Kemi shënuar me aktivitete të shumta ditët simbolike, sikurse ditën e mjekut familjar, ditën e infermierëve, ditën e down syndrome, autizmit, etj.

Në vazhdimësi ka pranuar dhe shqyrtuar kërkesa të ndryshme, për barëra, banim social dhe kërkesa të tjera që ndërlidhen me mirëqenien socio-ekonomike të banorëve të Komunës së Gjilanit.
Statistikat e shërbimeve që janë ofruar për subvencionim me barëra:

- Muaji korrik, 75 kërkesa në total. Të aprovuara 64 sosh. Në total 6090 euro.
- Muaji gusht, 93 kërkesa në total. Të aprovuara 68 sosh. Në total 7890 euro.
- Muaji shtator, 91 kërkesa në total. Të aprovuara 66 sosh. Në total 8100 euro.

Gjithashtu, kemi realizuar projektin për Dezinsektim, Dezinfektim dhe Deratizim (DDD). Projekti është realizuar në tri faza dhe ka pas për qëllim eliminimin apo sjelljen në kufi të tolerancës epidemiologjike të mikroorganizmave të dëmshëm për shëndetin e popullatës.
Kemi realizuar disa rekomandime të dala nga strategjia për përfshirje sociale.
Kemi marrë pjesë në shumë punëtori e trajnime të realizuara nga organizata ndërkombëtare e vendore, OJQ etj.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe Ambulancat e Mjekësisë Familjare

Për herë të parë në komunën tonë kemi bërë ndarjen e ekipit të urgjencës. Tanimë funksionojmë me dy ekipe, ku gatishmëria për shërbime urgjente është rritur 100%. Kemi pranuar donacione të ndryshme dhe jemi furnizuar mirë me aparaturë mjekësore.

Statistikat e shërbimeve të ofruara:

Muaji Korrik

- 15.669 Shërbime të ofruara për pacientë
- 514 shërbime mjekësore në kujdestarinë e fëmijëve
- 1973 intervenime nga ndihma e shpejtë
- 571 shërbime stomatologjike
- 2748 shërbime laboratorike
- 1176 shërbime të ofruara nga ekipi i kujdesit paliativ
- 182 konsulta e shërbime nga qendra e diabetit
- 59 persona të vaksinuar
- 133 vizita në shtëpi- shëndeti i nënës dhe fëmijës
- 704 receta të ekzekutuara

Muaji Gusht

- 18.185 Shërbime të ofruara për pacientë
- 378 shërbime mjekësore në kujdestarinë e fëmijëve

- 1866 intervenime nga ndihma e shpejtë
- 791 shërbime stomatologjike
- 2800 shërbime laboratorike
- 178 shërbime të ofruara nga ekipi i kujdesit paliativ
- 96 persona të vaksinuar
- 87 vizita në shtëpi- shëndeti i nënës dhe fëmijës
- 566 receta të ekzekutuara

Muaji Shtator
- 17. 340 Shërbime të ofruara për pacientë
- 555 shërbime mjekësore në kujdestarinë e fëmijëve
- 1151 shërbime stomatologjike
- 297 shërbime të ofruara nga ekipi i kujdesit paliativ

91 persona të vaksinuar

Qendra për Punë Sociale
- Janë mbajtur komisionet mjekësore për muajt korrik, gusht, shtator ku kanë qenë gjithsej 134 lëndë.
- Prej tyre janë aprovuar 87 lëndë dhe janë refuzuar 47 lëndë, në mungesë të raporteve të bollshme mjekësore.
- Me datën 12 gusht është bërë shpërndarja e 230 pakove ushqimore (lloje të ndryshme të mishrave) nga organizata Islamic Relief Kosova. Përfitues kanë qenë shfrytëzuesit e asistencës sociale.
- Me datë 23 gusht kemi pranuar donacion nga KFORI Turk, ku 23 fëmijë shfrytëzues të asistencës sociale kanë përfituar veshmbathje.
- Me datën 31 gusht është bërë shpërndarja e çantave shkollore. Përfitues kanë qenë 320 fëmijë nga mosha 6 deri 10 vjeç nga klasa parë deri në të pestën.
- Në vazhdën e përkrahjes për shfrytëzuesit e asistencës sociale, me datën 1 shtator, 30 fëmijëve pjesë e kësaj kategorie nga komuna e Gjilanit, ju është siguruar procesi i Phimosis dhe kjo falë donacionit të familjes Zymberi.

Shërbimi social

- Individë e lëndë të trajtuara
- Fëmijë me sjellje asociale 6
- Abuzim i fëmijëve jashtë familjes, fizik, seksual etj. 1
- Kërkesa për birësim me element vendor 1
- Shërbime për ri integrimin e viktimave të trafikimit 1
- Shërbime për viktima të dhunës në familje 40
- Ndihmë në rregullimin e marrëdhënieve bashkëshortore 8
- Dhënia e mendimit për besimin e fëmijëve 12
- Ndihmë në realizimin e kontakteve prind-fëmijë 8
- Fëmijët me aftësi të kufizuara 10
- Shërbime për fëmijë në konflikt me Ligjin 20
- Prezantim në seanca Gjyqësore-Prokurori 40
- Prezantim në Polici 39
- Konsultim me palë 1081 etj.

# Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit Hapësinor dhe Mjedisit

## VIII. Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit Hapësinor dhe Mjedisit

Ky raport paraqet punën e Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit (DUPMM), për periudhën 1 Janar 2022 - 15.06.2022.

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit (DUPMM), në përputhje me kompetencat ligjore, planin vjetor të punës për vitin 2022, si dhe objektivat e përcaktuara në plan, është përqendruar në përmbushjen e Planit të Punës.

Raporti bazohet në të dhënat periodike të sektorëve të DUPMM-së, përkatësisht:

- Sektorit për Punë të Përgjithshme Juridike;
- Sektorit të Urbanizmit dhe
- Sektorit të Planifikimit.

Gjatë periudhës kohore 1 janar 2022 – 15 qershor 2022, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, ka pranuar për shqyrtim **309 lëndë**, nga të cilat **78** lëndë kanë të bëjnë me trajtimin e ndërtimeve pa leje, e të cilat ende nuk kanë hyrë në proces të shqyrtimit, si pasojë e një numri të konsiderueshëm të lëndëve të pa shqyrtuara nga vitet paraprake, prandaj, edhe tani kjo drejtori është në proces të shqyrtimit të lëndëve nga viteve paraprake, konkretisht në proces të shqyrtimit të lëndëve të vitit 2020.

Nga numri i përgjithshëm i kërkesave të pranuara për shqyrtim në këtë periudhë kohore, pa përfshirë numrin e lëndëve të pranuara për trajtimin e kërkesave pa leje ndërtimore, **numri i lëndëve të shqyrtuara është 231, ndërsa në proces të shqyrtimit apo lëndë të cilat ende nuk kanë marrë ndonjë përgjigje nga organi shqyrtues janë 60 lëndë.**

### Aktivitetet sipas sektorëve

1. Sektori për Punë të Përgjithshme Juridike

**Lloji i akteve të përpunuara nga Sektori për Punë të Përgjithshëm Juridike**

| **Emërtimi i aktit** | |
|---|---|
| Vendime për lejimin e ndërtimit – Leje ndërtimore | 48 |
| Vendime për përcaktimin - miratimin e kushteve ndërtimore | 27 |
| Vendime për lejimin e rrënimit – Leje rrënimi | 12 |
| Vendime për përfundimin e procedimit administrativ | 22 |
| Vendime për lejimin e riparimit të objekteve | 3 |
| Vendime për ndryshimin e emrit të poseduesit të lejes ndërtimore | 2 |
| Vendime për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale | 2 |
| Vendime për pezullimin e akteve | 1 |
| Vendime refuzimi | 11 |
| Vendime anulimi | 1 |
| Pëlqime për parcelim | 54 |
| Ekstrakte | 77 |
| Vendime për rivendosjen e afatit të akteve administrative | 1 |
| Vendime për pezullimin e procedurës administrative | 11 |
| Vendime për dhënien e certifikatës së legalizimit | 95 |
| Vendime për korrigjimin e akteve administrative | 10 |
| Vendime për përfshirje në listë të pritjes | 28 |
| Vendime për emërtimin e komisioneve | 3 |
| Vendime për ndryshimin e përbërjes së komisioneve | 4 |
| Propozime për miratim, anulim dhe shfuqizim të vendimeve | 7 |
| Vendime për miratim në Kuvend Komunal | 5 |
| Propozim rregullore për miratim në Kuvend Komunal | 1 |
| Njoftime, lidhur me prezantimin e dokumentacionit | 98 |
| Përgjigje në kërkesë | 18 |
| Përgjigje në kërkesa për qasje në dokumente publike | 4 |
| Kërkesë për transferim të përkohshëm | 2 |
| Kërkesë zyrtare për ofrim të dokumentacionit | 1 |
| Kërkesa | 15 |
| Dërgim i lëndës për shkak të jo kompetencës, organit kompetent | 7 |
| Dërgim i ankesës me shkresa përcjellëse në MMPH | 1 |
| Njoftime | 2 |
| Autorizime | 2 |
| Informata | 15 |
| Gjithsej | 590 |

| Përshkrimi | Realizimi 2021 | Planifikimi 2022 | Realizimi 2022 | Indeksi 3:2 | Indexi 4:3 |
|---|---|---|---|---|---|
| Hartimi i projekteve | 47,032.27 | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| kryesore për infrastrukturë komunale | | | | | |
| Mbikëqyrja dhe zbatimi i projekteve dhe pranimi teknik | 80,662.40 | | | | |
| Hapja e traseve rrugore | 195,000.00 | | | | |
| Hartimi i planeve rregulluese te hollësishme | | | | | |
| Mallra dhe shërbime | | | 25,000.00 | | |
| Gjithsej:(1+4) | 322,694.67 | 0.00 | 25,000.00 | | |

Raporti i shpenzimeve për Komunali D.U.M.M-se - Janar-Shtator 2022

| Përshkrimi | Realizimi 2021 | Planifikimi 2022 | Realizimi 2022 | Indexi (4:2) | Indexi (4:3) |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | | |
| Rryma | 4,166.05 | 6,000.00 | 4,198.28 | 100% | 70% |
| PTK | 324.20 | 400.00 | 434.30 | 134% | 109% |
| Uji | 104.81 | 300.00 | 110.14 | 105% | 37% |
| Mbeturinat | 102.88 | 300.00 | 154.32 | 150% | 51% |
| Gjithesej (4+1) | 4,697.94 | 7,000.00 | 4,897.04 | 104% | 70% |

Raporti i Shpenzimeve për mallra dhe shërbime i D.U.M.M-se Janar- Shtator 2022

| Përshkrimi | Realizimi 2021 | Planifikimi 2022 | Realizimi 2022 | Indeksi 3:2 | Indexi 4:3 |
|---|---|---|---|---|---|
| Dreka | | | | | |
| Furnizime për zyre | 2,229.05 | 3,800.00 | 177.00 | 8% | 5% |
| Shërbime tjera kontraktuese | 960.00 | 206,000.00 | 72,922.31 | 8% | 35% |
| Derivate për gjenerator | | 0.00 | | | 0% |
| Shpenzimet e internetit | | 100.00 | | | 0% |
| Mirëmbajtja e ndërtesave | | | | | 0% |
| Mirëmbajtja e tek. Informative | | 500.00 | | | 0% |
| Shpenzime postare | | 100.00 | | | 0% |
| Pajisje tjera | | 1,000.00 | | | 0% |
| Ushqim dhe pije | 213.84 | 500.00 | 133.60 | 62% | 27% |
| Udhëtime jashtë vendit | | | | | 0% |
| Reklamat dhe konkurset | 360.00 | | | | 0% |
| Kompjuterë | 5,490.00 | 10,000.00 | | | 0% |
| Furnizim me veshmbathje | | | | | 0% |
| Harduerë për tek. Informative | | 500.00 | | | 0% |
| Shërbime të Varrimit | 389.00 | | 389.00 | | 0% |
| Mobileje më pak se 1000 | 11,535.00 | 4000.00 | | | 0% |
| Shërbime shtypi-jo marketing | | 1000.00 | | | 0 |
| Mirëmbajtja e mobileve | | 500.00 | | | 0 |
| Gjithsej | 21,176.89 | 228000.00 | 73,621.91 | 348% | 32% |

Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve I D.U.P.M.M për Janar - Shtator 2022

| Përshkrimi | Realizimi 2021 | Planifikimi 2022 | Realizimi 2022 | Indeksi 3:2 | Indexi 4:3 |
|---|---|---|---|---|---|
| Te Hyrat nga Lejet Ndërtimore | 506,112.33 | 750,000.00 | 246,906.87 | 49% | 33% |
| Te Hyrat nga Taksat-Kërkesat | 1,390.00 | 3,000.00 | 1,339.00 | 96% | 45% |
| Legalizimet | 50,816.72 | 90,000.00 | 27,436.49 | 54% | 30% |
| Te Hyrat nga Lejet Mjedisore | 32,382.00 | 47,000.00 | 20,630.00 | 64% | 44% |
| Te Hyrat nga Rrënimet e objekt. | 4,456.64 | 10,000.00 | 1,904.43 | 43% | 19% |
| Gjithsej: (1+4) | 595,157.69 | 900,000.00 | 298,216.79 | 50% | 33% |
| SHPENZIMET | | | | | |
| Mallra dhe Shërbime | 21,176.89 | 228,000.00 | 73,922.31 | 349% | 32% |
| Komunalit | 4,697.94 | 7,000.00 | 4,897.04 | 104% | 70% |
| Gjithsej: (1+2) | 25,874.83 | 235,000.00 | 78,819.35 | 305% | 34% |
| Investimet Kapitale | 322.694.67 | 196,000.00 | 25,000.00 | 8% | 13% |

# Drejtoria e Inspeksio

IX. Drejtoria e Inspeksionit

## Sfera e Ndërtimit

Duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e sferës së ndërtimit, gjatë kësaj faze janë kryer këto punë:
Inspektim të rasteve në proces të ndërtimit, hartim të procesverbaleve-ndërprerje të punimeve ndërtimore, hartim të procesverbaleve-shiritim të objekteve, dorëzim të vendimeve për ndërprerje të punëve, shqyrtim të kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, shqiptim të gjobave ndaj kundërvajtësve, pranimin-evidentimin dhe kontrollimin e lejeve ndërtimore të pranuara nga sektori i lejeve.

| Përshkrimi i punës | 2022 |
|---|---|
| Procesverbal | 176 |
| Procesverbal për ndërprerje të punëve | 29 |
| Aktvendime për ndërprerje të punëve | 23 |
| Inspektim i objekteve me leje ndërtimi | 56 |
| Leje rrënimi | 04 |
| Procesverbal për ndërprerje të punëve – tejkalim i L.N. | 02 |
| Përgjigje ndaj kërkesave për insp. të punimeve ndërtimore | 449 |
| Ankesa | 12 |
| Gjoba mandatore | 27 |
| Vendim për rrënim | 06 |
| Konkluzion për rrënim | 00 |
| Rrënime | 00 |
| Lëndë për gjykatë – Kallëzim penal | 13 |
| Numri i lejeve të pranuara nga DUPMM | KN – 22 |
| | KN – 22<br>LN – 34<br>LRR – 04<br>MKN – 02<br>VR – 06<br>VPP – 08<br>RLN – 01<br>VRLN – 01 |
| Inspektim sipas UA- 05/2017 | 12 |

| | |
|---|---|
| Procesverbale për ankesa | 01 |
| Procesverbale për mos pagesë gjobe- Gjykatë | 02 |

## Sfera e tregut

Gjatë kësaj periudhe kryesisht jemi fokusuar në identifikimin e bizneseve të reja, të pa pajisura me certifikatë mbi regjistrimin e biznesit.
Po ashtu janë vizituar subjektet afariste të cilat merren me shitjen e produkteve të duhanit për ekspozim të duhanit,  furrat e bukës (pesha e bukës, deklaracioni i bukës, si dhe kemi kryer aksione të përbashkëta me Policinë e Krimeve Ekonomike për kontrollim të rritjes së çmimeve dhe ndryshim të çmimeve raft-arkë.
Janë inspektuar të gjitha parkingjet për regjistrimin e bizneseve dhe pranimet teknike për të gjitha bizneset të cilat nuk posedojnë.
Gjithashtu janë autorizuar për kujdestari për zbatimin e Urdhëresës për mbrojtje nga zhurma.
Kemi marrë kërkesë për Urdhëresën nga Ministria e Tregtisë me nr. 3466- 19/2022 e datës: 06.06.2022.
Kërkesë për largimin e të gjithave lodrave për fëmijë të cilat janë imitim i produkteve ushqimore në formë të shpuzës dhe si të tilla  mund të jenë të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e fëmijëve. Inspektorët e tregut i kanë ndaluar nga shitja këto produkte.
Inspektim i përbashkët me Policinë e Kosovës (njësiti për trafikim me qenie njerëzore); inspektorët e ATK-së, Inspektorët e Punës, Inspektorët sanitarë nga AUV-i si dhe inspektorët e tregut nga Komuna e Vitisë.

Me datën 18.08.2022, kemi pas aksion për uzurpimin e trotuareve në lagjen “Dardania”, Rr.”15 Qershori” ku kemi shqiptuar gjoba.

Gjithashtu sipas kërkesës suaj për zbatimin e UA nr03/2022 të MINT dhe ecurinë e zbatimit të të njëjtit nga pronarët e pikave të karburantit ju njoftojmë se:

1: UA3/22 i cili pati vendosur çmimet të kufizuara dhe ndryshimin në baza ditore për shitjen e naftës, benzinës dhe gazit është zbatuar mirë, saktë nga operatorët ekonomik, pompat e  benzinës.

Inspektorati i Tregut Komunal, ka bërë monitorimin në baza ditore të ndryshimit të çmimit të këtyre operatorëve dhe ka konstatuar se ata po i përmbahen UA dhe po e zbatojnë me rregull.

| Aktiviteti, masat e ndërmarra dhe numri i tyre | 2022 |
|---|---|
| Numri i inspektimeve | 497 |
| Numri i procesverbaleve të hartuara | 198 |
| Numri i gjobave të shqiptuara | 33 |
| Pranime Teknike | 118 |
| Refuzime të pranimeve teknike | 06 |
| Shuma e të hyrave nga pranimet teknike | 6.883 € |
| Numri i ankesave – kërkesave të shqyrtuara | 40 |
| Gjoba mandatore të dërguara për Gjykatë | 06 |
| Aksion me Policinë e Kosovës (kujdestari) | 02 |

## Sfera e komunikacionit

Në këtë periudhë është marrë kryesisht me inspektimin e bartjes publike të udhëtarëve me taksi. Ka qenë pjesë e komisionit për regjistrimin e inventarit të Drejtorisë së Inspeksionit si dhe pjesë e komisionit për performancë komunale për vitin 2021. Në mungesë të inspektorëve të Shërbimeve Publike ka ndihmuar në kryerjen e punëve të inspektorit të shërbimeve publike si dhe është marrë me shqyrtimin e kërkesave të palëve.

## Sfera e Shërbimeve Publike

Në këtë periudhë është marrë kryesisht me inspektimin e hapësirave publike- vendosja e karrigeve dhe tavolinave të vendosura nga kafiteritë, me inspektimin e ndërhyrjes në infrastrukturë publike. Po ashtu është marrë me shqyrtimin e ankesave zyrtare dhe me shqyrtimin e ankesave të palëve.

Gjithashtu kemi pasur bashkëpunim me kompaninë “Hidromorava” në lidhje me ankesa të ndryshme nga qytetarët për ujësjellës dhe kanalizim.

Është bërë inspektimi dhe lirimi i hapësirave publike të cilat shfrytëzohen nga kafiteritë, ku ju konfiskohen përkohësisht tavolinat dhe karriget në tri kafiteri, si dhe shqiptohen pesë gjoba mandatore pemëshitësve të cilët kishin vendosur mallra në trotuare, me inspektimin e ndërhyrjeve në infrastrukturë dhe me shqyrtimin e ankesave zyrtare.

## Sfera e mbrojtjes së Mjedisit

Inspektori i Mbrojtjes së Mjedisit është angazhuar në inspektimin e zakonshëm për shqyrtimin e ankesave verbale, zyrtare, inspektime për Leje Mjedisore Komunale si dhe inspektimet rutinore në bazë të planit të punës.

Gjithashtu, është angazhuar edhe si pjesë e komisionit për pranime teknike të lokaleve si dhe në komisionin e caktuar për vendosjen e pikave të kontejnerëve nëpër qytet.
Janë vizituar të gjitha bizneset ku janë njoftuar për Urdhëresën me të cilën ndalohet hedhja e broshurave- fletëpalosjeve ku janë marrë masa ndëshkuese ndaj subjekteve të cilat nuk e kanë përfillur Urdhëresën.

Në orën e kujdestarisë inspektori i Mjedisit në bashkëpunim me inspektorët e Tregtisë kanë inspektuar zbatimin e Urdhëresës për mbrojtje nga zhurma.
Inspektorët e lartë përmendur kanë bashkëpunuar me inspektorët e ndërtimit dhe të tregut.
Kemi bërë shpërndarjen e Urdhëresës për pagesën e lejes për shfrytëzimin e hapësirës publike.

Është mbajtur takim me Ministrinë e Mjedisit, Krimet mjedisore dhe Policinë e Kosovës në lidhje me ndotjen e ujit në fshatin Livoq i Epërm. Gjithashtu kemi

inspektuar dhe kemi marrë mostra për ndotjen e ujit në këtë fshat. Kemi mbajtur takim me grupin teknik për projektin e Giz për shpërndarjen e komposterëve. Është mbajtur takim me Ministrinë e Mjedisit, përkatësisht inspektorët e Ujërave.

Komision për projektin lidhur me kontejnerët nëntokësorë.

Inspektorët e lartpërmendur kanë bashkëpunuar edhe me inspektorët e tregut si dhe me inspektorin për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga rreziku i përgjithshëm.

Raporti detal për sferën e komunikacionit, shërbime publike dhe mbrojtjes së mjedisit:

| Aktiviteti dhe masat e ndërmarra | 2022 |
|---|---|
| **Numri i inspektimeve** | 812 |
| **Numri i procesverbaleve** | 223 |
| **Numri i kundërvajtjeve** | 21 |
| **Numri i automjeteve të përjashtuara të komunikacionit** | 01 |
| **Numri i gjobave të shqiptuara në total** | 31 (5.590 €) |
| **Numri i aksioneve me Policinë e Kosovës** | 04 |
| **Numri i reklamave të larguara** | 02 |
| **Numri i platove të larguara** | 01 |
| **Numri i kërkesave të pranuara** | 50 |
| **Numri i kërkesave të shqyrtuara** | 39 |
| **Numri i kërkesave në shqyrtim** | 13 |

| Përshkrimi | Vlera në Euro |
|---|---|
| **Të hyrat e realizuara gjatë periudhës nëntëmujore 2022** | 23,422 € |
| **Të hyrat e realizuara gjatë periudhës nëntëmujore 2021** | 17.382 € |
| **Dallimi për 9 mujorin e vitit 2021 krahasuar me 2022** | 6.040 € |

# Drejtoria për Buxhet dhe Financa

## X. Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Planifikimet

- 29,075,279.00 € - Buxheti i planifikuar për vitin 2022
- 16,199,142.00 € - Pagat e planifikuara për 2479 të punësuar
- 4.727.834,00€- Mallra dhe Shërbime
- 576,800.00 € - Shpenzime Komunale
- **970,000.00 € - Subvencione**
- **5.841.502,00€ - Shpenzime kapitale**
- **760.000,00€ - Rezervat**

**29.075.278,00€ - Financimi i planifikuar**

- **24.605.224,00€ - Grantet**
- **4.470.054,00€ - Të hyrat vetanake vitit 2021**

**Buxheti i planifikuar për vitin 2022 (Buxheti përfundimtar me mjete nga Grandi, mjete vetanake të vitit 2022, mjetet e bartura, donacione dhe participim i qytetarëve)**

**Burimi i financimit përfundimtar - 31.097.388,03€**

- **24.760.334,21€ - Grandet**
- **4.470.054,00€ - Të hyrat vetanake të vitit 2021**
- **1.744.452,65€ - Të hyrat e bartura**
- **122.547,17€**

Buxheti në mënyrë sintetike është shpenzuar

**Zyra e Kryetarit:**

31.097.388,03€

- 16.386.810,18 € - Pagat dhe mëditjet
- 5.286.799,89€ - Mallrat dhe shërbimet
- 612.728,04€ - Shpenzimet komunale
- 1.302.948,28€ - **Subvencionet**
- 7.508.101,64€ - Shpenzime Kapitale

**Buxheti i shpenzuar - 19.290.624,31€**

- **10.605.537,28€** - Pagat e Administratës Komunale, Arsimit dhe Shëndetësisë
- **2.959.870,77€ - Mallra dhe shërbime**
- **367.764,78€ - Shpenzime komunale**
- **802.084,08€ - Subvencionet**
- **4.555.367,40€ - Shpenzime kapitale**

| | |
|---|---|
| -Pagat | 172.234,78€ |
| -Mallra dhe shërbime | 90.160,10€ |
| -Shpenzime komunale | 2.931,36€ |
| -Subvencionet | 85.387,61€ |
| **Gjithsej shpenzimet** | **350.713,85€** |

### Drejtoria e Administratës së përgjithshme:

| | |
|---|---|
| Pagat | 172.754,37€ |
| Mallra dhe shërbime | 271.992,13€ |
| Shpenzime komunale | 11.609,69€ |
| Shpenzime kapitale | 58.157,89€ |
| **Gjithsej shpenzimet** | **514.514,08€** |

### Inspekcioni:

| | |
|---|---|
| Pagat | 73.898,42€ |
| Mallra dhe shërbime | 100.630,96€ |
| Shpenzime komunale | 2.786,37€ |
| **Gjithsej shpenzimet** | **177.315,75€** |

### Zyra e prokurimit:

| | |
|---|---|
| Pagat | 43.654,62€ |
| Mallra dhe shërbime | 409,78€ |
| Shpenzime komunale | 0,00€ |
| **Gjithsej shpenzimet** | **44.064,40€** |

### Zyra e kuvendit:

| | |
|---|---|
| Pagat | 103.481,77€ |
| Mallra dhe shërbime | 3.745,20€ |

| | |
|---|---|
| **Gjithsej shpenzimet** | **107.226,97€** |

## Drejtoria për Buxhet dhe Financa

| | |
|---|---|
| Pagat | 128.422,77€ |
| Mallra dhe shërbime | 28.127,94€ |
| Shpenzime komunale | 3.102,69€ |
| **Gjithsej shpenzimet** | **159.653,40€** |

## Drejtoria për Shërbime publike, Infrastrukturë dhe Banim

| | |
|---|---|
| Pagat | 49.023,45€ |
| Mallra dhe shërbime | 624.888,05€ |
| Shpenzime komunale | 148.601,26€ |
| Subvencionet | 148.773,00€ |
| Shpenzime kapitale | 1.047.422,94€ |
| **Gjithsej shpenzimet** | **2.018.708,70€** |

## Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

| | |
|---|---|
| Pagat | 196.020,21€ |
| Mallra dhe shërbime | 76.601,32€ |
| Shpenzime komunale | 2.791,43€ |
| **Gjithsej shpenzimet** | **275.412,96€** |

## Zyra lokale e komuniteteve

| | |
|---|---|
| Pagat | 33.909,45€ |
| Mallra dhe shërbime | 0,00€ |
| Shpenzime Komunale | 72,25€ |
| **Gjithsej shpenzimet** | **33.981,70€** |

## Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë

| | |
|---|---|
| Pagat | 104.010,07€ |
| Mallra dhe shërbime | 12.351,06€ |
| Shpenzime komunale | 2.151,04€ |
| Subvencionet | 48.179,60€ |

| | |
|---|---|
| Shpenzime kapitale | 0.00€ |
| **Gjithsej shpenzimet** | **166.691,77€** |

### Drejtoria për Zhvillim ekonomik

| | |
|---|---|
| Pagat | 58.061,69€ |
| Mallra dhe shërbime | 51.081,68€ |
| Shpenzime komunale | 274,17€ |
| Shpenzime kapitale | 667.901,73€ |
| **Gjithsej shpenzimet** | **777.319,27€** |

### Drejtoria për Gjeodezi,Kadastër dhe Pronë

| | |
|---|---|
| Pagat | 94.437,48€ |
| Mallra dhe shërbime | 5.013,30€ |
| Shpenzime komunale | 299,95€ |
| Shpenzime kapitale | 2.504.662,23€ |
| **Gjithsej shpenzimet :** | **2.604.412,96€** |

### Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

| | |
|---|---|
| Pagat | 84.919,01€ |
| Mallra dhe shërbime | 73.621,91€ |
| Shpenzime komunale | 4.545,16€ |
| Shpenzime kapitale | 25.000.00€ |
| **Gjithsej shpenzimet:** | **188.086,08€** |

### Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

| | |
|---|---|
| Pagat | 28.164,64€ |
| Mallra dhe shërbime | 17.733,44€ |
| Shpenzime komunale | 3.420,65€ |
| Subvencionet | 131.280,30€ |
| **Gjithsej shpenzimet** | **180.599,03€** |

### Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

| | |
|---|---|
| Pagat | 1.750.833,47€ |
| Mallra dhe shërbime | 419.756,57€ |
| Shpenzime komunale | 46.379,52€ |
| Shpenzime kapitale | 141.985,74€ |
| **Gjithsej shpenzimet** | **2.358.955,30€** |

### Qendra për Punë Sociale

| | |
|---|---|
| Pagat | 59.093,39€ |
| Mallra dhe shërbime | 3.293,40€ |
| Shpenzime komunale | 2.190,28€ |
| **Gjithsej shpenzimet:** | **64.577,07€** |

### Kulturë, Rini dhe Sport

| | |
|---|---|
| Pagat | 105.717.98€ |
| Mallra dhe shërbime | 58.090,87€ |
| Shpenzime komunale | 25.851,95€ |
| Subvencionet | 233.069,57€ |
| **Gjithsej shpenzimet** | **422.730,37€** |

### Teatri

| | |
|---|---|
| Pagat | 97.175,41€ |
| Mallra dhe shërbime | 49.225,17€ |
| Shpenzime komunale | 3.443.69€ |
| Subvencione | 6.000,00€ |
| **Gjithsej shpenzimet** | **155.844,27€** |

### Drejtoria Komunale e Arsimit

| | |
|---|---|
| Pagat | 80.280,34€ |
| Mallra dhe shërbime | 587.432,57€ |
| Shpenzime komunale | 11.575,00€ |
| Subvencionet | 149.394,00€ |

| | |
|---|---|
| Shpenzime kapitale | 110.236,87€ |
| **Gjithsej shpenzimet** | **938.918,78€** |

### Arsimi parashkollor:

| | |
|---|---|
| Pagat | 386.192,52€ |
| Mallra dhe shërbime | 92.061,21€ |
| Shpenzime komunale | 20.549,63€ |
| **Gjithsej shpenzimet** | **498.803,36€** |

### Arsimi fillor:

| | |
|---|---|
| Pagat | 4.885.149,69€ |
| Mallra dhe shërbime | 273.345,26€ |
| Shpenzime komunale | 51.541,78€ |
| Shpenzime kapitale | 0.00€ |
| **Gjithsej shpenzimet:** | **5.210.036,73€** |

### Arsimi i mesëm:

| | |
|---|---|
| -Pagat | 1.898.101,75€ |
| -Mallra dhe shërbime | 120.308,85€ |
| -Shpenzime komunale | 23.646,91€ |
| **Gjithsej shpenzimet:** | **2.042.057,51€** |

## XI. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik vlerëson periudhën 1 vjeçare të vitit të parë si jashtëzakonisht pozitive, sa i përket të arriturave të drejtorisë dhe realizimit të planit vjetor të punës.

Rezultatet e arritura kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik lokal dhe në ngritjen e standardit të jetesës së qytetarëve të komunës së Gjilanit.

### INVESTIMET KAPITALE

Sa i përket investimeve kapitale, është arritur një sukses i jashtëzakonshëm pasi janë 11 projekte të reja infrastrukturë publike dhe sociale të cilat do të realizohen në bashkë-financim me Komunën e Gjilanit dhe me mbështetjen financiare nga niveli qendror dhe donatorë.

Komuna e Gjilanit, respektivisht DZHE do të bashkë-financoj projektet prioritare të cilat do të realizohen përmes Grantit të Perfomancës Komunale në vlerën prej 1,028,119.41 (€) nga te cilat 864,306.35 (€) do të financohen nga MAPL ndërsa bashkë-financimi i Komunës (DZHE) 163,813.06 (€) për projektet si në vijim:

#### Projekti 1 "Kanalizimi fekal Livoq i Eperm Livoq i Ulët dhe një pjesë e lagjës Kodra e Thatë".

Projekti  i propozuar ka vlerën e përgjithshme 455,610.88 (€), prej të cilave 384,335.28 (€) do të financohet nga Granti i MAPL, ndërsa shuma prej 71,275.60 (€) do të bashkë-financohet nga Komuna e Gjilanit. (DZHE)

#### Projekti 2 "Terrenet sportive''

Projekti i propozuar ka vlerën e përgjithshme 359, 889.75 (€), prej të cilave 288,614.15 (€) do të financohet nga Granti i MAPL, ndërsa shuma prej 71,275.60 (€) do të bashkë-financohet nga Komuna e Gjilanit.(DZHE)

Vlen të përmendet se janë gjthësej, 7 terrene sportive  te cilat do të realizohen në hapësirat shkollore në qytet dhe fshatra :

1. SHFMU " Skënderbeu" Verbicë e Kmetovcit
2. SHFMU "Sadullah Brestovci " ,Gjilan,
3. SHFMU "Bajram Curri ", Shurdhan,
4. SHFMU "Vesel Muji", Mihir
5. SHFMU "AFËRDITA " Kishna Pole,
6. SHFMU "Fetah Qerimi" Vërbicë e Zhegovcit
7. SHFMU "Zija Shemsiu ", Gjilan

#### Projekti 3. "Asfaltimi i rrugëve në fshatin Cërnicë''

Projekti i propozuar ka vlerën e përgjithshme 89,851.03 (€), prej të cilave 80,865.93 (€) do të financohet nga Granti i MAPL, ndërsa shuma prej 8,985.10 (€) do të bashkë-financohet nga Komuna e Gjilanit. (DZHE)

#### Projekti 4."Asfaltimi i rrugëve në fshatin Haxhaj''

Projekti i propozuar ka vlerën e përgjithshme 122,767.75 (€), prej të cilave 110,490.99 (€) do të financohet nga Granti i MAPL, ndërsa shuma prej 12,276.76 (€) do të bashkë-financohet nga Komuna e Gjilanit. (DZHE)

Një sukses tjetër i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik është aplikimi në projektin propozim për thirrjen e MAPL "Programi për mbështetje për projektet infrastrukturore për komunitete në komunat e Republikës së Kosovës"  ( I REALIZUAR)

#### Projekti 5."Asfaltimi i rrugës Livoq i Ulët- Livoq i Epërm (Gjilan)"

Aplikimi nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka rezultuar i suksesshëm dhe Marrëveshja për Financim është nënshkruar në mes të Komunës së Gjilanit dhe MAPL me 26 maj 2022. Ky projekt ka buxhetin prej 60,889.72 €, prej të cilave 50,000.00 € financohen nga MAPL, ndërsa shuma prej 10,889.72 € do të bashkë-financohet nga Komuna e Gjilanit (DZHE). Drejtoria ka përgatitur dokumentacionin teknik për inicim të procedurave të prokurimit dhe realizimi i projektit pritet të filloj gjatë këtij viti. (I  REALIZUAR)

#### Projekti 6. " Ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë familjare në lagjën Arbëria"

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik do të bashkë financoj me vlerën prej 72.000 € për vitin 2022 në bashkëpunim me organizatën "Bamirësia e Katarit" (QATAR CHARITY) sipas Marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Komunës së Gjilant dhe organizatës në fjalë me 6 Qershor 2022.

### Projekti 7. "Modernizimi i tregut të gjelbërt"

Projekti për modernizimin e "Tregut të gjelbërt" i cili është në fazën finale të punimeve dhe pritet të përfundoj brenda një afati të shkurtër kohor. Ky projekt me infrastrukturë bashkëkohore do të ndikoj jo vetëm në përmirësimin e kushteve për shitjen e produkteve të freskëta të prodhuesve tanë por edhe do ta transformoj plotësisht atë paraprak duke e bërë atraktiv për qytetarë dhe vizitorë. Me iniciativë të NPL "Tregu" si dhe kërkesat e tregtarëve për zgjerim të kapaciteteve për infrastrukturore të tregut janë shtuar edhe 18 lokale të cilat do të plotësojnë nevojat dhe kërkesat e tregtarëve për hapësira pune.

### Projekti 8. "Tregu i Kafshëve''

Projekti "Tregu i kafshëve" financuar nga BE dhe bashkëfinancuar nga DZHE, Komuna e Gjilanit është në proces të realizimit të punimeve. Me ndërtimin e tregut të kafshëve dhe infrastrukturës përcjellëse(asfaltimi, ndriqimi, trotuaret, rrjeti kanalizimit dhe ujësjellësit) do të hapen mundësi të reja punësimi, kryesisht fermerë numri i të cilëve është rreth 2,000 të cilët sigurojnë të ardhura përmes blegtorisë. Ky projekt do të ndikoj edhe në përmirësimin e konkurueshmërisë në ekonominë lokale duke krijuar kushte dhe ngritur standardet për shitje jo vetëm në tregun lokal por edhe ndër-komunal e rajonal.

### Projekti 9 ''Tregu i gjelbërt dhe parku në fshatin Zhegër"

Projekti "Tregu i gjelbërt dhe parku" në fshatin Zhegër është në proces të finalizimit të ekzekutimit të punimeve të nyjeve sanitare(zyre administrative, depo për mjete te punës te mirëmbajtjes se tregut, tualete) dhe do të hyj në funksion së shpejti. Punimet ne aspektin infrastrukturor ne pjesën e aneksit tek tregu ne fshati Zheger kane përfunduar dhe pritet te behet pranimi teknik i hapësirës se tregut dhe te behet hapja e tregut. Ky treg do të jetë një ndihmesë e madhe për të gjithë bujqit dhe qytetarët nga fshatrat përreth.

(Projekti i përfunduar i gatshëm për bartjen e kompetencave te NPL "Tregu")

### Projekti 10 "Shëtitorja mbi lumin Mirusha – pjesa jug faza 2"

Ka vazhduar realizimi i projektit "Shëtitorja mbi lumin Mirusha –pjesa jug faza 2" dhe punimet janë duke u realizuar me një dinamikë të kënaqshme. Ky projekt do të ndikoj pozitivisht në stimulimin e zhvillimit të bizneseve të reja përgjatë shëtitores si dhe krijon mundësi dhe më shumë hapësira publike në shërbim të qytetarëve të Komunës së Gjilanit.

### Projekti 11 "Qendra Kulturore për Komunitete''

Projekti "Qendra Kulturore për Komunitete" financuar nga MZHR dhe bashkë financuar nga DZHE dhe parasheh realizimin e punimeve respektivisht renovimin e objektit "Teknika popullore". Ky objekt është në listën e aseteve të trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përhershme dhe Drejtoria për Zhvillim Ekonomik është përkujdes për të përmbush të gjitha

kërkesat ligjore për t'i hap rrugë zbatimit të projektit. DZHE ka organizuar një varg takimesh me zyrtar relevant si dhe ka angazhuar ekspertë për hartimin e projektit zbatues në përputhje me kërkesat e Departamentit te Trashëgimisë Kulturore / MKRS dhe ka arritur të pajiset me leje nga institucioni në fjalë. Drejtoria ka parashtruar kërkesë MZHR për vazhdimin e projektit "Qendra Kulturore për Komunitete" në kuadër të "Programit për Zhvillim Rajonal 2021" dhe sipas projektit zbatues vlera e përgjithshme e projektit është 86,127.50 Euro prej të cilave 68,902.00 Euro ose 80% e vlerës do të financohen nga Ministria e Zhvillimit Rajonal ndërsa shuma prej 17,225.50 Euro ose 20% do të bashkë-financohet nga Komuna e Gjilanit (DZHE).

Gjatë këtij viti, Komuna e Gjilanit ka arrit Marrëveshje me MMPHI për realizimin e 10 projekteve tjera infrastrukturore me bashkë-financim nga Komuna (DZHE). Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka planifikuar buxhet dhe ka siguruar deklaratën e disponushmërisë së mjeteve në tërësinë e vlerës sipas Marrëveshjes për projektet siç janë prezantuar në tabelën nr. 1 të prezantuar më poshtë.

| Titulli i projektit | Vlera e projektit në euro (€) | Financimi nga MMPHI | Bashkë-financimi nga komuna (DZHE) |
|---|---|---|---|
| Asfaltimi i rrugëve në fshatrat e Gjilanit (Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadish) | 100,000.00 | 100,000.00 | |
| Asfaltimi i rrugëve në qytetin e Gjilanit (Asfaltimi i rrugëve në lagjen "Vishnjet") | 108,410.00 | 67,764.00 | 40,464.00 |
| Asfaltimi i rrugës në fshatin Kokaj-Gjilan | 100,000.00 | 100,000.00 | |
| Asfaltimi i rrugës në fshatin Malishevë e Ulët Faza-2 | 174,565.00 | 140,000.00 | 34,565.00 |
| Rruga "Jonuz Tvrstena", 28 Nentori dhe krahet 1-5 si dhe kanalizimi fekal | 308,100.00 | 250,000.00 | 58,100.00 |
| Asfaltimi i rrugëve "Qefsere Salihu" dhe "Blerim Halili" | 289,196.00 | 204,000.00 | 55,196.00 |
| Asfaltimi i rrugëve në lagjen "Livadhet e Arapit" | 301,580.00 | 250,000.00 | 51,580.00 |
| Asfaltimi i rrugëve në fshatin Burincë | 345,685.00 | 280,000.00 | 65,685.00 |
| Rregullimi i trotuarit dhe Ndriqimit (Haxhaj -Demiraj) | 179,000.00 | 143,200.00 | 35,800.00 |
| Projekti kryesor për rrugen -Nëna Terezë | 512,625.00 | 410,100.00 | 102,525.00 |
| **Totali** | **2,419,161.00** | **1,945,064.00** | **443,915.00** |

## SEKTORI I EFIÇIENCËS SË ENERGJISË

Një tjetër sektor tejet i rëndësishëm i kësaj drejtorie është edhe Efiçienca e Energjisë . Gjatë kësaj periudhe kemi bashkëpunuar ngushtë me Ministrinë e Ekonomisë dhe KFW (Banka Gjermane), për fillimin e zbatimit të masave të EE në objektet publike, respektivisht në shkollat "Liria", Pogragjë, "Ibrahim Uruqi", Bresalc dhe "Dëshmorët e Kombit", Livoq i Ulët. Sipas Ministrisë së Ekonomisë së shpejti pritet të nënshkruhet Marrëveshja 3 palëshe ndërmjet Komunës, ME dhe KFW për fillimin e zbatimit të projekteve të lartpërmendura.

Gjithashtu, Programi "Fondi i Kosovës për Efiçiencë të Energjisë (FKEE) për masat e EE" në shkollat "Mehmet Isai" dhe "Rexhep Elmazi", vazhdon nga viti paraprak derisa gjatë kësaj periudhe kohore ka vazhduar bashkëpunimi dhe rishtazi kemi përzgjedh skenarin më të favorshëm për realizim të masave në shkollën "Abaz Ajeti", në koordinim me kryetarin e Komunës. Në koordinim të ngushtë me DKA dhe drejtorët e shkollave, kanë filluar të realizohen punimet.

DZHE, ka realizuar disa vizita në dy objektet-shkollat për të parë nga afër punimet pasi një komision i veçantë komunal mbikëqyr punën e OE, kontraktuar nga FKEE-së. Gjatë kësaj periudhe në shkollën "Mehmet Isai" janë ndërruar të gjitha dritaret e shkollës, si dhe janë në përfundim të fasadimit të shkollës ( ka mbetur edhe një pjesë e fasadës në pjesë e brendshme të oborrit derisa instalimet makinerike si dhe ato të elektrikes sipas organit mbikëqyrës të kompanisë "2A Group" sh.p.k priten të përfundojnë së shpejti.

Ndërsa në shkollën "Rexhep Elmazi", janë ndërruar 80% e dritareve si dhe kanë filluar me punët e fasadimit, në proces të vendosjes së termoizolimit dhe në disa pjesë janë duke u bërë përgatitjet për fasadë.

Projektet e lartpërmendura në fushën e EE, synojnë intervenimin me masa të efiçiencës së energjisë në objektet shkollore duke mundësuar kursimin e konsiderueshëm të energjisë dhe realizimi i të cilave do të ndikoj në krijimin e vendeve të punës në sektorin e ndërtimtarisë.

Programi tjetër me MFK, projekti SEEK, komponentë HER për intervenim me masa të EE në një shtëpi banimi (raste social) në fshatin Pogragjë ku janë përfunduar punimet dhe së shpejti do të përmbyllet ky projekt gjatë muajve të ardhshëm. Në kuadër të këtij projekti kanë qenë të planifikuara pesë shtëpi banimi ku katër prej tyre kanë përfunduar vitin e kaluar dhe kjo e fundit është përmbyllur me sukses këtë vite me marrëveshjen me MFK SEEK-HER. Sipas Marrëveshjes janë përmbyll me sukses të gjitha projektet dhe gjatë kësaj periudhe kohore është finalizuar raporti final i cili është në dispozicion në DZHE.

## MARRËVESHJET E REALIZUARA

- Me datën 14.03.2022 është nënshkruar marrëveshja ndërmjet GIZ dhe Komunës së Gjilanit për realizimin e Planit Komunal për Energji dhe Klimë, në kuadër të Projektit të Asociacionit të Komunave të Kosovës "Projekti për mbështetje të Komunave të Kosovës në rritjen e kapaciteteve në hartimin e Planeve Komunale për Energji dhe Klimë" të mbështetur nga Qeveria Gjermane përmes GIZ, dhe Komuna e Gjilanit është përzgjedh si njëra ndër pesë komunat e Kosovës që do të asistohet në hartimin e këtij plani. Vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe GIZ ka përfunduar procedurat e prokurimit për përzgjedhjen e operatorit ekonomik për fillimin e hartimit të planit për energji dhe klimë të komunës së Gjilanit. Me inicimin e DZHE-se (menaxheri i projektit për Energji dhe Klimë) në bashkëpunim me zyrën e Kryetarit të Komunës, është formuar grupa punuese nga zyrtarët e drejtorive komunale për të siguruar informata dhe të dhëna për realizimin e planit komunal për Energji dhe Klimë.
- Me 20.05.2022 është nënshkruar Marrëveshja në mes të Komunës së Gjilanit dhe Caritas-it zviceran për zbatimin e projektit MARDI "Veprimi i Komunave për Riintegrim dhe Diasporë", i cili do të bashkë-financohet nga DZHE.
- Marrëveshja me MMPHI për 10 projekte
- Komuna e Gjilanit dhe MMPHI me datë 26.05.2022 ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi për financimin e projekteve infrastrukturore.
- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, do të bashkë-financoj realizimin e Planit Komunal për Energji dhe Klimë të financuar nga GIZ.
- Gjithashtu Drejtoria për Zhvillim Ekonomik do të mbështes financiarisht aktivitetin e DBPZHR për trajtimin e qenve endacak.

## AKTIVITET E REALIZUARA

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik gjatë periudhës 1 vjeçare ka ndërmarrë veprime për organizimin e një numri të madh të aktiviteteve përfshirë vizitat të shumta bizneseve,

ndërmarrjeve publike si dhe takime të shumta në mes institucioneve publike, lokale dhe organizata jo qeveritare, donator, shoqëri civile, komunitet të bizneseve, me qëllim të koordinimit për zhvillimin e projekteve të ndryshme për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik, lokal të Komunës së Gjilanit.

Sidoqoftë, një prej aktiviteteve më të rëndësishme të DZHE është panairi "E JONA" të mbajtur me datën 27-29 Korrik 2022, në qendër te qytetit dhe në palestrën sportive të qytetit të Gjilanit. Panairi kishte në përmbajtje: Panair dhe B2B, panair shitës dhe B2C i përcjellur me festë të birrës, me festë të verës, me ushqim dhe me koncert festiv për mirëseardhje të diasporës sonë dhe gjithë vizitorëve e mysafirëve të qytetit të Gjilanit. Qëllimi i panairit "E JONA" e që do të jete tradicional, qëllimi kryesor ishte që prodhuesit shqiptarë kudo që janë, ta kenë një vendtakim në të cilin do të njoftohen rreth veprimtarisë së njëri tjetrit dhe të ndërtojnë relacione bashkëpunimi për shkëmbimin dhe shpërndarjen e ndërsjellë të produkteve të veta në mbarë tregun shqiptar që përfshinë rreth 7 milionë banorë. Gjithashtu, në panair ishin të ftuar në cilësinë e ekspozuesve dhe vizitorëve bizneset e diasporës shqiptare, të cilat janë shumë të interesuara për t'i eksportuar prodhimet shqiptare në shtetet e jashtme ku ata veprojnë.

Një aktivitet tjetër i rëndësishëm i drejtorisë është përkujdesi për zbatim të kontratës së koncesionit për projektin PPP me titull "Rregullimi i infrastrukturës së kompleksit të shkollave të mesme në Komunën e Gjilanit" të datës 11.12.2015 me nr. të protokollit 1687, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik i ka parashtruar kërkesë Koncesionarit "Adea Fast Food" sh.p.k për pagesë të këstit të parë të tarifës së koncesionit për vitin 2021 sipas nenit IV "Kompensimi për të drejtat e koncesionerit". Bazuar në Pasqyrat Financiare dhe Raportin e Auditort të Pavarur të "ADEA Fast Food" sh.p.k për vitin 2021, të bruto të realizuara për vitin 2021 kanë qenë 169,844.00 euro.

Bazuar në nenin IV dhe pasqyrat financiare të audituara, obligimi i koncensionarit për pagesë të tarifës së koncesionit për vitin 2021 është në vlerë prej 1% e të hyrave bruto të realizuara për vitin 2021, që kapin vlerën gjithsej 1,698.44 Euro.

Kjo pagese kryhet në dy këste në fillim të muajit korrik 849.22€. dhe ne fillim te muajit janar me vlerë 849.22€. Vlen të përmendet se pas pranimit të kërkesës, Koncesionari ka kryer obligimin e këstit të parë sipas Kontratës.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka bashkëpunuar ngushtë me Projekt Menaxherin e Ekipit për Menaxhim të Projektit (EMP) PPP si dhe koncesionarin dhe po ashtu edhe me departamentin për Partneritet Publiko Privat- Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve të cilët kanë ofruar asistencë të vazhdueshme Komunës së Gjilanit në mbikëqyrjen e projekteve PPP.

## Agjenda Evropiane

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka ofruar të dhëna zyrës për integrime evropiane në lidhje me përmbushjen e standardeve të agjendës Evropiane si një prej prioriteteve kryesor për Republikën e Kosovës. Të gjitha të dhënat janë inkorporuar në matricën kornizë përfshirë komentet në lidhje me statusin e dokumenteve strategjike të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik.

Me kërkesë të DUPMM dhe bazuar në nevojat për investime në Komunën e Gjilanit, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik në linjë edhe me prioritetet e kryetarit z. Hyseni, ka propozuar hartimin e disa projekteve me qëllim të jenë "të gatshme" për aplikim në thirrje për projekt propozime, qoftë nga niveli qendror apo donator në të ardhmen. Një prej kritereve që duhet të përmbushen për aplikim të suksesshëm me projekte tek donatorët, është që në fazën e aplikimit të kemi të paktën projektin ideor derisa projekti zbatues do të ishte avantazh për drejtorinë.

Projektet e propozuara për hartim nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik janë si në vijim:

- Ndërtimi i Zonës Ekonomike
- Projektet për 3 Çerdhe në lokacionet si: te livadhet e Arapit, Fidanishte dhe rr.e Ferizajit
- Renovimi i Konviktit të studentëve (përfshirë masat e Efiqiencës së Energjisë)
- Renovimi i parkut te palestra e sporteve "Bashkim Selishta-Petriti"
- Rregullimi i parkut në Velekincë (te pishat)
- Rregullimi dhe zgjerimi i parkut përfshirë hapësirat për parkingje në lagjen "Arbëria"

- Projekti për rregullimin e kanalizimit për eliminimin e ujërave të zeza nga penda e Livoqit
- Ndërtimi i tregut ditor “te Kisha”
- Rregullimi i shtratit të lumit  dhe ndërtimi i dy urave në fshatin Zhegër
- Ndëritimi i një urë në fshatin  Lladovë.
- Ndërtimi i terrenit sportiv në Zhegër
- Zgjerimi dhe ndërtimi i urës në fshatin Çelik
- Ndërtimi i sallës së Edukatës Fizike në sh.f.m.u “Sadullah Brestovci”
- Restaurimi i kishës katolike ‘’Shën Ana’’ në fshatin Dunav, si dhe asfaltimi i rrugës
- Asfaltimi i rrugës Livoq i Epërm - Gumnisht

Në vazhdimësinë e aktiviteteve te Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik  bën pjesë edhe pjesëmarrja në punëtori të ndryshme të organizuara nga organizata vendore dhe ndërkombëtare ashtu dhe punëtori të organizuara nga MZHR, MAPL, MINT, AKK, UN HABITAT etj.

## QENDRA PËR REGJISTRIMIN E BIZNESEVE

Në Qendrën për Regjistrimin e Bizneseve gjatë kësaj periudhe  nëntë mujore Janar-Shtator 2022, janë regjistruar 450 biznese të reja dhe 719 punëtorë derisa janë shuar 83 biznese.

Shih tabelën me nr.2:

| QENDRA E REGJISTRIMIT BIZNESIT - GJILAN | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| RAPORTI 01.01.2022 -31.09.2022 | | | | | | | | | | | | | |
| Të regjistruara 2022 | | | | | | | | | | | | | |
| Emertimet | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nentor | Dhjetor | Gjithësej |
| Prodhuese | 14 | 6 | 6 | 9 | 8 | 8 | 11 | 5 | 7 | 0 | 0 | 0 | 74 |
| Tregtare | 11 | 18 | 14 | 11 | 11 | 5 | 6 | 6 | 7 | 0 | 0 | 0 | 89 |
| Shërbyese | 21 | 24 | 24 | 29 | 30 | 40 | 40 | 21 | 24 | 0 | 0 | 0 | 253 |
| Ndërtimore | 6 | 6 | 8 | 3 | 2 | 2 | 6 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 34 |
| Gjithësej: | 52 | 54 | 52 | 52 | 51 | 55 | 63 | 33 | 38 | 0 | 0 | 0 | 450 |
| Pronar femra | 16 | 10 | 7 | 12 | 13 | 12 | 18 | 2 | 10 | 0 | 0 | 0 | 100 |
| Pronar meshkuj | 72 | 85 | 86 | 64 | 72 | 79 | 47 | 31 | 27 | 0 | 0 | 0 | 563 |
| Puntorë në Biznes | 88 | 95 | 93 | 76 | 85 | 91 | 92 | 48 | 51 | 0 | 0 | 0 | 719 |
| Emertimet | Të ç'regjistruara 2022 | | | | | | | | | | | | |
| | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | | Nentor | Dhjetor | Gjithësej |
| Prodhuese | 0 | 0 | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 5 |
| Tregtare | 1 | 5 | 7 | 2 | 2 | 0 | 0 | 3 | 1 | 0 | 0 | 0 | 21 |
| Shërbyese | 2 | 4 | 6 | 5 | 16 | 5 | 5 | 6 | 5 | 0 | 0 | 0 | 54 |
| Ndërtimore | 0 | 1 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 |
| Gjithësej: | 3 | 10 | 17 | 8 | 18 | 5 | 5 | 9 | 8 | | 0 | 0 | 83 |
| Pronar meshkuj | 4 | 9 | 13 | 7 | 13 | 4 | 5 | 0 | 5 | 0 | 0 | 0 | 60 |
| Pronar femra | 0 | 1 | 4 | 1 | 5 | 0 | 0 | 6 | 0 | 0 | 0 | 0 | 17 |
| Puntorë | 4 | 16 | 20 | 11 | 21 | 4 | 16 | 11 | 8 | 0 | 0 | 0 | 111 |

Me 14 mars 2022, Ministria e Zhvillimit Rajonal ka lansuar skemën e granteve - programi për zhvillim rajonal të balancuar (PZHRB 2022). Drejtoria ka këshilluar aplikantët e interesuar për procedurat e aplikimit për Start UP dhe Bizneseve Ekzistuese LOT I dhe LOT II.

## ZONA EKONOMIKE INDUSTRIALE

Komuna e Gjilanit ka identifikuar dhe përcaktuar lokacionin me sipërfaqe 146 hektarë pronë komunale për krijimin e një zonë ekonomike industriale me synim të krijoj infrastrukturë moderne si parakusht për tërheqjen e invesitorëve të jashtëm dhe të brendshëm. Zonë Ekonomike që përfshin trekëndëshin mes Livoqit të Epërm, Gllamës e Bresalcit, ku brenda saj inkuadrohet dhe autostrada Gjilan-Prishtinë, me qëllim lehtësimin e transportit e qasjes në mallra e shërbime. Gjatë kësaj periudhe të raportimit ka filluar realizimi i studimit të fizibilitetit i cili i hap rrugë krijimit të kësaj

zone ekonomike, industriale e cila do ta shdërroj Komunën në një qendër të rëndsishme të zhvillimit ekonomik, lokal dhe rajonal.

Me datën 31.05.2022, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik në bashkëpunim me Organizatën gjermane ”Help” ka organizuar një aktivitet përmbyllës, “treg” një ditor ku janë promovuar produktet e dhjetëra përfituesve të granteve ndër vite dhe të bashkë-financuara nga Komuna e Gjilanit. DZHE dhe organizata “Help Kosova” do të vazhdojnë bashkëpunimin e tyre edhe në të ardhmen për të krijuar mundësi për përkrahjen dhe stimulimin e ndërmarrësisë, sidomos bizneseve të reja “Start Up” për zhvillim e tyre dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Gjatë kësaj periudhe Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, ka bashkëpunuar me NPL “Tregu”, NPL “Stacioni i Autobusëve” dhe PPP “Eco-higjiena” me qëllim të kordinimit të veprimeve me kompanitë publike për të rritur efikasitetin, transparencën dhe cilësinë e shërbimeve për qytetarët e Komunës së Gjilanit.

Drejtoria do të vazhdoj të bashkëpunoj ngushtë dhe është në kërkim të partneriteteve me të gjithë akterët relevant në nivel lokal dhe qendror, donator, shoqëri civile, komunitet të biznesit, me qëllim të koordinimit të inciativave dhe aktiviteteve të cilat ndikojnë ne rigjenerimin ekonomik, rritjen ekonomike si dhe përmirësimin në vazhdimësi të cilësisë së jetesës së qytetarëve.

**RAPORT I SHPENZIMEVE JANAR - SHTATOR 2022**

| Planifikimi përfundimtar 2022 | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Drejtoritë/Programet | Drejtoritë/ Programet | Pagat | Mallra dhe shërbime | Shpenzime komunale | Subvencione | Shpenzime kapitale | Rezervat sipas Ligjit buxhetit | Gjithsej € |
| Zhvillim Ekonomik | 480/48027 | 88,835.00 | 130,000.00 | 2,000.00 | 10.00 | 1,264,177.00 | #REF! | 1,485,022.00 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Gjithsej €** | **88,835.00** | **130,000.00** | **2,000.00** | **10.00** | **1,264,177.00** | **#REF!** | **1,485,022.00** |

| **Shpenzimet Janar - Shtator 2022** | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Drejtoritë/Programet | Drejtoritë/ Programet | Pagat | Mallra dhe shërbime | Shpenzime komunale | Subvencione | Shpenzime kapitale | Rezervat sipas Ligjit buxhetit | Gjithsej € |
| Zhvillim Ekonomik | 480/48027 | 58,061.69 | 51,081.68 | 274.17 | - | 667,901.73 | | 777,319.27 |
| Shprehur ne % | | | **39.29** | **13.71** | **0** | **52.83** | | **52.34** |

# Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëti

## XII. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

Ecuria e punës së Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim (DMSH), mbështetet në rregulloret dhe ligjet në fuqi si në:

- Ligjin mbi Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, me nr;04/L-027;
- Ligjin e Mbrojtjes nga Zjarri nr 04/L-012,
- Ligjin për Zjarrëfikje dhe Shpëtim me nr: 04/L-049,

Ligjin përkatës Komunal, Udhëzimet, Rregulloret përkatëse të lëmisë së emergjencave, të cilat kanë fushë veprimtarinë në menaxhimin e situatave emergjente duke bërë identifikimin, lajmërimin dhe alarmimin me kohë të situatave, të cilat kanë të bëjnë me rrezikun e jetës së njerëzve dhe të mirave materiale në Komunën tonë, për të cilën veprimtari, ka hartuar edhe plane konkrete si Planin e Vlerësimit të Rrezikut, Planin Operativ Emergjent, plane kontingjente etj.

Duke u bazuar në përgjegjësit e saja DMSH, ka marrë masa të nevojshme për parandalimin e fatkeqësive si dhe ka përcjellë aktivitetet e subjekteve relevantë duke bërë koordinimin me to varësisht nga karakteri, lloji dhe përmasat e fatkeqësisë – shkallës emergjente.

Puna e drejtorisë është në varësi nga faktorët natyror, por edhe faktorëve të tjerë, njerëzor dhe teknologjik, andaj edhe bëhet sipas intensitetit që përcaktohet nga kushtet e përgjithshme shoqërore dhe klimatike.

Prandaj, në kuadër të tërë kësaj, paraqesim raportin sipas kronologjisë së zhvilluar për gjashtëmujorin e parë të këtij viti.

**Aktivitete e realizuara në DMSH**:

- Në ditët e para pas marrjes së detyrës, bashkë me stafin, kemi filluar me planifikimin për vitin 2022 në bazë të ojektivave që i kemi përcaktuar për këtë vit.
- Duke qenë se DMSH, ka përcaktuar objektivat kryesore të saja, fokusi kryesor do të jetë parandalimi, meqë në organikë ka zyrtarë dhe inspektor të preventives dhe gjatë kësaj periudhe në takimet e stafit si prioritet kemi nxjerrë nevojën e rishikimit të dokumentit të Vlerësimit të Rrezikut në komunën tonë gjatë muajve në vijim (sipas planit të punës).
- Inspektim i strehimoreve kolektive, ku pas shikimit të gjendjes së tyre është konstatuar se gjendje është shumë e keqe sa i përket funksionalitetit, pastërtisë dhe shumica e tyre janë të uzurpuara nga banorët.
- Ka vazhduar puna gjatë kësaj periudhe për të nxjerrë dokumentacionin e strehimoreve kolektive në mënyrë që të vërtetohet pronësia e tyre.
- Në kuadër të kësaj problematike (rreth strehimoreve) së bashku me Inspektorin e FNFT, kemi vizituar arkivin ndërkomunal për të identifikuar pronat e strehimoreve kolektive.
- Gjithashtu jemi në koordinim edhe me drejtoritë relevante rreth kësaj çështje.
- Vazhdon mbledhja e dokumentacionit rreth pronësisë së strehimoreve publike (arkivi ndërkomunal). Është bërë skanimi digjital për 7 strehimore.
- Aktivitetet tjera administrative dhe financiare janë realizuar sipas nevojës dhe kërkesave.
- Kemi vizituar dhe shirituar rrethojën e fushës së futbollit në lagjen “Dardania” rrethojë e cila paraqet rrezik për fëmijët që luajnë në këtë fushë.
- DMSH ka mare pjesë në fushatën për vetëdijesimin e qytetarëve kundër ndezjes së zjarreve (shpërndarja e materialeve informuese) e realizuar nga DMSH dhe PK.
- Angazhim së bashku me drejtorin e Kadastrit rreth përcaktimit të lokacionit të varrezave për kafshë.
- Është përpiluar dhe dorëzuar te zyra e Kryetarit lista me emrat e anëtarëve të MR.
- Kemi bërë ri shiritimin e rrethojës së fushës së futbollit në lagjen ,,Dardania.
- Kemi lëshuar një pëlqim rreth qasjes së ekipeve emergjente për një aterim të helikopterit te aeroporti bujqësor (autotregu) në Gjilan.
- NJPZH është pajisur edhe me 21 aparate për frymëmarrje nga AME.
- NJPZH ka ndihmuar në fikjen e zjarreve Komunën e Kamenicës me një ekip më 25 mars dhe Komunën e Novo Bërdes me 6 prill.
- Në konsultim me Kryetarin është nënshkruar kontrata deri në fund të vitit me SHZV dhe njëherit është marrë vendim që të ketë rritje të pagës mujore për këtë vit.
- NJPZSH është pajisur me një gjenerator (60 KW) nga DKRS.
- **Kemi kthyer mbrapa Pushkën Impulsive e cila ka qenë planifikuar për NJPZSH, sepse nuk ka qenë sipas specifikacionit dhe kërkesës. (Kontraktori ka sjellë Pompë Impulsive).**
- Me vendim të Kryetarit është themeluar grupi punues për hartimin e dokumentit të Vlerësimit të Rrezikut për Komunën e Gjilanit.

- Kemi filluar me fushatën senzibilizuese/informuese në portalet lokale, rreth parandalimit të zjarrvënies në territorin e Komunës së Gjilanit .
- NJPZSH vazhdon kujdestarinë sipas njoftimit të njësisë për ngritjen e gjendjes së gatishmërisë për muajt e verës.
- Kemi vizituar hapësirat e Spitalit Regjional, rrugën e Malishevës( çezma e Kufcës ) dhe oborrin e shkollës ,,Ibrahim Uruqi,,në Bresalc për të prerë lisat të cilët paraqesin rrezik, ku kemi rekomanduar drejtorinë e SHPB të bëjë prerjen e tyre.
- Me kërkesë të Kryetarit kemi bërë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga shtrëngata pronarëve në panairin EJONA më 28 korrik.
  Për këtë rast kemi bërë një raport dhe të njëjtin ja kemi prezantuar Kryetarit.

- Është mbështetur nga NJPZSH prerja e dy lisave në hyrje të fshati Malishevë.
- Kemi bërë koordinimin e veprimeve pas reshjeve të shiut me NJPZH dhe DSHPP në Komunën e Gjilanit.
- Vizitë familjeve që janë vërshuar nga reshjet e shiut si dhe vizitë objektit mbrapa shtatores së “Mulla Ideriz GJILANIT”, dëmtim i fasadës.
- Është iniciuar procedura e prokurimit për instalimin e pompave termike në objektin e NJPZSH ( Investim kapital në pajisje).
- **Kemi pranuar një donacion nga bashkatdhetarët në Gjermani. Donacioni është automjet me shkallë hidraulike 30m lartësi për nevojat e NJPZSH në Gjilan.**
- Janë kryer të gjitha procedurat rreth doganimit dhe homologimit të automjetit me shkallë hidraulike dhe tani ky automjet është i gatshëm për përdorim.
- Kemi realizuar takim me pronarin e parcelës për të na lejuar përdorimin e kësaj parcele për pastrimin e shtratit të lumit Stanishorka prej Rr. ,,Dajti,, në gjatësi rreth 500 m.
- Inspektim i disa pikave (pusetave) kritike ku ka rrezik që të vërshohen kur ka reshje te dendura të shiut. Në inspektim ishim bashkë me UD. e drejtorit të KRU ,,Hidromorava,, dhe dy zyrtarë të kësaj kompanie.
- Është bërë intervenimi nga NJPZSH në prerjen e lisave nga rrethoja e fushës së sportit në shkollën fillore ,,Ibrahim Uruqi,, në Bresalc si dhe e një lisi në oborrin e Spitalit Rajonal në Gjilan që kanë paraqitur rrezik.
- Angazhimi në dezinfektim dhe dezinsektim
- Më 30 shtator, është bërë intervenimi në zhbllokimin dhe pastrimin e shtratit të lumit Stanishor në gjatësi afër 400 m. Në Rrugën ,,Dajti,, (te Livadhet e Arapit) i cili ka paraqitur rrezik të vazhdueshëm nga reshjet e shiut.
- Ka vazhduar pastrimi i lumit Stanishor në gjatësinë rreth 100 m. te ,,Livadhet e Arapit, (më 31 tetor dhe 1 nëntor).
- Janë pranuar dhe trajtuar kërkesa të ndryshme drejtuar DMSH.
- Janë proceduar të gjitha faturat për pagesa të ndryshme për nevojat e DMSH dhe NjPZSH.

**Trajnimet:**

- Trajnim në Vushtrri (19-21 Prill) nga AME në temën Vlerësimi i Rrezikut (VRR) pjesëmarrës drejtori i DMSH dhe Inspektori i FNFT.
- Një zyrtar i DMSH në muajin prill ka marrë pjesë në trajnimin e realizuar nga BIRN në temën: ,,Standardet e menaxhimit të rrjeteve sociale dhe komunikimi me publikun në raste të krizave,
- Është realizuar trajnimi i MR më 14-15 prill, ku është bërë edhe certifikimi i pjesëmarrësve në trajnim.( Trajnimi është realizuar me instruktorët nga Britania e Madhe)
- Drejtori i DMSH, ka marrë pjesë në punëtorinë e organizuar nga BIRN më 12 maj në temën ,,Parandalimi i përhapjes së ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit në Kosovë,,.
- Më 02- 03 qershor është realizuar punëtoria (Workshop) rreth dokumentit të Vlerësimit të Rrezikut ku pjesëmarrës kanë qenë drejtoritë dhe kompanitë komunale dhe mekanizmat tjerë të nevojshëm sipas ligjit. ( Punëtoria është realizuar nga instruktorët e AME)
- Më 08-09 shtator është realizuar punëtoria (Workshop) e II-të e MR, nga ekspertë Britanez.
- Pjesëmarrje në punëtorinë e organizuar nga ,,BIRN,, ( KALLXO.COM) në temën: ,, Standardet e menaxhimit të rrjeteve sociale dhe komunikimit me media gjatë situatave të krizave,, 22-23 shtator.
- Trajnim, punëtoria ,”Menaxhimi i kontratave të prokurimit” dy zyrtarë të DMSH, 26-27 shtator.

Në kuadër të objektivave që dalin nga Plani Vjetor i Punës së DMSH-së, në kuadër Objektivit nr. 1 të Nën objektivit 1.4 (masave parandaluese) dhe aktivitetit 1.4.5 (Identifikimi i gjendjes të Rrjedhave natyrore, përrenjve dhe lumenjve që shkaktojnë vërshime dhe përmbytje), në këtë periudhe kemi realizuar vlerësimin e gjendjes së pjesës së sipërme të pellgut të rrjedhës që derdhët në lumin “Morava”.

a. Pellgun e lumit “Mirusha” deri në Pogragjë, përfshirë edhe lumin e Sllubicës
b. Përroin e Kufcës dhe Stanishorit deri te ura afër kazermës së FSK-së.
c. Pellgun e lumit Përlepnica deri në Dobërqan, përfshirë edhe përroin e Kosoqës
d. Pellgun e lumit Livoç, përfshi rrjedhën e lagjes së qytetit ,,Qarku,,

**Vlerësimi i gjendjes së përroskës së Kufcës dhe lumit Stanishori.**

Nga shikimi i gjendjes, është vlerësuar së në rast të shtimit të reshurave pranverore, mund të ketë dalje nga shtrati i lumit të Stanishorit dhe përroit të Kufcës, kryesisht nga mbushjet me material inert, plastikë dhe aluvione.

**Gjendja:**

**Situacioni i parë, Përroska e Kufcës:**

Përroska e Kufcës daljen kryesore e ka të ura, e cila përshkon trupin e rrugës Kufcë – Gjilan. Si rezultat i mbushjeve, ura është e mbushur dhe nga ky , nuk ka kapacitet të përballoi prurjet në rast të reshjeve me intensitet të larë. Konfiguracioni i terrenit te vendi ku është ura, favorizon përmbytjen e anës së majtë, ku zakonisht uji përfshinë lagjen e re e cila ndodhët në mes të rrugës qarkore dhe rrugës regjionale Gjilan – Bujanoc.

Gjithashtu, për shkak të mbushjeve dhe urave të improvizuara gjatë gjithë shtratit të kësaj përroske deri në daljen në rrugën qarkore, është zvogëluar vëllimi i shtratit, gjë që do të shkaktonte përmbytje në të dy anët e rrugës.

Një problem shtesë në këtë pjesë është dëmtimi i kanalizimit të fshatit Kufcë, i cili nuk shkarkohet në kanalizimin e qytetit, por në hyrje të urës së përroskës së Kufcës.

**Është intervenuar në 6 pika kritike në zhbllokimin e rrjedhës së lumit Stanishor dhe kanalit kullues përgjatë rrugës së fsh.Kufcë .**

- **Është bërë hapja e shtratit të kanalit nën urë në rrugën e fsh.Kufcë, e cila thuajse ka qenë e bllokuar(rreth 90% e bllokuar)**
- **Është bërë pastrimi i kanalit kullues përgjatë rrugës për fsh.Kufcë rreth 1.3 km.**
- **Është pastruar lumi Stanishor afër udhëkryqit në rrugën qarkore.(rr.për fsh.Kufcë)**
- **Është bërë pastrimi dhe thellimi i lumit Stanishor rreth 150 m afër qendrës së shëndetit mental.**
- **Është bërë pastrimi dhe thellimi i lumit Stanishor rreth 200 m. prej çezmës së Porodinit, si dhe është shtuar rruga me zhavorr rreth 400 m.**
- **Më 30 shtator është bërë intervenimi në zhbllokimin dhe pastrimin e shtratit të lumit Stanishor në gjatësi afër 400 m. Në Rrugën ,,Dajti,, (te livadhet e Arapit) i cili ka paraqitur rrezik të vazhdueshëm nga reshjet e shiut.**
- **Ka vazhduar pastrimi i lumit Stanishor në gjatësinë rreth 100 m. te ,,Livadhet e Arapit,, (më 31 tetor dhe 1 nëntor).**

● Në kuadër të objektivave që dalin nga plani vjetor i drejtorisë, në kuadër të pikës 1.3 (Planifikimet Strategjike) dhe aktivitetit 1.3.1 (Rishikimi i Dokumentit të Vlerësimit të Rrezikut), kemi realizuar pjesën e Përgatitja e Koncept – Dokumenteve (Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Emergjencave dhe Planin e Reagimit Kombëtar)

**Aktiviteti Inspektorit të FNFT:**

Gjatë kësaj periudhe raportimi kemi vizituar përroskat ku mundë të kenë përballje me rreziqe nga vërshimet dhe përmbytjet :

- Kemi vizituar Lumin “Stanishorka”, ku ky lumë po sjell probleme thuajse çdo vit nga shirat që po ndodhin, po shkakton dëme të mëdha në vërshime (ky lum është më emergjentë që të trajtohet).

- Kemi vizituar lumin që shtrihet nga Livoçi i Epërm deri në Livoçin e Ulët, kemi parë nga afër se ky lumë duhet të trajtohet dhe të rregullohet për ndonjë të pa pritur nga vërshimet. Në këto fshatra kanë nevojë emergjente për të rregulluar së pari kanalizimin e mandej shtretërit e lumenjve për të mos pasur ndonjë fatkeqësi.

Gjatë kësaj periudhe kemi inspektuar pikat e shitjeve të derivateve të naftës, benzinës dhe gazit ku 99 % e tyre nuk i kanë planet e kërkuara sipas Ligjeve në fuqi:

- Planin e Reagimit Emergjent.
- Planin e vlerësimit të Rrezikut.
- Instalimet e Rrymës dhe Rrufepritësit.
- Që nga 7 marsi, kemi filluar vizita në strehimoret në qytet, ku i kemi evidentuar në këto vende, gjatë kësaj kohe ne jemi angazhuar në kompletimin e dokumentacioneve të pronësisë, si dhe planet e këtyre strehimoreve në DSHPTB si dhe në arkivin e Qytetit.
- Më 21 mars është mbajtur një aktivitet "për ditën Ndërkombëtare e Pyjeve" së bashku me Nënkryetaren e Komunës, Drejtorinë e Bujqësisë, Policinë e Kosovës, Agjensionin Pyjorë të Kosovës, OJQ Gruaja Hyjnore, dhe Fuqia e Bashkimit Rinor. Në këtë aktivitet sensibilizues për të vetëdijesuar qytetarët për rëndësinë jetike të pyjeve, mbrojtjen, ruajtjen e tyre nga prerjet ilegale, ndezja e tyre.
- Kemi vizituar fshatin Bresalc, ku ka pasur të reshurat më datës 21.08.2022, në orët e mbrëmjes, si pasoj e kësaj, kemi pasur dalje të ujit nga çezma e Malishevës e deri në hyrje të fshatit, lumi Stanishorit në lagjen e Kurteshve ka dalur nga shtrati, por jo në përmasa të mëdha.
- Në fshatin Velekincë e epërme, kemi problem me ujëmbledhës si pasojë e kësaj vërshohen dy shtëpi.
- Vizitë në shtëpinë e Sali Abazit në fshatin Velekincë për shkak të goditjes nga rrufeja dhe zbrazja e atmosferike elektrike në afërsi të shtëpisë, ku për fat të mirë nuk kemi pasur humbje në njerëz dhe të mira materiale.
- Takim më Drejtorinë e Urbanizmit për projektin e zgjerimit të garazheve në objektin e njësisë Profesionale të Zjarrfikëseve dhe Shpëtimit (NJPZSH) për projekt ku nga kjo drejtori na është kërkuar leja e objektit ekzistues, për të pasur mundësi për leje për aneks garazhe. Ne kemi kërkuar në arkivin e Qytetit dokumentacionin e shtëpisë së zjarrfikësve, plani ishte i detajuar, por leje nuk kishte.
- Njoftim për Drejtorinë për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim, për plepat në fshatrat, Malishevë, Bresalc si dhe në oborrin e Spitalit. ( në fshatin Malishevë janë larguar)
- Kërkesë për Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, për matjen e objektit të Njësisë Profesionale të zjarrfikëseve dhe Shpëtimit (NJPZSH) kjo matje na shërben për legalizimin e objektit.

**Inspektime te qendrat tregtare dhe prodhuese**

- Tri qendrat tregtare Interex, kemi vizituar dhe nuk kanë plan për reagim dhe evakuim, si dhe instalimet e rrymës.
- Qendra tregtare Gorenje posedon Atestet e rrymës dhe rrufepritësit, por nuk e posedon planin e reagimit dhe evakuimit.
- Qendra Tregtare ShPK - nuk kanë plan për reagim dhe evakuim, si dhe instalimet e rrymës.
- Qendra prodhuese Palma ShPK, ku nuk kanë plan për reagim dhe evakuim, si dhe instalimet e rrymës.
- Në deponin e mbeturinave KMDK në fshatin Velekincë,(nuk i kane të kontrolluara instalimet e rrymës dhe Rrufepritësit)

**Inspektime: Universitetet/Shkollat e mesme/fillore në Gjilan**

- Kemi vizituar SHFMU "Thimi Mitko" në Gjilan - nuk e posedon Planin për Reagim dhe Evakuim , Instalimet e Rrymës dhe Rrufepritësit.
- Kemi vizituar SHFMU "Musa Zajmi" në Gjilan, ku gjatë kësaj kontrolle është konstatuar së nuk e posedon Planin për Reagim dhe Evakuim , Instalimet e Rrymës dhe Rrufepritësit
- Kemi vizituar SHFMU "Abaz Ajeti" në Gjilan, ku gjatë kësaj kontrolle është konstatuar së nuk e posedon Planin për Reagim dhe Evakuim , Instalimet e Rrymës dhe Rrufepritësit
- Kemi vizituar SHFMU "Mulla Idriz Gjilani " në Velekincë, ku gjatë kësaj kontrolle është konstatuar së nuk i posedon Planin për Reagim dhe Evakuim , Instalimet e Rrymës dhe Rrufepritësit.
- Çerdhet - Çerdhja në Dardani, Integj në Gjilan, ku gjatë kësaj kontrolle është konstatuar se këto dy çerdhe të fëmijëve e posedojnë, Planin për Reagim dhe Evakuim Emergjent, por nuk i posedojnë atestet e rrymës dhe rrufepritësit.

**Inspektime të planifikuara dhe paplanifikuara**

- Gjatë kësaj periudhe, ne kemi marr një njoftim për shtëpinë e pronarit të Refik Demirit në rrugën Feti i Vogli në lagjen Elez Agushi, ku e kemi vendosur njoftimin në shtëpinë e personit në fjalë dhe e kam njoftuar përmes telefonit në Gjermani.
- Kemi vizituar fshatin Cërrnicë së bashku me inspektorët e drejtorisë së Inspeksionit në shtëpinë e pronarit Xhavit Bajramit, kjo shtëpi rrezikohet nga rryma për shkak se është shumë afër largpërçuesit 10 kilovat.
- Së bashku me inspektorët e Inspeksionit, kemi vizituar lagjen e Jabuqëve rrugës për Gumnishtë, pronarët janë duke ndryshuar reliefin tokës dhe si pasojë e kësaj kanë shkaktuar një pellg artificial ku mblidhet uji nga të reshurat dhe mundë të rrezikoj banorët apo bagëtitë që frekuentojnë rreth këtij pellgu.
- Vizitë në lagjen e 7 – korrikut, së bashku me inspektorët e Drejtorisë së Inspeksionit, ku kemi parë në vendin e ngjarjes një shtëpi të pa banuar e mbushur me mbeturina, kjo shtëpi përdoret nga narkomanet sipas banorëve që jetojnë afër kësaj shtëpie.
- Gjatë kësaj kohe ne së bashku me Policinë e Kosovës, kemi evidentuar një shtëpi të romëve në Gjilan që paraqet rrezik për banorët e lagjes.
- Gjatë kësaj periudhe kemi dhëne përgjigje për dëmet në Bresalc dhe rrethinë:
- Nëntë vërtetime për vërshime.
- Katër njoftime për Drejtorin për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim.
- Dy njoftime për Këshillin e fshatit Malishevë dhe Bresalc.
- Dy njoftime për KEDS-in dhe Telekomin.
- Një njoftim për Policinë e Kosovës.
- Një Njoftim për Kolegjin UBT, në Gjilan.
- Një vërtetim për shtëpinë e vjetër.

**Inspektime**

- Biblioteka “ Fan Noli “ në Gjilan
- Konvikti nxënësve dhe studenteve në Gjilan.
- Astoria, Sh.P.K.
- Baroni, Sh.P.K.
- Albimi, Sh.P.K.
- Restorant, Planeti.
- Viva Vresh, qendër .
- Viva Fresh në Rrugën e Prishtinës.
- Biblioteka “ Fan Noli “ në Gjilan
- Spitalin e përgjithshëm Regjional në Gjilan
- Hotelin Vali Ranç në fshatin Përlepnicë me gjitha objektet përcjellëse.
- SHFMU ‘ Bajram Curri” në fshatin Shurdhan.
- SHFMU “ Agim Ramadani” në fshatin Zhegër me paralelet në fshatrat, Haxhaj, Selishtë, Lladovë dhe Nasalë.
-

**Raporti i punës së Inspektorëve të parandalimit/preventivës janar-shtator 2022**

Në periudhën raportuese janë kryer inspektime të rregullta me ç‘rast janë hartuar procesverbale, gjithashtu janë lëshuar vërtetime mbi gjendjen e sigurisë nga zjarri të subjekteve të ndryshme, vërtetime mbi zjarrin e ndodhur në objekte të ndryshme, kryesisht të sektorit privat, njoftime për njësinë e hetuesisë të Policisë së Kosovës në Gjilan, kurse pëlqime të dokumentacioneve teknike në sektorin privat në Komunën e Gjilanit dhe Novobërdës. Në këtë periudhë ka pas gjithsejtë 8 nga të cilat katër janë në sektorin privat dhe një në atë publikë.

| Komuna | Inspektimet | Sektori i Pasurisë | Numri i objekteve të inspektuara sipas kategorisë | Nr. i masave të propozuara |
|---|---|---|---|---|

| Gjilan | Themelore | Rregullt | Jashtëzakonshëm | verifikues | Gjithsej | Shoqërorë | Privat | Gjithsej | I | II | III | IV | Gjithsej | | Gjithsej | M pr ce ur të rre ul |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 65 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 1 |
| | 10 | 53 | - | - | 72 | 11 | 61 | 72 | 50 | 22 | 8 | 2 | 82 | 221 | 9 | 9 |
| **72** | 10 | 53 | - | - | 72 | 11 | 61 | 72 | 50 | 22 | 8 | 2 | 82 | 221 | 9 | 9 |

**af ati** | **ed ur ës ku nd ër va jtë sv e** | **ed ur ë** | **i z j a r r i n** | **te kn ik**

| Komuna Gjilan | Sektori i Pasurisë | | | Aksident komunikacioni | Vërtetim zjarri | Vërtetim mbi gjendjen e sigurisë nga zjarri | Njoftime PK |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Shoqëror | Privat | Gjithsej | | | | |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 |
| 14 | | 15 | 15 | - | 9 | 5 | 3 |
| **14** | **-** | **15** | **15** | **-** | **9** | **3** | **3** |

**Intervenimet e NJPZSH-së**

| 2022 | Numri i përgjigjeve në dalje | Numri i zjarreve | Numri i teknike | Numri i shërbimeve | Aksidente Rrugore | Vërshime | Të rejshura | Të lënduar | | | Të vdekur | | | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | **zj** | **qyt** | **tot** | **zj** | **qyt** | **tot** | |
| Janar | 35 | 32 | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 35 |
| Shkurt | 37 | 30 | 2 | 1 | 4 | 0 | 0 | 0 | 5 | 5 | 0 | 2 | 2 | 37 |
| Mars | 91 | 82 | 9 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 91 |
| Prill | 47 | 35 | 10 | 0 | 2 | 0 | 0 | 1 | 3 | 4 | 0 | 0 | 0 | 47 |
| Maj | 32 | 23 | 4 | 0 | 3 | 1 | 1 | 0 | 4 | 4 | 0 | 0 | 0 | 32 |
| Qershor | 15 | 8 | 2 | 0 | 1 | 3 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 15 |
| Gjithsej | | | | | | | | | | | | | | 257 |

Raporti i shpenzimeve financiare:

Për periudhën 6 mujore në DMSH mjete të alokuara nga kategoria mallëra dhe shërbime kanë qenë si vijon:

- Të alokuara 49.000.00€
- Të shpenzuara 38.313.01€ (Të paguara 31.719.91€, në procedure për pagesë janë: 6.593.10€)
- Të lira 10.686.99€

Për periudhën 6 mujore në DMSH mjete të alokuara nga kategoria shërbime komunale kanë qenë si vijon:

- Të alokuara 2.200.00€
- Të shpenzuara 2.152.37€ (Të paguara 1.568.26€, në procedure për pagesë 584.11€)
- Të lira 47.63€.

XIII. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

## Aktivitetet kulturore

**Flaka e Janarit 31 Vjet**

- Homazhe te varrezat e Dëshmorëve
- Vizitë kazermës së FSK-së
- Ekspozitë memoaresh e kujtimesh ‘’Dhoma e Kadriut, Jusufit e Bardhoshit’’- Muzeu Etnologjik/Gjilan
- Ndezja e Flakadanit të Flakës së Janarit 2022
- Akademia e Flakës së Janarit kushtuar Dr. Ibrahim Rugoves
- Peneli i Flakes së Janarit (Ekspozitë në Galerinë e Qytetit)
- Ekspozitë e Artit Bashkëkohor ‘’Rezistencë’’
- Talia e Flakës së Janarit-Festivali i Dramës Shqipe
- Flaka Interaktive (Promovimi i 6 dramave Shqipe)
- Tryezë Letrare kushtruar Jusuf Gervallës
- Xixat e Flakës (Festivali i këngëve për fëmije)
- Pena e Flakës (Ora e madhe letrare)
- Fest Flaka (Koncerti përmbylles i Flakës së Janarit)

**Për shënimin e pavarësisë me 17 shkurt kemi realizuar gjashtë aktivitete:**

- Lexuesit e vitit në bibliotekë,
- Shfaqja teatrale ‘’Viganët’’ në Teatër,
- Panairi i punimeve artizanale në sheshin “Rexhep Mala” e “Nuhi Berisha”,
- Koncert për femijë në Teatrin e Qytetit
- Dy ekspozita në Galerinë e Qytetit, njëra me imazhe e titulluar ‘’E Bukura Kosovë’’ dhe tjetra me fondin e Galerisë, vepra artistike nga viti 2003 deri 2022

**4 Mars**

Takimi me Ministrin dhe Komunitetit artistik, ku u diskutua me komunitetin artistik nm Teatrin e Gjilanit mbi ligjin për kulturë që është duke e hartuar Ministria e Kulturës.

**7 Mars**

“Nata e Zjarreve’’

**8 Mars**

Ekspozitë me Imazhe
OJQ- Gruaja Hyjnore
Galeria e Qytetit
*#DitaNderkombetareEGruas*
Ekspozitë “Muza’’
Organizuar dhe Kuruar nga:
Arta Ramadani-Jashari dhe
Arbenita Kërçeli
*#DitaNderkombetareEGruas*

**14 Prill**

Sesion Informues në Shtëpinë e Rinisë lidhur me thirrjen per aplikim për subvencione nga DKRS

**15 Prill**

-Beteja e Zhegocit
Homazhe te Kodra e Dëshmorëve, te bustet e dëshmorëve Alban Ajeti dhe Pajazit Ahmeti, homazhe në Lapidarin e Zhegocit
-Akademia e Betejës së Zhegocit si dhe dokumentar kushtuar dëshmorit Nijazi Osmani.

**21 Prill**

Dita e Dëshmorëve
Akademi përkujtimore kushtuar dëshmorëve të UÇPMB-së

**25-29 Prill**

Ekspozitë me 2 artistë Gjerman në Galerinë e Qytetit
Melanie Sapina dhe Marcus Sendlinger

**27 Prill**

Koncert: Ansambli i Këngëve dhe Valleve Popullore
‘’Moj e Bukura Shqipëri’’

**30 Prill**

Homazhe te varrezat e Dëshmorëve-Fshati Llashticë
Ekspozitë e Masakrës së Llashticës
Ish-Galeria e Qytetit
Koleksion i fotografit Milaim Grabovci nga autori kanadez Brian Honeyburn

**1-3 Maj**

Ditët e Agimit- Fshati Zhegër
Ekspozita Postmortum’’Agim Ramadani’’- Galeria e Qytetit-Gjilan

**01 Qershor**

- Rihapja e Muzeut Etnologjik me orar të plotë (E hënë-e Premte) për vizitorë

**Për shënimin e ‘’Ditës së Çlirimit’’ me 14 dhe 15 Qershor, kemi realizuar 10 aktivitete:**

**14 Qershor**

- Vrapimi i Lirisë
- Garat Komunale të notit
- ‘’Ballë për Ballë me poetin’’ Biblioteka e Qytetit
- Monodramë nga Bedri Selmani ‘’Cili je… Cili je…’’ - Teatri i Qytetit

**15 Qershor**

- Seancë solemne e Kuvendit Komunal
- Homazhe
- Turneu i Futbollit me veteranët e Kosovës
- Koncert për fëmijë
- Flakadanët
- Koncert përmbyllës, Platoja e Teatrit

**22 Qershor**

- Ndarja e Subvencioneve per OJQ dhe Individ me thirrje Publike për Sport, Kulturë dhe Rini.

**27 Qershor**

- Lansimi i web-faqes www.kulture06.com
- Databazë për Artistë dhe Vullnetarë të qytetit.

- **Dhjetëra kërkesa të aprovuara për shfrytëzim të hapësirave, shfrytëzim të transportit për aktivitete dhe ndihmë në aktivitete përmes operatorit me zërim, binë dhe ndriçim.**

KORRIK

- 01.07.2022 “Vrapo për Autizëm” 2022
- 10.07.2022-05.08.2022 Ekspozita me dy artistë Gjerman nga Frankfurti
- 18.07.2022 korrik debati publik për riorganizimin e Flakës së Janarit 2023
- 27/28/29.07.2022 panairi dhe festivali E JONA
- 27.07.2022 Karvani i Diasporës
- GUSHT
- 19.08.2022 diskutim publik për të gjitha shtyllat e Manifestimit “Flaka e Janarit 2023”
- 22.08.2022 diskutim publik Talia e Flakës - Shfaqjet Teatrale;

- 23.08.2022 diskutim publik Pena e Flakës - Letërsia;
- 23.08.2022 diskutim publik me sportistë dhe artistë
- 24.08.2022 diskutim publik Xixat e Flakës - Festivali për fëmijë;
- 25.08.2022 diskutim publik Paneli i Flakës - Ekspozita e arteve pamore; dhe
- 26.08.2022 diskutim publik Fest Flaka - Koncerti i muzikës popullore.
-

SHTATOR

- Takimi me Ministrin Ceku- për investime kapitale 14.09.2022 paraqitja e projekteve nga DKRS
- Është shënuar Java evropiane e lëvizshmërisë ‘’Lëvizim pa makina’’ 21.09.2022 rr.Idriz Seferi
- Është hartuar Draft Statuti i Galerisë dhe Draft Statuti i Muzeut dhe është caktuar dëgjimi publik për datën 05.10.2022, e qe pastaj kalon nëpër komitete dhe në fund në Kuvendin Komunal për votim.
- Muralfest Kosova- përfitues i projektit për një mural ne Gjilan, ka mbetur përcaktimi i lokacionit dhe fillimi i punës në momentin që e nënshkruan kontratën me MKRS Muralfest Kosova.
- Çmimi letrar Beqir Musliu- Takim me Sabit Rrustemin për organizim, projekti ka ardhur në zyrën e Kryetarit.

Me datën 15 Shtator u hap ekspozita e Artistit me Grafika nga Gjilani z.Rasim Vllasaliu me titull ‘’Retrospektivë’’.

- Homazhe te Kodra e Dëshmorëve- ‘’Rivarrimi i Dëshmorëve’’ me datën 17.09.2022
- Takim ne AAB me Rektorin dhe Prorektorin për organizimin e Festivalit të Teatrove të shkollave të mesme. Është hartuar draft koncepti i organizmit nga DKRS.
- Takim me OSCE dhe rekomandimet për DKRS qe duhet ndërmarrë për personat me aftësi të kufizuara. 26.09.2022.
- Stadiumi ndihmës i SC Gjilanit- jemi takuar në terren me operatorin dhe presidentin e klubit, kemi propozuar vendosjen e zhveshtores, pastaj është aprovuar nga MKRS, dhe gjeodeti ka bërë piketimin në terren për të filluar punimet.
- Takim me Komitetin për Kulturë me datën 27.09.2022.

**Teatër**

**23 – 28 janar**

- Festivali i Dramës Shqipe “Talia e Flakës 2022”
- Premiera e shfaqjes “Viganët” - Prodhim i Teatrit të Qytetit - Gjilan

Kalendari mujor i shfaqjeve Shkurt 2022

- **16 Shkurt**
- **‘’Viganët’’** nga Visar Krusha, regjisor Ilir Bokshi

- **23, 24 dhe 25 Shkurt**
  - Shfaqja **‘’E Vërteta’’** nga Florian Zeller, regjisor Agon Myftari

Kalendari mujor i shfaqjeve Mars 2022

**15 Mars**

- **‘’King Lori’’** Shfaqje Mysafire nga Zvicra

**24 dhe 25 Mars**

- Repriza të shfaqjes **‘’E Vërteta’’** nga Florian Zeller, regjisor Agon Myftari

**28 Mars**

- Shfaqja **‘’Provo edhe njëherë Sam’’** nga Teatri ‘’Bekim Fehmiu’’ - Prizren

**30 Mars**

- Shfaqja **‘’Marksistët dhe Leninistët e Zvicrës’’** nga Teatri ‘’Adriana’’ - Ferizaj

Kalendari mujor i shfaqjeve Prill 2022

**07 dhe 08 Prill**

Reprizat e shfaqjes **‘’Viganët’’**

**12, 13 dhe 14 Prill**

Reprizat e shfaqjes **''E Vërteta''**

**19 Prill**

Repriza e shfaqjes **''a.y.l.a.n''**

**26 Prill**

- **''a.y.l.a.n''**-Prodhim i Teatrit të Qytetit-Gjilan
- Pjesëmarrës në festivalin ndërkombëtar **''Kontrapunkt''** në Poloni

**Fitues të Çmimit Kryesor**

**30 dhe 31 Maj**

- Premiera dhe repriza e parë e komedisë **''Gënjeshtër pas gënjeshtre''nga**
- Anthony Nielson me regji të Sevdije Ajeti dhe ass. regjisore Natyrë Kallaba, prodhim i Teatrit të Qytetit-Gjilan

**26 Qershor**

- **''a.y.l.a.n''-** Prodhim i Teatrit të Qytetit-Gjilan
- Pjesëmarrës në festivalin ndërkombëtar **''Open dhe Door''** në Katoëice, Poloni, ku u vlerësua me vendin e parë nga juria profesionale.

- **Në muajt korrik dhe gusht, Teatri i Qytetit ka pushuar nga aktivitetet.**
- **Kalendari i Shtatorit 12 shfaqje përfshirë dhe reprizat**
- **2 pjesëmarrje jashtë vendit në festivale:**
- **Festivali i Teatrove Suharekë 07.09.2022**
- **K'tu Fest- Strugë 17.09.2022**
- **Konsolidimi i KD te Teatrit**
- **Hartimi i Statutit te Teatrit, Rregullores së KD të Teatrit dhe Rregullorja për shfrytëzim të sallës së Teatrit-Plotësim Ndryshim.**
- **Është caktuar dëgjim publik me datën 05.10.2022, pastaj kalon në komitete dhe në Kuvend Komunal për votim.**
- **Zgjedhja e drejtorit të ri të Teatrit**

- **Biblioteka e Qytetit ''Fan. S. Noli''**

**I. Gjatë janarit në Bibliotekë në bashkërenditje me "Ars club..." dhe DKRS, duke qenë nikoqir të këtyre e ngjarjeve e janë mbajtur dy aktivitete kulturore:**
**II. Më 26 janar Tryezë shkencore për Jetën dhe veprën e atdhetarit, poetit, kompozitorit shkrimtarit Jusuf Gërvalla.**
**III. Më 31 janar 2022, në kuadër të "Flakës .." Pena e Flakës"**
**Diskutim për shënimin e datës 17 shkurt 2022, Aktiviteti i bibliotekës, përzgjedhja e "Lexues i dalluar i vitit" dhe ndarje të Mirënjohjes nga kryetari i Komunës për Anila Daku, Tuana Shabni dhe Kaltrina Berisha.**

1. **Në llogarinë e DKRS, deri më tani janë dorëzuar 6855 € mjete të anëtarësisë.**
2. **Për 6 muaj janë regjistruar 1708 anëtarë të rinj, prej tyre 1090 janë femra e 624 meshkuj.**
3. **Për lexuesit janë huazuar 6819 libra**
4. **Janë përpunuar, shtypur dhe vendosur në libra mbi 10 mijë skeda-tiketa elektronike të librave, të cilat janë kthyer në rafte për lexuesit**
5. **Në bibliotekë janë pranuar, janë përpunuar kataloguar dhe klasifikuar 285 ekzemplarë të librave dhuratë nga autor të ndryshëm.**
6. **Gjithashtu janë përpunuar, shtypur dhe vendosur në libra 10974 skeda-tiketa elektronike të librave, të cilat janë kthyer në rafte për lexim.**

- **Periodiku 24 anëtar, gjithashtu 11 gazeta të lexuara dhe 440 revista dhe mbi 1500 gazeta të huazuara.**

- **Shfrytëzues të sallave të leximit (studentë të rinj dhe fëmijë për gjysmë muajin mars janë 11.104 lexues.**
- **21 prill, pranim i pajisjeve elektronike për aktivizimin në formë pilot projekti për platformën digjitale (katalogut) në bibliotekë, siç e biseduam do të ishte e mirëseardhur ueb-faqja e Bibliotekës së Qytetit.**
- **23 Prill Dita Ndërkombëtare e librit dhe Drejtës së Autorit- donacion librash nga një adhuruese e librit.**
- **Në maj dhe qershor zyrtaret, bibliotekaret Lumturije Arifi, Mukadeze Behluli dhe Shqipe Latifi në datat 23,24 dhe 25 maj, kanë ndjekur dhe janë trajnuar për modulin digjital të huazimit të librit nga instruktorja e**

**Akademisë së Shkencave të Kosovës, znj Arta Këqiku në të njëjtën kohë gjatë këtyre ditëve kanë zgjeruar trajnimin edhe me koleget/ët e tyre në bibliotekë lidhur me këtë çështje.**

- **Biblioteka e qytetit "Fan S. Noli" Gjilan me lexuesit e saj, nxënës nga SH.F.M.U „Abaz Ajeti"- kanë marrë pjesë në realizimin e projektit dhe më datë 21 qershor janë shpërblyer me çmimin e dytë në "Sfidën-Qytetari Digjital", me temën "Shtëpia e përrallave".**
- **1 Qershor Dita botërore Fëmijëve –aktivitet më fëmijët e tri shkollave fillore. S Hallaqi, Abaz Ajeti, Th. Mitko" dhe "M. Zajmi", biblioteka u ka dhuruar regjistrim falas për fëmijë.**
- **14 Qershor 2022, Programi kulturor i Bibliotekës për nderë të "15 Qershori" Dita e çlirimit të Gjilanit me moton:**
- **Ballë për ballë me poetin tim -para publikut artdashës**
- **15 autorë- 15 poezi –15 lexime**

- **Në bashkëpunim të DKRS, Bibliotekës dhe zyrës së Prokurimit ju është dorëzuar projekti për blerjen e fondeve librare, për të cilin tanimë është bërë edhe thirrja publike.**
- **Kemi vazhduar me regjistrimin e studentëve dhe anëtarëve tjerë nga të gjitha moshat dhe duke ju dhënë udhëzime në e-mail të tyre shënimet, kodin digjital për përdorimin e Programit nga tel mobil, apo edhe kartelës sipas departamentit përkatës të bibliotekës.**
- **Në të njëjtën kohë të gjithë anëtarët e rregullt të bibliotekës kanë të drejtë të shfrytëzojnë pa pagesë Bazën e të dhënave ku për të gjithë jepen falas mbi 31 milion artikuj të të gjitha shkencave dhe lëmive të mbi 50 mijë botueseve të njohur.**
- **Të gjithë qytetarët që janë të interesuar për librin, revistën a ndonjë material bibliotekar ata mund të kërkojnë në dy mënyra: me kërkesë te thjeshtë të autorit apo titullit të librit si dhe me kërkesë të specializuar me të cilën kërkimi në katalog është më i detajuar.**
- **Në muajin Korrik është zgjatur orari i punës për Bibliotekën deri në ora 22:00**
- **Gjatë korrikut janë bartur në bazën e katalogut elektronik të gjithë anëtarët e bibliotekës nëpër sektorë" fëmijë, sektori i të brinjëve, shkencori dhe ai i të rriturve mbi 1300 anëtarë në muajin korrik të regjistruar si të rregullt janë 145 anëtarë;**
- **Libra dhe materiale tjera (revista e gazeta) të huazuar po gjatë këtij muaji janë 1324 ekzemplarë;**
- **Në bibliotekë kanë hyrë – 176 tituj të librave (korrik)**
- **Janë përpunuar, inventarizuar dhe kataloguar dhe po ashtu janë vendosur edhe etiketa të koduar- 414, autorë të përpunuar – 23**
- **Gjatë muajit korrik janë dorëzuar – 840 euro nga pagesa e anëtarësisë.**
- **Shfrytëzimi i sallave të leximit për shkak të pushimeve ka qenë shumë më i ulët -1012 lexues;**
- **Ne muajin gusht bilanci i lexueseve të cilët kanë gravituar bibliotekën nga ora 19.00 deri 22.00 është ky 213, nga 3296 të cilët shfrytëzojnë sallat e bibliotekës në bazë ditore.**
- **Numri i librave, revistave e materialeve tjera të huazuar tek fëmijët ka qenë diku mbi 900 libra, kurse tek studentët dhe dashamirësit e leximit (të rriturit) afërsisht 660 libra.**
- **Gjatë muajit gusht janë bartur në bazën e katalogut elektronik të gjithë anëtarët e bibliotekës nëpër sektorë" fëmijë, sektori i të rinjve, shkencori dhe ai i të rriturve mbi 1300 anëtarë.**
- **Janë përpunuar inventarizuar dhe kataloguar dhe po ashtu janë vendosur edhe etiketa të koduara mbi 800 libra të autorëve të vendlindjes dhe autorëve botëror dhe autorë të përpunuar – 90**
- **Gjatë muajit gusht nga ojq bashkëpunuese "kosovo makers league dhe "qytetari digjital" biblioteka (sektori i fëmijëve) përmes projektit ka përfituar dy robotë të mençur si pjesë e garës kombëtare të bibliotekave publike.**
- **Në muajin shtator kanë ndodhur këto aktivitete:**
- **-led com është duke punuar për konfigurimin e pajisjeve për funksionalizimin e sistemit të katalogut elektronik të bibliotekës, për të dhënë shërbime në modulin e huazimit.**
- **-aktivitete të rregullta me fëmijë – qytetari digjital**

- **-janë regjistruar deri tani  54 anëtar gjatë muajit.**

## Sektori i Rinisë

- **Sektori i rinisë në bashkëpunim me organizata rinore nga qyteti i Gjilanit, po ashtu edhe me OJQ-të në nivel nacional, ka bashkëpunuar në kërkesat e drejtuar neve si DKRS, respektivisht sektorit të rinisë.**
- **Më poshtë po ju bashkëngjisim aktivitetet e realizuara gjatë periudhës janar- qershor:**

**1. Në bashkëpunim me OJQ, toka në periudhën janar-mars janë mbajtur 10 aktivitete në Shtëpinë e Rinisë, me nxënës të shkollave të mesme.**
**2. Social Hub në Gjilan, në periudhën janar-mars ka mbajtur trajnime në fushën e Dizajnit Grafik.**
**3. Në muajin mars, Social Hub, ka certifikuar të rinjtë të cilët kanë ndjekur trajnimet e organizuar për pjesën e parë janar-mars.**
**4. OJQ Liza-R, ka mbajtur trajnime  për të rinjtë e Gjilanit për shkathtësi të buta.**
**5. Kemi mbajtur sesion informues për OJQ-të, në lidhje me aplikimin në thirrjen publike të organizuar nga DKRS.**
**6. Me 4 prill, ka përfunduar punëtoria “Techstitution”, e organizuar nga IPKO Foundation në bashkëpunim me DKRS, ku pas 5 ditëve trajnim janë certifikuar të rinjtë e shkollave të mesme nga Gjilani. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport / Direktorat za Kulturu, Omladinu i Sport/Department of Culture, Youth and Sport**
**7. Në cilësinë e ekspertit për çështje rinore jam pjesë e grupit punues për ndryshim/plotësim të ligjit për Fuqizimin e Pjesëmarrjes së rinisë nga MKRS.**
**8. Ipko Foundation për 5 ditë rresht ka zhvilluar punëtorin e saj PODIUM, me programin Avokim për Ndryshim. Ku 50 të rijnë të shkollave të mesme kanë pasur mundësinë të jenë pjesë e kësaj punëtorie.**
**9. Ballkan Union në bashkëpunim me Komuna e Gjilanit/ DKRS kanë hapur thirrje për Bizneset për punë praktike për të rinj, 50 të rinj do të mund të përfshihen në Fushën e marketingut digjital, zhvillimit të ueb-it, dizajnit grafik dhe punime dore dhe artizanale.**
**10. Social Hub- Gjilan ka mbajtur punëtorinë për zhvillimin e aftësive të buta për të rinjtë nga Gjilani.**
**11. 50 të rinj të Gjilanit kanë marr pjesë në Punëtorinë UPSHIFT Tematik, gjatë të cilës kanë punuar bashkë me mentorët e tyre për t'i zhvilluar edhe më tej idetë për pasurimin e platformës shkollat.org, duke e bërë atë më atraktive dhe të dobishme për të gjithë ata që e shfrytëzojnë, për të përvetësuar njohuri të reja.**

**Ky projekt është financuar nga UNICEF e realizuar nga IPKO Foundation dhe e mbështetur nga DKRS me hapësirë për realizimin e kësaj punëtorie.**
**Në sektorin e rinise në periudhën korrik-gusht, ka qenë mjaftë e qetë sa i përket aktiviteteve rinore si pasojë e përfundimit të shkollave të mesme, përfundimi i semestrave në universitet si dhe përfundimi i projekteve dhe shkuarja në pushim e OJQ-ve në këtë periudhë të verës.**

**Disa nga aktivitetet të cilat kanë qenë nën domen të sektorit të rinisë, mund të veçohen;**

**1. OJQ Liza-R, në muajin gusht ka mbajtur trajnim 2 ditor për 20 të rinj të moshave mbi 18 vjeç, te financuar nga USAID, ARTC dhe të përkrahur nga DKRS, me hapësirat e nevojshme.**
**2. Me 25 gusht, OJQ Liza-R përfundoi trajnimin disa ditor në projektin "Rritja e sigurisë njerëzore dhe krijimi i një mjedisi të sigurte për të rinjtë", i cili u mbajt në hapësirat e Shtëpisë së Rinisë.**
**3.Me 29 gusht, filloi kampanja vetëdijesuse me qellim mbi informimin rreth ligjit Nr. 05/L-002, të projektit Rritja e sigurisë njerëzore dhe krijimi i një mjedisi të sigurte për të rinjtë, me qëllim të parandalimit të VERLT.**
**4. Mbajtja e takimit Online me përfaqësuesit e OJQ-ve rinore dhe aktereve qeveritar mbi nevojat e të rinjve, në kuadër të muajit të rinisë.**

**Shtator:**

-Rregullimi i problemeve të rrymës në Shtëpinë e Rinisë
-Memorandum bashkëpunimi me Beetroots academy për trajnim të të rinjve në fushën e IT
-Memorandum bashkëpunimi me Procoders academy- Trajnim i të rinjve ne Programim- Java evropiane e Kodimit 8-24 tetor 2022.
-Shfaqje teatrale me titull ''… edhe Unë'' nga ARTPOLIS Prishtinë 27.09.2022

## SEKTORI I SPORTIT

Palestra e Sporteve ''Bashkim Selishta-Petriti''

Ju njoftoj se gjatë periudhës së raportimit, palestra e sporteve ka funksionuar sipas orarit të përcaktuar të punëtorëve dhe orarit të ushtrimeve.
-Gjatë muajit janar, klubet sportive nuk kanë qenë të angazhuara maksimalisht për shkak të pushimit të tyre dimërore, por nga gjysma e dytë e janarit kanë filluar të kthehen në stërvitje të rregullta.
-Gjatë muajit shkurt klubet sportive kanë qenë të angazhuara maksimalisht me ushtrime dhe gara.
-Gjatë muajve mars, prill, maj, qershor palestra e sporteve ka funksionuar me kapacitete maksimale sa i përket ushtrimeve dhe garave kampionale.
Nga fillimi i vitit dhe deri tani sa po raportojmë i kemi pasur 99 aktivitete sportive nga të gjitha kategoritë:

- 35 ndeshje basketboll,
- (KB Drita M, KB Drita F KB United Basket M, KB United Basket F,)
- 4 ndeshje basketbolli Meshkujt ekipi senior
- 8 ndeshje basketbolli meshkujt grup moshat e reja
- 11 ndeshje basketbolli femrat ekipet seniore
- 8 ndeshje basketbolli femrat grup moshat e reja
- 30 ndeshje volejbolli (KV Drita M, KV Drita F, KV Akademia Drita F)
- 8 ndeshje  meshkujt ekipi senior
- 7 ndeshje meshkujt grupmoshat e reja
- 11 ndeshje femrat ekipet seniore
- 8 ndeshje femrat grupmoshat e reja
- 25 ndeshje hendboll ( KH Drita M, KH Drita F)
- 5 ndeshje meshkujt ekipi senior
- 1 ndeshje meshkujt grupmoshat e reja
- 9 ndeshje femrat ekipi senioreve
- 10 ndeshje femrat grupmoshat e reja
- 9 ndeshje futsall (KF Përlepnica, KF Jetoni FC)

Këtu bëjnë pjesë edhe garat e sportit shkollore, për disiplinat volejboll, basketboll, hendboll dhe futsall, liga shkollore NBA e organizuar nga Federata e Basketbollit të Kosovës etj.

27,28,29 korrik në Palestrën e Sporteve është organizuar panairi i bizneseve në kuadër të panairit E JONA.

Në muajin shtator është bërë ndarja e pjesës së sallës së ushtrimeve për KK Emperors në Palestër Sportive, dhe rregullimi i ndriçimit në Palestër.

-Aktivitete: Ndeshje kampionale 2
Ushtrime të rregullta me kapacitet të plotë, për çdo ditë nga ora 09:00-22:00.

## FUSHA NDIHMËSE

Sektori i sportit tanimë shquhet për organizimin e veprimtarive sportive që janë të shumta dhe të ngjeshura, si sektor i sportit kemi bërë përpjekje që të përballemi edhe pse me vështirësi duke pasur parasysh problemet dhe nevojat  e mëdha financiare të klubeve të shumta sportive të qytetit të Gjilanit.

Këtë vit kemi filluar që t'i zhvillojmë pothuajse të gjitha aktivitetet sportive kalendarike të sektorit të sportit, ndërsa garimi i klubeve tona ka vazhduar me plot suksese në liga të ndryshme ku ato zhvillojnë aktivitetin e tyre.

**Në bashkëpunim me Komitetin Olimpik të Kosovës, kemi organizuar javën e sportit më datë 13 prill në stadiumin ndihmës.**
**Dita ndërkombëtare e sportit për zhvillim dhe paqe shënohet në tërë botën dhe mbledhë botën e sportit, shoqërinë civile, politikën, pasi që Asambleja e OKB-së, më 6 prill 2013 e kishte shpallur këtë ditë, duke u ndërlidhur me 6 prillin e vitit 1896, ditën e hapjes së Lojërave Olimpike Moderne të mbajtura në Athinë të Greqisë.**
**Këtë vit, DKRS në bashkëpunim me KOK-u, ka organizuar aktivitete sportive për fëmijët në këto sporte si: futboll, basketboll, atletikë, tenis, karate, ngjitje dhe joga.**

**Në kuadër të programit "Grassroots", në bashkëpunim me Federatën e Futbollit të Kosovës është organizuar festivali i futbollit për nxënësit e shkollave të mesme për të dy gjinitë.**
**Implementimi i këtij programi kishte për qëllim masivizimin e futbollit në vendin tonë, duke aktivizuar dhe stimuluar nxënësit të merren me sportin më të popullarizuar në botë. Të pranishëm ishin mbi 100 nxënës të shkollave të mesme.**

**Për nder të ditës së çlirimit të Gjilanit edhe sektori i sportit kishte aktivitetet kalendarike të cilat e shënuan këtë ditë.**
**Në bashkëpunim me Shoqatën e Pedagogëve të Kulturës Fizike kemi organizuar vrapimin e qytetit si dhe garat në not më nxënësit e shkollave të Gjilanit.**

**Gara në not u mbajt në pishinën Evropa 2002, ku numri i shkollave pjesëmarrëse në garat e notit ishte i kënaqshëm dhe u arritën rezultate shumë të mira.**

**- Më 15 qershor, në kuadër të Ditëve të Lirisë së Gjilanit, u mbajt turneu në futboll të madh në nderim të figurave të shquara të futbollit dhe sportit gjilanas, të ndjerëve: Prof. Kemajl Halimi (Raci), Reshat Osmani (Reshi) dhe Prof. Hafiz Gashi.**
**Pjesëmarrës ishin:**

- **Reprezentacioni i Kosovës ( V );**
- **Veteranët e Kumanovës –Kumanovë;**
- **F.C. "DRITA" (V) – Gjilan dhe**
- **S.C. "GJILANI" (V).**

**Ekipet pjesëmarrëse dhe fituese u nderuan me mirënjohje e kupa, kurse familjet e të ndjerëve me MIRËNJOHJE për kontribut jetësor.**
**Gjatë periudhës së korrikut kanë pushuar të gjitha aktivitetet, kurse në muajt gusht-shtator në stadiumin ndihmës janë zhvilluar shumë punime në shumë pozicione të cilat kanë qenë mjaft të nevojshme për plotësimin e kritereve për zhvillimin e ndeshjeve kampionale të ekipeve elitare të komunës sonë FC Drita si dhe SC Gjilani.**

**- Ka filluar puna për rregullimin e fushës ndihmëse të SC Gjilanit në lagjen e Zabelit, d.t.th pas rregullimit të infrastrukturës, gjegjësisht inicimin për largimin e telave të tensionit të lartë që kanë qenë pengesë për gati 2 vjet për të filluar punën.**

**Gjatë kësaj periudhe saktësisht në muajt korrik dhe gusht në stadiumin ndihmës janë zhvilluar shumë ndeshje kampionale dhe stërvitje të klubeve si :**
**Klubet që e shfrytëzojnë stadiumin kryesorë të Qytetit si dhe stadiumin ndihmës janë:**

- **FC Drita (Superliga e Kosovës)**
- **SC Gjilani (Superliga e Kosovës)**
- **Kff Intelektualet (Superliga e Kosovës)**
- **Kf Galaksia (Liga e tretë)**
- **Kf Bashkimi (Liga e tretë)**
- **Sc Gjilani (juniorët, Superliga)**
- **Gs Gjilani (Juniorët liga 1)**
- **Kff Intelektualet( kadetet)**
- **Sc Gjilani(Kadetët)**
- **Klubi i Veteraneve Drita**
- **Klubi i Veteranëve Gjilani**

**Këto klube gjatë një muaji si nikoqir i zhvillojnë 55 ndeshje kampionale si dhe 181 stërvitje gjatë një muaji, ndërsa në muajt gusht dhe shtator janë zhvilluar 110 ndeshje kampionale si dhe 362 stërvitje.**
**Në muajin shtator është bërë ndarja e Pjesës së Zhveshtores të Stadiumi ndihmës për FC Drita.**

## STADIUMI I QYTETIT

- **Gjatë kësaj periudhe Stadiumi i Qytetit është shfrytëzuar nga Klubet Futbollistike për ndeshje Kampionale dhe ushtrime të Klubeve:**

**Janar-Qershor**

- **Në stadium gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar 11 ndeshje kampionale nga FC Drita dhe SC Gjilani.**
- **Stadiumi është shfrytëzuar për ushtrime të Klubeve, ku për këtë periodë janë zhvilluar gjithsej 39 ushtrime nga Klubi Futbollistik Drita dhe Klubi Futbollistik - Gjilani.**
- **Mirëmbajtja e Fushës përveç ujitjes paradite dhe pasdite dhe pastrimit çdo ditë, është bërë edhe kositja e barit.**
- **Në muajin korrik kanë pushuar të gjitha aktivitetet, kurse në muajt gusht-shtator në stadiumin e Qytetit të Gjilanit, aktivitetin e kanë zhvilluar klubet e ligës së tretë dukë i zhvilluar gjithsej 12 ndeshje kampionale si dhe klubet FC Drita dhe SC Gjilani kanë zhvilluar gjithsej 20 seanca stërvitore.**

**Aktivitetet në përgjithësi:**

- **DKRS/Aktivitete kulturore, ekspozita në Galeri dhe Teatër: 89 Aktivitete**
- **Bibliotekë: 6 aktivitete**
- **Rini:23 aktivitete**
- **Palestra e Sporteve: 105 aktivitete**
- **Stadiumi ndihmës: 21 aktivitete (pa llogaritur ndeshjet kampionale)**
- **Stadiumi i Qytetit: 82 aktivitete ( 23 ndeshje kampionale dhe 59 ushtrime të klubeve)**

**Investime:**

**-Rritja e subvencioneve për sektorin e sportit 40,000.00 €**
**-Ndarja e fondit për blerjen e Librave 10,000.00 €**
**-Rivitalizimi i fushës ndihmëse për zhvillimin e ndeshjeve kampionale**
**-Ri-hapja e Muzeut Etnologjik**
**-Inicimi për fillimin e punimeve në fushën ndihmëse të SC Gjilanit në lagjen Zabel**
**-Krijimi i databazës për Artistët dhe Vullnetarët e Qytetit-website www.kulture06.com**
**-Projekti ‘’Social Hub’’-Shtëpia e Rinisë, bashkëfinancim prej 144,825.10 € nga Komuna** prej: 144,825.10 € nga Komuna.

# ZYRET DHE NJËSITË

8. Zyret dhe Njësitë

I. Zyra e Prokurimit

Ky raport paraqet të dhënat për kontratat publike, ndarja e tyre mbi bazën e llojit të procedurave të përdoruara nga autoritetet kontraktuese, nivelin e përdorimit të këtyre procedurave, nivelin e konkurrencës brenda tregut publik, duke ofruar bazën ligjore në mbështetje të shpenzimeve në mënyrë të duhur të parasë publike, si dhe indikator tjerë të rëndësishëm për matjen e performancës së prokurimit publik në Komunën e Gjilanit.

**1.Ngjarjet kryesore gjatë këtij raporti**

Gjithashtu në muajin janar – qershor më dt. 05.04.2022 është dorëzuar në AQP Planifikimi Final i Prokurimit Publik për vitin 2022, bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik pas miratimit të buxhetit për vitin fiskal, duhet të dorëzohet me shkrim Planifikimi Final i Prokurimit në AQP.

**Aktivitetet e kryera gjatë periudhës 2021- 2022 ( kontratat e Nënshkruara )**

1. Shërbim me zërim, binë dhe ndriçim në Komunën e Gjilanit.

2. Rrënimi i Objekteve

3. Furnizim me pajisje për shuarje të zjarrit, pushkë impulsive për SHZSH-N

4. Transporti i nxënëseve nga lagjja e Muhaxherëve të Shillovës deri në sh.f. Thimi Mitko-Gjilan

5. Transporti i Nxënësve nga Dunavi, Pidiç ,Çelik , Lagjja e Maliqve deri në sh.f. Bajrami Curri

**2.1 Zhvillimi i procedurave të prokurimit vitit 2022**

Gjatë muajve janar-shtator janë 82 aktivitetet të prokurimit janë zhvilluar, bazuar në planifikimin final të prokurimit dhe ( në bazë të marrëveshjeve te mirëkuptimit me MAPL ) duke respektuar hapat në vijim sipas Udhëzuesit Operativ për prokurim publik:

- Pranimi i kërkesës për inicim dhe Deklaratën e Nevojave
- Parashikimi i Vlerës dhe Klasifikimi i kontratës
- Përcaktimi i Procedurës së Prokurimit
- Përgatitja e Dosjes së Tenderit
- Publikimi në web faqe e-prokurimit të KRPP
- Hapja dhe Vlerësimi i Tenderëve
- Njoftimi për Dhënie dhe Nënshkrimi i Kontratës
- Menaxhimi i Kontratës

**2.2 Kontratat e nënshkruara :**

1. Furnizim me pajisje për shuarje të zjarrit, pushkë impulsive për SHZSH-N
2. Furnizim me pemë dhe perime për çerdhet dhe konviktin
3. Furnizim me farë misri
4. Furnizim me letër për Komunën e Gjilanit
5. Furnizim me ushqim të kafshëve (sanë), koncentrat dhe kontroll mjekësore-Ri Tender
6. Furnizim me material laboratorik
7. Furnizim i shkollës me mjete teknologjike me qëllim të realizimit të praktikës shkollore
8. Furnizim me aparat dhe kartela për hyrje dhe dalje
9. Furnizim me farë gruri
10. Furnizim me ditar për shkolla
11. Furnizim me sera të zinguara
12. Furnizim me teknologji informative Sh.f.Sadulla Brestovci –Gjilan
13. Furnizim me TV të mençur
14. Furnizim me dru
15. Furnizim dhe instalim të pompave termike në objektin e NJPZSH-së Gjilan
16. Furnizim me rafta metalik
17. Furnizim me shtëpiza për bleta tre katëshe
18. Furnizim me 30 pajisje të GPS për montimin e lëvizjeve të automjeteve dhe mirëmbajtja në Komunën e Gjilanit
19. Transporti i nxënësve dhe punëtorëve
20. Furnizim me material botues

**Vlera minimale**

1. Furnizim me Smart TV
2. Furnizim me pajisje teknologjike
3. Furnizim me material higjienik-sanitar për QKMF-në.
4. Furnizim me foto video kamerë profesionale, mikrofon profesional dhe wireless mikrofon, mikrofon për largësi dhe mbajtëse e foto video kamerës.
5. Furnizim me dyshek për pushim pasiv në objektin NJPZSH-së Gjilan
6. Furnizim me reagenca për laborator -
7. Furnizim me material higjenik- administratë
8. Furnizim me mjete higjienike për çerdhet - Ardhmëria 1,Ardhmëria 2, Integj, IP Dardania- Ri Tender
9. Furnizim me bllok për kundërvajtje
10. Furnizim me reklamë për ndriçim – QKMF
11. Furnizimi dhe mbishkrimi në ordinancë dhe sinjalizimi orientues për QKMF-n e re
12. Furnizim me makinën për pastrimin e automjeteve
13. Furnizim me material higjenik për drejtoritë Komunale- Ri tender
14. Furnizim me pompë të ujit për drejtorinë e Arsimit
15. Furnizim me filtër të vajit, naftës, ajrit dhe poqa për mirëmbajtjen e automjeteve të rënda (Kamionët) për NJPZSH- Ri Tender
16. Furnizim me filtër të vajit, naftës, ajrit dhe poqa për mirëmbajtjen e automjeteve të rënda (Kamionët) për NJPZSH- Ri Tender
17. Furnizim me Internet për shkollën “Mulla Idrizi” Gjilan
18. Furnizim me pesticide, farishta dhe repromaterial për pemishte dhe sera-RI-Tender
19. Furnizim me oksigjen medicinal dhe bombola
20. Furnizim me material laboratorik- 2151
21. Furnizim me karrige statike për drejtorin e Buxhetit dhe Financa- 1022
22. Furnizim me material laboratorik- 837
23. Shërbime avokati dhe përfaqësim juridik - 1990
24. Transporti i nxënësve në relacionin Nasal- Lladovë dhe anasjelltas- 1707
25. Shërbime Avokati dhe përfaqësim ligjor- 794
26. Shërbime të Avokatisë dhe përfaqësim ligjor- 3434
27. Transport i nxënësve në relacionin Sllubicë, Stublinë deri në sh.f. “Liria” Pograxhë 4345
28. Transporti i grupit të Intelektualëve 4921
29. Shërbime Avokati dhe përfaqësim ligjor - 6689
30. Furnizim me material laboratorik -3283
31. Transporti i punëtorëve të teatrit 6308
32. Matje gjeodezike me dron
33. Çmontimi i karrigeve stomatologjike
34. Transporti i nxënësve dhe mësimdhënësve relacioni Gjilan-Prizren- 6612
35. Pastrimi i xhamave në QKMF-ne e Re.
36. Shërbime të Avokatisë dhe përfaqësimit ligjor – 8041
37. Transporti i tifozëve- 6993
38. Shërbime të Avokatisë dhe përfaqësimit ligjor - 9462
39. Servisimi i gjeneratorëve (Drejtoria për buxhet dhe financa, Zhvillim Ekonomik, Prokurimi) dhe QMF-ve
40. Mbushja dhe servisimi i aparateve për shuarje të zjarreve.
41. Shërbime të Avokatisë dhe përfaqësimit ligjorë Ri-Ri Tender 11654

**Kontratat e nënshkruara të punës**

1. Rruga në lagjen Porodin, kanalizimi fekal dhe ujësjellësi
2.Asfaltim i rrugëve në lagjen Arbëria
3. A asfaltim i rrugëve në fshatin Llashticë
4.Asfaltim i rrugëve në fshatin Nasal
5. Asfaltim i rrugëve në fshatin Haxhaj
6.Asfaltim i rrugëve në lagjen e vishnjeve pjesa 1
7. Hartimi i planit komunal të veprimit për energji dhe klimë
8..Dezinfektimi, dezinsektimi dhe deratizimi i objekteve të Komunës
9.Terrenet sportive një llote
10.Rrënimi i objekteve pa leje

**Aktivitetet që janë në vlerësim :**

1.Asfaltim i rrugëve lidhëse në rrugën Qarkore
2. Ndërtimi i parkut “Baja”
3. Mirëmbajtja dimërore
4..Furnizim me letër
5. Furnizim me material higjenik

6. Furnizim me karrige
7.Furnizim me goma për kamion
8.Furnizim me mekanizëm bujqësor
9.Terrenet sportive
10.Furnizim me makina për rroba larje

**Aktivitetet të cilat janë në publikim:**

- Furnizim me pelet
- Furnizim me gjenerator
- Mirëmbajtja e e-kioskave
- Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadish
- Rrugët Jonuz Tërstena, 28 Nëntori
- Asfaltim i rrugëve në lagjen Livadhet e Arapit
- Asfaltimi, kanalizimi dhe ndriçimi publik në rrugën "Nënë Terezë"
- Ndërtimi i bazamentit për trafon në shkollën e muzikës
- Asfaltim i rrugëve Gadish

Departamenti i Prokurimit si përgjegjëse për menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të prokurimit të Autoritetit Kontraktues –Komunës së Gjilanit, sistematikisht është angazhuar për të procesuar të gjitha kërkesat e pranuara nga Njësitë e kërkesës, duke i zhvilluar aktivitetet sipas llojit dhe procedurave përkatëse të prokurimit.

Për periudhën Janar-Shtator të vitit 2022, janë udhëhequr 21 aktivitete të prokurimit, prej tyre:

1. Procedurë e hapur 34 aktivitete
2. Vlera minimale 41
3. Procedurë e negociuar -3 ( pastrimi i objekteve shkollore dhe furnizim me material laboratorik)
4. Procedura me minitender - 2 aktivitete
5. Ankande publike 1
6. Aktivitete të cilat janë të publikuara në procedurë 9
7. Anulime janë 5

## II. Njësia e Kuvendit

Bazuar në Planin e punës të Njësisë së Kuvendit dhe Planin e punës të Kuvendit për periudhën janar-shtator 2022, Njësia e Kuvendit ka kryer këto aktivitete:

- Përgatitja profesionale dhe teknike e seancave të rregullta, solemne, të jashtëzakonshme dhe urgjente të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, bazuar në orarin vjetor për mbajtjen e seancave të KK-Gjilan,
- Përgatitja profesionale dhe teknike e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komiteteve tjera të parapara me Statutin e Komunës, bazuar në kalendarin vjetor për mbajtjen e mbledhjeve të Komiteteve,
- Përcjellja e takimeve dhe mbajtja e procesverbaleve të KK-së dhe Komisioneve tjera të formuara nga KK-ja,
- Përkthimi i të gjitha materialeve të Kuvendit, Komiteteve, Zyrës së Kryetarit dhe organeve tjera komunale, si dhe përkthimi simultan i seancave të rregullta dhe të tjera të Kuvendit, Komiteteve dhe takimeve tjera të institucioneve komunale,
- Dërgimi në MAPL i raportit mujor, për të gjitha aktet dhe shkresat e përkthyera të lëshuara nga Institucionet komunale,
- Lekturimi i të gjitha materialeve të Kuvendit dhe Komiteteve, dhe materialeve e akteve tjera të KK-së,
- Ekspedimi me kohë i të gjitha materialeve për seancat e Kuvendit, Komiteteve dhe takimeve tjera të institucioneve komunale, në formë fizike dhe elektronike,
- Përgatitja teknike e Sallës së Kuvendit, kujdesi për mirëmbajtjen e aparaturës për zërim dhe incizimi përmes kamerës dhe incizimi tonik i seancave.
- Njoftimi me kohë i anëtarëve të Kuvendit për mbajtjen e seancave të KK-së,
- Dërgimi i të gjitha vendimeve, rregulloreve dhe akteve tjera në MAPL për vlerësim të ligjshmërisë bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale,
- Dërgimin e raporteve të rregullta mujore në MAPL për të gjitha aktet e miratuara nga KK-Gjilan,
- Ekspedimi me kohë i të gjitha vendimeve, rregulloreve, rekomandimeve e akteve tjera brenda institucioneve komunale, me qëllim të implementimit të tyre.,
- Bashkëpunimit brenda institucioneve komunale dhe me organet qeveritare dhe ministritë tjera të linjës, në funksion të mbarëvajtjes së funksionimit sa më të mirë të organeve komunale.

Gjatë periudhës janar-shtator 2022, Kuvendi dhe Komitetet e KK-së, kanë mbajtur takimet si në vijim:

- Kuvendi ka mbajtur një seancë inauguruese, një seancë urgjente, një të jashtëzakonshme, tri seanca solemne dhe nëntë seanca të rregullta. Në seancën Inauguruese është bërë konstituimi i Kuvendit dhe kanë dhënë betimin anëtarët e KK-së dhe Kryetari i Komunës të dalë nga rezultati i zgjedhjeve lokale të mbajtura në fund të vitit 2021, përderisa në seancën Urgjente është zgjedhur Kryesuesi i KK-Gjilan. Kuvendi i Komunës, në nëntë mbledhjet e rregullta të mbajtura ka miratuar 53 vendime, prej të cilave dy rregullore komunale ( Rregulloren për shfuqizimin e rregullores për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizik dhe juridik, si dhe Rregulloren për plotësimin dhe ndryshimin e rregullore për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve), ka miratuar Strategjinë për përfshirje Sociale 2022-2024 të Komunës së Gjilanit, si dhe ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar për vitin 2021, si dhe ka miratuar buxhetin e Komunës së Gjilanit për vitin 2023, po ashtu gjatë kësaj periudhe Kuvendi i Komunës së Gjilanit, me qëllim të promovimit të të drejtave të komuniteteve jo shumicë ka emëruar Nënkryetarin e Komunës për Komunitete si dhe ka themeluar Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB). Kuvendi i Komunës gjatë kësaj periudhe ka miratuar edhe propozimin e Ekzekutivit të Komunës për lidhjen e Marrëveshjes për kryerjen e shërbimeve komunale me NPL “Tregu”. Në mbledhjet në vijim do të shqyrtohen edhe raportet e Ndërmarrjeve Publike Lokale, si dhe do të formohen Komisionet komunale të aksionarëve në këto ndërmarrje.
- Komitetet obligative, Komiteti për Politikë dhe Financa, ka mbajtur katër takime dhe ka nxjerrë 32 Rekomandime për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, përderisa Komiteti për Komunitete ka mbajtur, pos takimit konstituiv edhe tri takime pune.

Komitetet tjera jo obligative gjatë kësaj periudhe kanë mbajtur takime si në vijim:

- Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka mbajtur tri takime
- Komiteti për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit ka mbajtur tri takime dhe ka nxjerr një rekomandim për Kuvend
- Komiteti për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, ka mbajtur tri takime dhe ka nxjerr dy rekomandime për Kuvend
- Komiteti për Arsim ka mbajtur katër takime
- Komiteti për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, ka mbajtur dy takime dhe ka nxjerrë katër rekomandime për Kuvend
- Komiteti për Kulturë, Rini dhe Sport, ka mbajtur tri takime
- Komiteti për Zhvillim Ekonomik dhe Agrikulturë ka mbajtur katër takime dhe ka nxjerrë tri rekomandime për Kuvend
- Komiteti për Barazi Gjinore ka mbajtur tri takime
- Komiteti për Bashkëpunim Ndërkufitarë ka mbajtur dy takime
- Komiteti Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara ka mbajtur dy takime dhe ka nxjerr një Rekomandim.

Po ashtu gjatë muajit qershor, Komiteti për Politikë dhe Financa, ka mbajtur Dëgjimet Publike me qytetarë në pesë lokalitete të Komunës, para draftimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitin 2023 dhe Vlerësimet e hershme për vitet 2024/2025. Dëgjimin e fundit me qytetarë, KPF e ka mbajtur në sallën e mbledhjeve të Kuvendit më 21.06.2022 nga ku kanë dal propozime dhe kërkesa nga qytetarët për nevojat dhe përmirësimin e jetës së tyre. Po ashtu, në fazën e konsultimeve me qytetarë para miratimit të buxhetit të Komunës për vitin 2023, janë mbajtur 12 takime me qytetarë në lokalitete të ndryshme të Komunës së Gjilanit

Njësia e Kuvendit gjatë periudhës janar-shtator 2022, ka dërguar në MAPL, të gjitha aktet e miratuara, për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç është paraparë në nenin 81 të LVL dhe nga ky bashkëpunim që kemi pasur me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, në lidhje me vlerësimin e ligjshmërisë të akteve të dërguara, Kuvendi i Komunës ka bërë rishqyrtimin e katër akteve të miratuara nga KK Gjilan: Rishqyrtimin e përbërjes gjinore të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete, rishqyrtimin e Vendimit për formimin e Komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zv.drejtorëve të IEAA-se si dhe rishqyrtimin e Vendimit për dhënien e pronës në shfrytëzim për raste të veçanta (KEDS).

## III. Njësia e Personelit

Raporti i punës përfshin përmbledhjen e aktiviteteve punuese në Njësinë e personelit për periudhën Janar – Qershor 2022.
Njësia e personelit merret kryesisht me menaxhimin e burimeve njerëzore të cilët janë pasuria kryesore e një organizate buxhetore.
Menaxhimi i burimeve njerëzore është proces i cili tejkalon kufijtë e njësive buxhetore dhe përbëhet nga disa komponente edhe atë:
Planifikimi, punësimi, menaxhimi i performancës, trajnimi dhe zhvillimi i karrierës së nëpunësve civil.
Poashtu Njësia e personelit bënë mbikëqyrjen dhe zbatimin e dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore, kryesisht nga marrëdhënia e punës dhe procedura administrative, duke bashkëpunuar dhe koordinuar veprimet e saj me Kryetarin e Komunës dhe drejtoritë përkatëse lidhur me zbatimin e përgjegjësive të Komunës të cilat rrjedhin nga ligjet dhe aktet nënligjore nga sfera e marrëdhënies së punës dhe pagave të SHC.
Andaj, Njësia e personelit në kuadër të planit të saj punues këtë vit ka kryer aktivitetet punuese si në vijim:

Akt emërime 8, Kontrata në vepër dhe kontrata tjera 229, ka shpallur 3 konkurse për 3 pozita me gjithsej 27 dokumente, hartimit i 302 vendime të ndryshme, 23 takime pune, 44 vërtetime të ndryshme, 133 pushime mjekësore, pushime vjetore 644, 12 pushime të tjera, ka hartuar shkresa 108, njoftime 44, përgjigje 14, kërkesa të ndryshme 36, përshkrimi i pozitave punuese për nevoja të drejtorive 59, plotësimi i formularëve për MAP 245, 159 konsultime me zyrtarë dhe të tjerë, aktivitete të ndryshme 35, janë përpunuar, skanuar dhe regjistruar në SIMBNJ 12 dosje, janë skanuar dhe kopjuar 220 dokumente, si dhe 68 shërbime dhe këshilla të ndryshme.

**Aktivitetet shtesë:**

- Mbajtja e përhershme e evidencës së punëtorëve të Komunës përmes sistemit elektronik;
- Menaxhimi me lista të pagave së Shërbyesve civil;
- Menaxhimi me stafin në aspektin e mbajtjes së trajnimeve të ndryshme;
- Raportimi nivelit qendror; MAPL dhe MAP për numrin e punëtoreve sipas gjinisë, kualifikimit, etnitetit etj;
- Përgatitja e formularëve: për punëtorë të rinj, ndryshime, të larguar, retroaktive dhe dërgimi i tyre në Ministrinë e Administratës Publike - Divizioni i pagesave, Prishtinë;
- Ofrimi i të dhënave për auditorin e brendshëm, jashtëm dhe KPMSHCK;
- Përpunimi dhe azhurimi i listës së SHCK;
- Bashkëpunimi me të gjithë drejtoritë komunale sa i përket aspektit të nëpunësit civil;
- Përgatitja e konkursve, publikimi i tyre dhe zhvillimi i procedurave rekrutuese konform konkurseve;
- Shfrytëzimi i pushimeve vjetore, mjekësore, vdekjes, lehonisë, etj. përmes SIMBNJ
- Përpunimi i dosjeve të nëpunësve civil dhe vendosja e dosjeve në SIMBNJ
- Pjesëmarrja në trajnime rreth SIMBNJ, monitorimit të performancës, etj.

## IV. Njësia për të Drejtat e Njeriut

Raporti pasqyron përmbledhjen e punëve të Njësisë Komunale për të Drejtat e Njeriut për periudhën 9 mujore 2022.

Në raport janë prezantuar aktivitetet që pasqyrojnë dhe reflektojnë angazhimin dhe rezultatet e shënuara gjatë kësaj periudhe të cilat i trajton Njësia për të Drejtat e Njeriut si mekanizëm përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivelin komunal.

Monitoron përputhshmërinë e respektimit të standardeve për të Drejtat e Njeriut në këto fusha: mundësi të barabarta, mbrojtje nga diskriminimi, barazi gjinore, të drejtat e fëmijëve, personat me nevoja të veçanta, të drejtat e komuniteteve, përdorimi i gjuhëve dhe kundër trafikimit me qenie njerëzore e tjera.

Koordinatori dhe zyrtaret e NJDNJ gjatë kësaj periudhe 9 mujore kanë monitoruar seancat e Kuvendit, Komiteteve dhe takime të tjera të organizuara në kuadër të komunës.

Zyrtarët e NJDNJ-së si anëtarë të Komisionit për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale në fushën e të drejtave të njeriut e barazi gjinore gjatë muajve (prill-maj) kanë mbledhë të dhënat e kërkuara nga MAPL për plotësimin e pyetësorit për performancë e Komunës se Gjilanit.

- Për nder të ditës se mësuesit, festës së 7 Marsit, Asambleja Komunale e Fëmijëve-Gjilan kanë zhvilluar një takim-aktivitet tek OJQ- Handikos me fëmijët me aftësi të kufizuara, ku janë njoftuar rreth edukimit jo formal të fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe shërbimet që ofron Handikosi.
- Me 11 mars 2022, së bashku me kryesinë e AF-se dhe mentorët, kemi mbajtur një takim me përfaqësueset e OJQ-se/PEMA, ku biseduam për aktivitetin e paraparë me 21 mars dita e Syndrome Down.
- Me 21 mars 2022 me AKF - Gjilan, në bashkëpunim me Qendrën e Kujdesit Ditor PEMA, në shënim të ditës Ndërkombëtare të Sindromës- Down, kemi organizuar 3 ditë aktivitete dhe takime të ndryshme. Gjatë këtyre aktiviteteve janë vizituar zyra e Kryetarit të Komunës së Gjilanit, ku janë pritur nga kryetari z. Alban Hyseni, janë vizituar drejtoritë komunale, Policia Rajonale në Gjilan dhe disa shkolla në këtë komunë, nëpër të cilat institucione është shpërndarë Deklarata me 21 zotime për gjithë përfshirjen e të drejtave të fëmijëve me sindrom Down.
  AKF-Gjilan bënë thirrje që të gjithë t'i pranojnë njerëzit me sindrom Down dhe t'i kyçin në të gjitha sferat e jetës.
- Me 8 Prill 2022 Asambleja Komunale e Fëmijëve në Gjilan, për nderë të ditës së Kushtetutës së Kosovës, ka mbajtur një takim me ish Kryetaren e Gjykatës Kushtetuese znj. Arta Rama. Në këtë takim janë njoftuar me eksperiencën e

znj.Rama sa ishte kryetare e Gjykatës Kushtetuese, e cila ka folur për pikat kryesore për Kushtetutën e Kosovës dhe rolin e Gjykatës Kushtetuese.

- Më 22 prill 2022 në shënimin e Ditës së Tokës AKF në Gjilan ka marr pjesë në një takim virtual tradicional
- Më 23 prill 2022 Asambleja Komunale e Fëmijëve në Gjilan, me moton
- “Po m ‘lexohet” , uron gjithë fëmijët për Ditën Ndërkombëtare të Librit.
- Më 27 prill 2022 AKF në Gjilan, i është bashkuar kampanjës për pastrim “ Green and Clean” Kjo kampanje ka zgjatur deri me 5 qershor.
- Për nderë të 1 Qershorit, Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, me kërkesën e grupit “ROR” dhe “AF” dhe me mbështetjen e Kryetarit të Komunës së Gjilanit, z. Alban Hyseni, si dhe me mbështetjen e NJDNJ, “SYRI VIZION” dhe “SAVE CHILDREN” kemi organizuar takim ku është folur për rëndësinë e kësaj dite dhe është bërë prezantimi i raportit “YOUNG VOICE” (zërat e rinj)
- Po ashtu për nderë të 1 Qershorit, kemi vizituar edhe Muzeun Etnografik të qytetit të Gjilanit, për të parë nga afër disa nga elementet e trashëgimisë kulturore.
- Më 6-7 korrik, u mbajt punëtoria për hartimin e planit të punës për Mos diskriminim dhe Mjedis e cila u mbështet nga Save dhe Children dhe Syri i Vizionit, ku morën pjesë anëtarët e ROR dhe grupe tjera të fëmijëve të cilët patën mundësinë t’i shprehin mendimet dhe idetë e tyre që kishin të bëjnë me parandalimin e problemeve mjedisore dhe eliminimin e diskriminimit.
- Në muajin gusht AFK, mori pjesë në fushatën senzibilizuese “Unë kam një ligj që më mbron” të organizuar nga OJQ Syri i Vizionit dhe Save the Children, ku kërkuam nga institucionet qeveritare e lokale të fillojnë menjëherë zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës i cili ka hyrë në fuqi më 17 korrik 2020.
- Gjithashtu, gjatë muajit gusht AFK mori pjesë në trajnimin “Metodologjitë praktike të avokimit ndaj institucioneve vendimmarrëse” të organizuar nga ROR, pastaj në punëtorinë e organizuar me 25-26 gusht, ku trajtuam temën e hapësirës qytetare, u identifikuan problemet dhe u dhanë propozimet për zgjidhje më të mira dhe u theksua rëndësia e përfshirjes së fëmijëve në vendimmarrje në të gjitha nivelet.
- Më 17 shtator, Grupi Respect our Rights dhe Asambletë Komunale të Fëmijëve, realizuan fushatën për parandalimin e ngacmimeve seksuale me moton “Teshat nuk m ‘definojnë” që kishte për qëllim rritjen e përgjegjësisë së institucioneve dhe vetëdijes së qytetarëve lidhur me dukuritë që kohëve të fundit janë bërë më të shpeshta.
- Më 27 shtator, ROR dhe asambletë komunale të fëmijëve, marshuan për të rritur vetëdijen dhe për të avokuar në aspektin e ndryshimeve klimatike dhe mbrojtjes së ambientit, ku të gjitha sloganet e përdoruara në këtë marsh ishin nga materialet e ripërdorura.

Gjate periudhës 9 mujore ZBGJ, bëri vlerësimin e PKBGJ, monitorimin e aktiviteteve të realizuara për periudhën 2021, 2022 në institucionet e Komunës së Gjilanit nga hyrja në fuqi e Programit te Kosovës për Barazi Gjinore.

Përgatitja e planit të veprimit për aktivitetet e Zyrës për Barazi Gjinore në harmoni me LBGJ, udhëzimet dhe rregulloret në fuqi.

**8 marsi “Dita Ndërkombëtare e Gruas” u shënua me aktivitete:**

U organizua seancë solemne e Kuvendit të Komunës me rastin e shënimit të 8 Marsit – “Ditës Ndërkombëtare të Gruas”, me qëllim për ta rikujtuar rolin e pazëvendësueshëm të gruas në ndërtimin dhe zhvillimin e shoqërisë.

Hapja e fushatës me moton: **“Protestojmë, nuk festojmë”.**

U realizua aktiviteti: **“Vendosja e këpucëve të kuqe në shkallët e teatrit**” që simbolizon vrasjet e grave dhe vajzave ndër vite! U mbajt fjalë rasti nga përfaqësues të Zyrës së Kryetarit, Zyrtarja për Barazi Gjinore dhe përfaqësues të OJQ- “Gruaja Hyjnore” dhe realizimi i ekspozitës në galerinë e qytetit me temë: **“Roli i Gruas në Shoqëri”.**

ZBGJ i rekomandoi Drejtorisë së Arsimit, që nga data **7 – 11** mars të realizohet aktiviteti: **“Java e Barazisë Gjinore”** ku në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të Komunës së Gjilanit, një orë mësimore t’i kushtohet shënimit të **“8 Marsit –“Ditës Ndërkombëtarë të Gruas”**, me qëllim të sensibilizimit të nxënësve për barazinë gjinore në përgjithësi dhe rolin e veçantë të gruas që ka në shoqëri.

Ndjekja e trajnimeve nga ZBGJ që kanë të bëjnë me buxhetimin e ndjeshëm gjinor për zbatimin e drejtë dhe efikas të parasë publike, sipas parimit të barazisë gjinore dhe

trajtimit të njëjtë të kërkesave të grave dhe burrave në nivel komunal. Lidhur me buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, është themelua task forca në nivel komunal në përbërje nga ekzekutivi, legjislativi dhe zyrtarët komunal si trupë ndihmëse për koordinimin dhe realizimin e aktiviteteve për zbatimin e parimeve për buxhetimin e ndjeshëm gjinor në Komunë.

U themelua Grupi Joformal i Grave me qëllim të fuqizimit të përgjithshëm të profilit të gruas dhe çështjeve me interes të cilat do të ndikojnë në arritjen e një mirëqenie më të madhe të saj. Në këtë kontekst, grupi ka pasur për qëllim edhe bashkëpunimin e punës së zyrës për Barazi Gjinore në lidhje me procesin e ndërmarrjes së aktiviteteve, duke e marrë parasysh numrin e madh të çështjeve që paraqiten në Komunë.

ZBGJ, në kuadër të komisionit për identifikimin e qasjes së personave me aftësi të kufizuar, kanë identifikuar të gjitha objektet publike dhe ato private që kanë më tepër frekuentim për të vlerësuar se sa i plotësojnë kushtet për qasje të personave me aftësi të kufizuar. Lidhur me këtë, së shpejti do të dalin me vlerësim për situatën reale në terren dhe do ta identifikojmë një objekt që vlerësohet si më i nevojshëm dhe me përkrahje të nivelit qendror do të bëhet i qasshëm për të gjithë personat me aftësi të kufizuar të të gjitha kategorive.

Ndjekja e trajnimeve nga ZBGJ që kanë të bëjnë me buxhetimin e ndjeshëm gjinor për zbatimin e drejte dhe efikas te parasë publike sipas parimit te barazisë gjinore dhe trajtimit të njëjtë të kërkesave të grave dhe burrave në nivel komunal. Lidhur me buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, është themelua task forca në nivel komunal në përbërje nga ekzekutivi, legjislativi dhe zyrtaret komunal si trupe ndihmëse për koordinimin dhe realizimin e aktiviteteve për zbatimin e parimeve për buxhetimin e ndjeshëm gjinor në Komunë.

ZBGJ në cilësinë e anëtares së Komisionit për performancë komunale, ka mbledhur të dhënat për të punësuarit në Institucionet publike të Komunës së Gjilanit të ndara sipas gjinisë, të dhënat për përbërjen e kuvendit dhe komiteteve të themeluara në komunën e Gjilanit, përbërjen e këshillave lokale, barazia gjinore në buxhetim për punësim dhe ndërmarrësi të grave, pjesëmarrjen e grave në takime publike, të dhënat të ndara sipas gjinisë për emërtimin e rrugëve të emërtuara pas personave, të dhënat për regjistrimin e pronës në komunë, që për vitin 2021 rezultojnë si:

2650 të punësuar në institucionet publike, 1267 burra e djem dhe 1383 gra e vajza. Përqindja e grave në Kuvendin Komunal dhe Komitetin për Politikë dhe Financa është 33.3%, në Komitetin për Komunitete 42.8%, ndërsa në komitetet tjera jo obligative është 50%.

Përqindja e grave në komisione të Kuvendit Komunal është 25%, nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të të gjithë këshillave lokale në Komunë që është 245 anëtarë.

Numri i përgjithshëm i anëtarëve të të gjithë këshillave lokale është 245, derisa numri i grave anëtare është 57, që zbërthyer në përqindje është 23%.

Sa i përket emërtimit të rrugëve pas personave, nga 699 emërtimet e bëra pas personave, 81 janë emërtuar në emër të grave dhe vajzave.

Numri i personave të regjistruara në komunë në emër të grave gjatë vitit 2021 është 304.

ZBGJ, koordinon Mekanizmin Komunal Kundër Dhunës në Familje në Komunën e Gjilanit, Gjatë periudhës 9 mujore kemi mbajtur 5 takime, në të cilat institucionet që trajtojnë rastet e dhunës në familje kanë ofruar informata për rastet e raportuara dhe të trajtuara brenda institucioneve që përfaqësojnë dhe sfidat që i përcjellin gjatë punës së tyre. Në policinë e Kosovës janë raportuar 125 raste të dhunës në familje dhe krahasuar me periudhën e njëjtë kohore të vitit 2021, 18 raste më shumë janë raportuar. E njëjta situatë është paraqitur edhe nga institucionet tjera, ku është vlerësuar se ka rritje të rasteve që raportojnë dhe kërkojnë mbrojtje.

Përmes zyrës për Barazi Gjinore është realizuar tryeza e diskutimit me temë: De-stigmatizimi dhe qasja sensitive ndaj të mbijetuarve të dhunës seksuale gjate luftës në Kosovë” ku pjesëmarrës ishin përfaqësues të Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje, nënkryetarja e komunës e përfaqësues e përfaqësuese të shoqërisë civile.

Zyrtarët e NJDNJ-së morën pjesë në takime dhe trajnime të formës virtuale dhe fizike të organizuara nga DEMOS, MAPL, MAP, OSCE, USAID, ABGJ dhe GIZ për ngritje të kapaciteteve dhe për të diskutuar çështje të ndryshme me qëllim të përmirësimit të punës në vazhdimësi dhe ngritjen e performancës komunale.

## V. Njësia e Auditimit

**1. Përshkrim i Shkurtër i Punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm:**

- Njësia e Auditimit të Brendshëm funksionon sipas Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike (Ligji nr.06/L-21), si njësi e pavarur e auditimit të brendshëm në vartësi të drejtpërdrejt të Udhëheqësit të Subjektit të Sektorit Publik (Kryetarit të Komunës). Pra i raporton drejtpërdrejt vetëm Udhëheqësit të Subjektit të Sektorit Publik dhe e njofton Komitetin e Auditimit.
- Njësia e Auditimit të Brendshëm është e plotësuar sipas kërkesave ligjore, ashtu që për vitin aktual funksionon me tre auditor, të cilët janë të certifikuar sipas kushteve të parapara me ligj;
- Auditorët e brendshëm kryejnë vetëm punët e auditimit të brendshëm;
- Auditorët e brendshëm kanë qasje të plotë, të lirë dhe të pakufizuar në të gjithë dokumentacionin e Subjektit të Sektorit Publik (SSP) ku funksionon.

Pra, Njësia e Auditimit të Brendshëm funksionon në bazë të kornizës ligjore të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe kornizës profesionale të vendosur nga Ministria e Financave dhe Transfereve dhe Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm (NJQHAB), që mbështet vlerat kryesore të ligjshmërisë, integritetit, objektivitetit, besueshmërisë, kompetencave dhe pavarësisë.

**Misioni i Auditimit të Brendshem** është që në pajtim me qëllimet e Institucioneve dhe organeve komunale:

- Të shtoj vlerën për performancën e veprimeve të Komunës duke siguruar cilësi dhe duke kryer auditime dhe shërbime këshillimore me kosto të reduktuara.
- Të sjellë përfitime në efiçiensen operacionale, kontrolle të brendshme dhe politika të përmirësuara.

**Qëllimet e Auditimit të Brendshëm janë:**

- Të jap siguri objektive, të pavarur dhe aktivitet këshillimor, i projektuar për të shtuar vlerën dhe përmirësuar veprimet e Institucioneve dhe Organeve Komunale.
- Të asistoi të gjitha nivelet e menaxhimit në kryerjen efektive të përgjegjësive të tyre me anë të vlerësimeve të pavarura, këshillimeve dhe rekomandimeve.
- Të raportoi te menaxhmenti i lartë lidhur me veprimet korrigjuese të ndërmarra nga të gjitha nivelet e menaxhimit.

**Objektiva e Auditimit të Brendshëm:**

Objektivi primar është të asistoi në menaxhimin e drejt të buxhetit, në zbatueshmërinë e plotë ligjore, në realizimin efektiv të përgjegjësive të tyre (personelit përgjegjës për ato veprime). Në këtë mënyrë i furnizon ata me analiza, rekomandime, këshilla dhe informacione lidhur me aktivitetet e shqyrtuara.

**2. Të Arriturat:**

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) punën e vetë e ka bazuar në Planin Strategjik për vitet 2022-2024 dhe Planin Vjetor për vitin 2022. Plane këto të shqyrtuara dhe aprovuara nga Kryetari i Komunës dhe Komiteti i Auditimit.

Në Planin Vjetor të NJAB-së janë planifikuar që brenda vitit 2022 të kryhen 11 auditime dhe atë brenda gjashtëmujorit të parë të kryhen pesë auditime, kurse në gjashtëmujorin e dytë është planifikuar të kryhen gjashtë auditime (në kuadër të 11 auditimeve është i planifikuar edhe një auditim eventual me kërkesë të menaxhmentit të lartë). Mirëpo pas përfundimit të gjashtëmujorit të parë me kërkesë të Kryetarit të Komunës është paraparë të bëhet rishikimi i Planit Vjetor i cili më pastaj është aprovuar nga Kryetari i Komunës dhe Komiteti i Auditimit.

Nevoja për ndryshimin e Planit Vjetor të NJAB-së për vitin 2022, ka ardhur kryesisht me kërkesë të Kryetarit të Komunës për shkak të interesimeve që të kryhen dy auditime në dy Ndërmarrje Publike, Lokale të cilat janë në pronësi të plotë të komunës. Ashtu që në Planin për gjashtëmujorin e dytë të këtij viti, është anuluar një auditim në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe janë përfshi këto dy auditime të dy Ndërmarrjeve Publike Lokale të cilat nuk kanë qenë të planifikuara për auditim.

Fjala është për Ndërmarrja Publike Lokale (NPL) "Stacioni Autobusëve" SH.A. Gjilan: *Auditimi i procesit të të hyrave, shpenzimeve dhe funksionimi i ndërmarrjes* dhe

Ndërmarrjen Publike Lokale (NPL) “Tregu ”SH.A. Gjilan: *Auditimi i procesit të të hyrave, shpenzimeve dhe funksionimi i ndërmarrjes.*

**Brenda nëntë mujorit 2022, NJAB-ja ka kryer shtatë auditime**:

1. Auditimi i Procesit të Shpenzimeve në Administratën Komunale, me përjashtim të Drejtorisë së Arsimit dhe Shëndetësisë, ku te këto drejtori kryhen auditime të veçanta (*auditim i vlerësuar me rrezikshmëri të lartë),*
2. Auditimi në Drejtorinë Komunale për Arsim (*auditim i vlerësuar me rrezikshmëri të mesme*).
3. Auditimi në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme (*auditim i vlerësuar me rrezikshmëri të mesme*),
4. Auditimi në Drejtorinë e Inspeksionit (*auditim i vlerësuar me rrezikshmëri të mesme*),
5. Auditimi me kërkesë të Kryetarit të Komunës, lidhur me disa furnizime në disa shkolla fillore dhe të mesme.
6. Auditimi në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (*auditim i vlerësuar me rrezikshmëri të mesme*) dhe
7. Auditimi në Zyrën e Prokurimit.

Në shtatë auditimet e kryera janë dhënë **21** rekomandime:
- pesë (5) rekomandime në auditimin e Procesit të Shpenzimeve,
- tri (3) rekomandime në auditimin e Drejtorisë Komunale të Arsimit,
- dy (2) rekomandime në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme,
- katër (4) rekomandime në Drejtorinë e Inspeksionit,
- një (1) rekomandim Drejtorisë Komunale të Arsimit lidhur me kryerjen e furnizimeve me vlerë nën 1000€),
- katër (4) rekomandime në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe
- dy (2) rekomandime në Zyrën e Prokurimit.

Prej 21 rekomandimeve të dhëna, katër rekomandime kanë qenë të përsëritura, kurse 17 rekomandime janë dhënë të reja.
Rekomandimet e përsëritura kanë qenë:
- një rekomandim nga auditimi i Procesit të Shpenzimeve,
- një rekomandim nga auditimi në drejtorinë e Inspeksionit,
- një rekomandim nga auditimi në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe
- një rekomandim nga auditimi në Zyrën e Prokurimit).

Pesë rekomandimet e dhëna në auditimin e kryer për **Procesin e Shpenzimeve në Administratën Komunale** kanë pasur të bëjnë me:
1. Aplikimin e programit E-Pasuria, si dhe për mbajtjen e një evidence të saktë në Sistemin E-pasuria nga ana e Zyrtarit kryesor për furnizim të komunës dhe nga ana e Zyrtares për Pasuri.
2. Rishikimin e arsyes së vazhdimit të zbatimit të kontratës për marrjen me qira të një objekti për nevoja të Komunës, apo edhe mundësinë e shkëputjes së saj (*Kontrata nr.02-501 datë 05.07.2021 - Për marrjen me qira të një objekti për nevoja të Komunës*).
3. Angazhimin e të gjithë drejtorëve të drejtorive komunale, menaxhmentit të Zyrës së Prokurimit dhe menaxherët e kontratave që në të ardhmen të rrisin angazhimet e tyre në mbikëqyrjen e realizimit të kontratave kornizë për ofrimin e shërbimeve të ndryshme në aspektin kohor, sasior dhe financiar të përmbushjes së kontratave.
4. Raportimet e rregullta të përfituesve të subvencioneve mbi mënyrën e shpenzimit të mjeteve të përfituara si subvencion nga Komuna e Gjilanit.
5. Shqyrtimin e mundësive për rritjen e buxhetit të planifikuar dhe të rishikuar për realizimin e pagesave që kanë të bëjnë me shpronësimin e pronave (tokave) me interes për Komunën e Gjilanit.

**Tri** rekomandimet e dhëna në auditimin e kryer në **Drejtorinë Komunale të Arsimit** kanë pasur të bëjnë me:
1. Dorëzimin me kohë të mjeteve të inkasuara, si dhe për nevojën e mbylljes së bllokave të inkasimit, duke e bërë njëkohësisht edhe barazimin me mjetet e inkasuara dhe atyre të dorëzuara (ky rekomandim ka pasur të bëjë vetëm për SH.M.L. të ,,Arbërisë’’).
2. Sigurimin, se të gjitha plotësimet e vendeve të reja të punës dhe zëvendësimet, do të bëhen në bazueshmëri ligjore të parapara për zhvillimin e procedurave të rekrutimit, si dhe me plotësimin e vendeve të lira të punës për kohë të shkurtër, ku

Drejtoria Komunale e Arsimit duhet të krijoi një rregull (*kriter apo standard*), e cila do e rregulloi këtë fushë, duke eliminuar mundësinë e selektimit, apo të diskriminimit të ndonjë konkurruesi.

3. Respektimin e legjislacionit aktual në fuqi për të gjitha rastet e përzgjedhjes së kandidatëve të suksesshëm, qofshin ato pozita për drejtor/sha shkolle, zëvendësdrejtor/sha, apo pozita tjera të kuadrit arsimor.

Kurse nga auditimi i kryer me kërkesë të Kryetarit të Komunës lidhur me disa furnizime në disa shkolla fillore dhe të mesme, i është dhënë **një** rekomandim Menaxhmentit të Drejtorisë Komunale për Arsim, menaxhmenteve të të gjitha shkollave dhe menaxherëve të kontratave ku është kërkuar rritja e kontrollit të brendshëm për gjatë procesit të furnizimit dhe pranimit të materialit shpenzues, si dhe në baza periodike të bëjnë identifikimin dhe planifikimin e nevojave për furnizime me artikuj të ndryshëm.

**Dy** rekomandimet e dhëna në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme kanë pasur të bëjnë me

vendosjen e një pike të kontrollit të përhershëm lidhur me inkasimin dhe dorëzimin e të hyrave vetanake përmes sistemit (*intranetit*), si dhe lidhur me funksionimin Qendrës për Shërbim të Qytetarëve duke e bërë printimin e librit të protokollit për kërkesat nga sistemi i intranetit për çdo fund vit.

**Katër** rekomandime në Drejtorinë e Inspeksionit kanë pasur të bëjnë me rritjen e përgjegjësisë dhe efikasitetit të punës së inspektorëve të ndërtimit, me vazhdimësinë e procedurave inspektuese të filluara paraprakisht e për të vazhduar me inspektime pasuese, me krijimin e mundësive për angazhimin e inspektorit të shërbimeve publike dhe të ndërtimit, si dhe një rekomandim ka pasur të bëjë me një koordinim më të mirë të detyrave angazhuese të inspektorëve duke e mbajtur një evidencë të saktë me numrin e inspektimeve sipas subjekteve afariste, sipas objektivave inspektuese dhe masave të ndërmarra ndaj subjekteve afariste.

**Katër** rekomandimet e dhëna në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale kanë pasur të bëjnë me eliminimin e praktikës jo të mirë lidhur me vonesat e dorëzimit të mjeteve të inkasuara nga participimet e pacientëve, një rekomandim ka pasur të bëjë me sigurimin ligjor për pagesat e bëra në emër të pagave jubilare. Lidhur me këtë i është rekomanduar menaxhmentit që të kërkoi një Opinion ligjor nga Ministria e Shëndetësisë (si sponzorizuese e Kontratës Kolektive Sektoriale nr.01-05-3815 datë 12.06.2018 respektivisht neni 17), lidhur me të drejtën apo jo të pagesave të pagave jubilare për punëtorët që nuk e kanë përvojën 10, 20 apo 30 vjeçare vetëm në Institucionet shëndetësore.

Rekomandimi i tretë ka pasur të bëjë me krijimin e mekanizmave të nevojshëm për fillimin e aplikimit të programit E-Pasuria, përmes të cilit program bëhet menaxhimi i pasurisë komunale me vlerë deri në 1000€ dhe rekomandimi i fundit ka pasur të bëjë me vendosjen e një pike të kontrollit të përhershëm për kompensimin e pagave jubilare, aprovimin e pagesave për orët e mbajtura të kujdestarisë dhe orët e mbajtura jashtë orarit të rregullt të punës, tejkalimit të orëve të lejueshme përgjatë punës jashtë orarit të rregullt të punës, duke verifikuar të gjitha evidencat e gjeneruara për kujdestarit dhe orët e mbajtura jashtë orarit të rregullt të punës nga zyrtarët përkatës, me qëllim që shpenzimi i parasë publike të jetë në përputhshmëri me legjislacionin aktual në fuqi.

**Dy** rekomandimet e dhëna nga auditimi në Zyrën e Prokurimit, kanë pasur të bëjnë me dorëzimin me kohë të kërkesave nga Njësitë Shpenzuese për nevojat e tyre të ndryshme të prokurimit si ato për punë, furnizime dhe shërbime, ashtu që Zyra e Prokurimit të hartojë me kohë planin e prokurimit për vitin fiskalë dhe të njëjtin ta dorëzojnë në autoritetin qendror të prokurimit publik bazuar në legjislacionin në fuqi, si dhe rritjen e bashkëpunimit me Organin mbikëqyrës dhe menaxherët e projekteve për projekte të investimeve kapitale lidhur me kryerjen e projekteve brenda afateve të parapara me kontratë.

**Zbatueshmëria e rekomandimeve të dhëna, do të sjellë efekte pozitive:**

- në fushën e menaxhimit të parasë publike gjatë proceseve të shpenzimeve, racionalizimit të shpenzimeve dhe arsyeshmërisë së shpenzimeve të krijuara,
- në procesin e furnizimeve me vlerë nën 1000€ dhe aplikimit të programit E-Pasuria,
- në raportimin e mënyrës së shpenzimeve të mjeteve të përfituara si subvencion nga gjithë përfituesit e subvencioneve,

- në uljen e obligimeve të cilat janë krijuar nga shpronësimet e paluajtshmerive.
- në zbatueshmërinë ligjore të procesit të të hyrave në Drejtorinë Komunale të Arsimit dhe në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme,
- në rritjen e efikasitetit të shërbimit të inspektorëve duke përmirësuar imazhin e këtij institucioni,
- menaxhimin e drejtë të parasë publike nga ana e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,
- në përgatitjen e planit të prokurimit në harmoni me nevojat e Njësive Shpenzuese dhe në kryerjen e projekteve brenda afateve të parapara me kontratë si dhe
- në përmirësimin e kontrollit të brendshëm në drejtoritë e audituara, me ç`rast kishte me u përmirësuar edhe performanca e qeverisjes komunale.

**Aktivitetet e tjera të cilat janë planifikuar ose janë realizuar për zhvillimin e auditimit të**

**brendshëm në kuadër të Komunës (shkurtimisht):**

- Në fillim të vitit 2022 janë përgatitur dy Raporte të punës së NJAB-së, raporti për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2021 dhe Raporti Vjetor i NJAB-së për vitin 2021.
- Janë mbajtur dy takime me Komitetin e Auditimit (me 09.02.2022 dhe me 02.07.2022), ku në takimin e parë është bërë shqyrtimi i Raportit për gjashtëmujorin e dytë, Raporti Vjetor i NJAB-së për vitin 2021 dhe aktiviteteve tjera të NJAB-së, kurse në takimin e dytë është bërë shqyrtimi i Raportit të NJAB-së për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022 (janë shqyrtuar pesë Raporte të auditimeve veç e veç).
- Drejtori i NJAB-së ka ndihmuar Komisionin për plotësimin e Pyetësorit të vet-vlerësimit për Menaxhim Financiar dhe Kontroll.
  Lidhur me punën e këtij Komisioni dhe rishikimin e Pyetësorit me 06.04.2022 kemi bërë një Informatë për Kryetarin e Komunës dhe Komitetin e Auditimit.
- Gjithashtu, NJAB-ja ka pasur angazhime lidhur me verifikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna nga auditori i Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe auditori i brendshëm. Për të gjeturat lidhur me zbatueshmërinë e rekomandimeve janë përgatitur Raporte të cilat i janë dorëzuar Kryetarit të Komunës, Komitetit të Auditimit dhe Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
- Drejtori i NJAB-së ka prezantuar në një Tryezë diskutimi për fuqizimin e auditimit të brendshëm dhe Komitetin e Auditimit, organizuar nga DEMOSI Zviceran. Pjesëmarrës kanë qenë auditorët e komunave të regjionit të Gjilanit.
- Drejtori i NJAB-së ka bërë një Prezantim (me sllajde) para të gjithë drejtorëve të Drejtorive Komunale lidhur me rolin dhe funksionimin e NJAB-së në kuadër të strukturës organizative të Komunës. Në këtë prezantim, ka prezantuar Kryetari dhe N. Kryetarja e Komunës, dy anëtaret e Komitetit të Auditimit si dhe dy auditorët e NJAB-së.
- Kemi pasur disa konsulta me auditorët e ZKA-së gjatë periudhës sa ata kanë qenë duke audituar.
- Kam përcjellë pjesërisht seancat e K.K.Gjilan, ku për rend të ditës kanë qenë tema që kanë qenë të nevojshme për punët audituese (*si Raporti i Pasqyrave Financiare për vitin 2021, bartja e disa mjeteve financiare nëpër kode tjera, si dhe Raporti financiare periodike të vitit 2022, ndryshimi, apo shfuqizimi i ndonjë Vendimi etj*).
- Kemi pasur angazhime lidhur me analizimin e gjendjes momentale të projektit të Stadiumit të Qytetit,
- Në muajin Qershor 2022, është bërë monitorimi i aktiviteteve të auditimit të brendshëm të NJAB-së nga Njësia Qendrore për Harmonizim të Auditimit të Brendshëm, e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Vlerësimi i përgjithshëm ka qenë, se nga 13 fusha të vlerësimit, vetëm një fushë është vlerësuar me pajtueshmëri të pjesshme (*që nënkupton se ka hapësirë për përmirësim*), kurse 12 fushat e tjera janë vlerësuar me pajtueshmëri të përgjithshme (*e që nënkuptohet si vlerësim më i lartë në aspektin pozitiv*).
- Me pjesëmarrje në dy takime drejtori i NJAB-së ka ndihmuar grupin punues për verifikimin dhe raportimin e gjendjes së zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit gjatë auditimit të pasqyrave vjetore financiare për vitin 2021.
- Drejtori i NJAB-së ,ka pasur takime konsultative me ekipin e auditorëve të Zyrës Kombëtare të Auditimit, lidhur me aktivitetet audituese të kryera gjatë vitit 2022 (deri me 30.09.2022).

- Është filluar me grumbullimin e informatave për përgatitjen e Planit Strategjik të NJAB-së për vitet 2023-2025 dhe Planit Vjetor për vitin 2023.
- Gjithashtu kemi pasur aktivitete lidhur me ofrimin e ndihmave profesionale të vazhdueshme për disa Drejtori Komunale që kanë shfaqur interesim dhe nevojë.

**3.Sfidat:**

Sfidë kryesore ka qenë realizimi i Planit Vjetor, përkundër angazhimeve të tjera, si dhe duke i shtuar objektivat audituese në auditimet e kryera në Drejtorinë Komunale të Arsimit, në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme, në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Gjithashtu me rishikimin e Planit Vjetor për vitin 2022 ku është anuluar një auditim, kurse janë shtuar dy auditime tjera në dy Ndërmarrje Publike Lokale me pronësi të plotë të Komunës (NPL"Stacioni i Autobusëve dhe NPL"Tregu").

**4. Punët kryesore në vazhdim:**

Jemi në përfundim të auditimit në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, gjegjësisht në Sektorin e Tatimit në Pronë, kurse auditimi në Ndërmarrjen Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" është në fazën e përgatitjes së Draft Raportit.

Deri në përfundim të këtij viti synimet tona sipas Planit vjetor janë që përveç dy auditimeve në proces të kryhet edhe Auditimi për Menaxhimin e Pasurisë Komunale, auditimi në Ndërmarrjen Publike Lokale "Tregu" dhe auditimi i verifikimit të zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna në auditimet e kryera gjatë vitit 2022 (përfundimi i këtij auditimi duhet të bëhet deri me 15 janar të vitit 2023, kur edhe është afati i dorëzimit të Raportit Vjetor të NJAB-së për vitin 2022.

Gjithashtu deri me 31 dhjetor NJAB-ja, duhet të dorëzoi në Njësinë Qendrore për Harmonizim të Auditimit të Brendshëm (NJQHAB) në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve Planin Strategjik të NJAB-së për vitet 2023-2025 dhe Planin Vjetor për vitin 2023, por paraprakisht këto Plane, do të shqyrtohen nga Komiteti i Auditimit.

Pra tremujori i katërt do jetë mjaft sfidues për realizimin e synimeve tona të parapara me Planin Vjetor të NJAB-së për vitin 2022.

## VI. Zyra Ligjore

Aktivitetet në kuadër të Zyrës ligjore

1. Projekt - kontratë/marrëveshje mirëkuptimi, ndryshimi dhe plotësimi i tyre-73
2. Vendime të hartuara, ndryshimi dhe plotësimi i tyre-284
3. Përgjigje në shkresa/kërkesa/ankesa -9
4. Qarkore ligjore-/
5. Opinione ligjore-7
6. Konsultime/këshilla ligjore-juridike-36
7. Shkresa/njoftime dërguar organeve dhe institucioneve lokale dhe qendrore - 12
8. Urdhëresa të hartuara -5
9. Debate/Dëgjime publike për akte të ndryshme-/2

**Dokumente të lekturuara**:

Në kuadër të Zyrës ligjore janë kontrolluar 439 faqe, gjegjësisht 275 dokumente të ndryshme.

## VII. Zyra për Informim

Zyra për Informim përbën një segment të rëndësishëm brenda qeverisjes komunale, sepse kujdeset që përmes informacioneve ditore, raporteve, njoftimeve e publikimeve të tjera, të realizojë transparencën e pushtetit kundrejt publikut, i cili ka të drejtë të plotë të njihet me punën e të zgjedhurve të vetë.

Gjatë këtij nëntëmujori, Zyra ka përgatitur dhe shpërndarë mbi 300 informacione ditore nga aktiviteti i kryetarit të Komunës, aktiviteti i drejtorive, Kuvendi dhe komitetet si dhe trupat e mekanizmat tjerë komunalë.

Mosfunksionimi i rregullt i web faqeve zyrtare të komunave, shkaku i problemeve në serverin qendror, disa prej materialeve janë publikuar me vonesë, pasi që qasja në administrim ka qenë e pamundur me ditë të tëra dhe vazhdon edhe tani.

Në web faqe, pos informacioneve ditore janë publikuar edhe mbi 550 materiale të tjera, si vendime të kryetarit të Komunës, vendime të Kuvendit Komunal, rregullore,

raporte, procesverbale, konkurse e njoftime për dëgjime publike, për seanca të Kuvendit dhe aktivitete të tjera.
Po ashtu, Zyra ka vazhduar të mbajë kontakte të rregullta me mediat qendrore dhe lokale.

## VIII. Zyra Komunale për Integrime Evropiane

Zyra Komunale për Integrime Evropiane gjatë periudhës janar-shtator 2022,0 ka zhvilluar një varg aktivitetesh që dalin nga obligimet dhe përgjegjësitë e saja.
Ky raport përfshinë aktivitetet dhe rezultatet e punës së kryer në një hark kohor prej nëntë muajsh, gjatë vitit 2022.
Në këtë periudhë të raportimit, ZKIE është angazhuar në detyrat dhe përgjegjësitë e zyrës përfshirë këtu komunikimin e rregullt me Kabinetin e kryetarit të Komunës, Ministrinë e linjës dhe institucionet tjera që ndërlidhen me funksionimin sipas detyrave ditore, si dhe me akterët tjerë relevantë në realizimin e punëve dhe përgjegjësive që dalin në kuadër të ZKIE.
Gjatë kësaj periudhe të punës, fokus kryesor ka qenë raportimi në kuadër të Matricës lidhur me obligimet e Komunës nga agjenda Evropiane, për të cilën kemi raportuar me kohë dhe kemi nxjerrë sfidat me të cilat ballafaqohet Komuna e Gjilanit në këtë rrafsh. ZKIE e ka njoftuar kryetarin e Komunës, drejtoritë, zyrat dhe njësitë lidhur me të gjitha sfidat, një pjesë e të cilave në kohë rekorde janë përmbushur, në kuadër të obligimeve të Komunës që dalin nga agjenda Evropiane.
Gjatë kësaj periudhe të punës, ZKIE-në e ka vizituar Komisioni Parlamentar për Integrime Evropiane i Kuvendit të Republikës, i cili është njoftuar në detaje mbi të arriturat, sfidat dhe problemet me të cilat ballafaqohet komuna jonë.
Ndërkohë, në muajin mars udhëheqësi i ZKIE, ka qëndruar për vizitë studimore tre ditore në Republikën e Shqipërisë, në kuadër të "Dialogut të Komunave Evropiane", nën organizimin e Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGI).
Gjatë muajit mars, me ftesë të Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGI), ZKIE nëpërmjet udhëheqësit të saj, ka marrë pjesë në Konferencën "Forumi i Qeverisjes Lokale në Ballkanin Perëndimor".
Gjithashtu, po në muajin mars, me ftesë së Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) është mbajtur takimi i Kolegjiumit të Zyrtarëve për Integrime Evropiane, ku janë diskutuar sfidat e zyrtarëve komunalë për integrime evropiane.
Udhëheqësi i ZKIE, gjatë muajit maj, konkretisht në datat 14, 15 dhe 16 maj, në hotelin "AbiGreen" në Prevallë ka marr pjesë në "Punëtorinë Konsultative për Pjesëmarrje Publike" me zyrtarët komunal, për të identifikuar objektivat për pjesëmarrje publike dhe avancuar qasjen e institucioneve publike, në raport me pjesëmarrjen e qytetarëve në nivelin lokal e mbështetur nga Programi USAID Kontrata Sociale.
Në muajin korrik, ZKIE ka raportua në MAPL lidhur me obligimet e komunës që dalin nga Agjenda e Evropiane. (raportim periodik i ZKIE, dy herë brenda vitit)
Identifikimi i sfidave që dalin nga raportimi për Agjendën Evropiane, koordinimi i vazhdueshëm me Zyrën e Kryetarit, drejtoritë, njësitë dhe zyrat komunale lidhur me harmonizimin për eliminimin e sfidave që dalin nga Agjenda Evropiane.
Gjithashtu gjatë muajit shtator-tetor ZKIE, ka qenë e angazhuar në grupin punues për hartimin e planit-programit tre vjeçar për Banim Social.
Monitorimi i vazhdueshëm i seancave të Kuvendit Komunal,si dhe komiteteve, detyrë e përshkruar me vendin e punës, si dhe takimet e vazhdueshme me komisionin komunal për Riatdhesim në kuadër të kërkesave të qytetarëve të riatdhesuar në komunën e Gjilanit.

Udhëheqësi i ZKIE, është i ngarkuar edhe me këto detyra shtesë, të cilat i realizon në përputhje me përshkrimet në vendimet e kryetarit:

- Zyrtar kontaktues në Agjencinë Kundër Korrupsion
- Zyrtar kontaktues për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkufitar
- Anëtar i grupit punues për hartimin e Planit Lokal për Riintegrim
- Anëtar i Komisionit Komunal për Riintegrim
- Zyrtar ndërlidhës komunal për diasporën
- Zyrtar për mbrojtjen e të dhënave personale

Gjatë muajit janar, shkurt dhe mars, është bërë njoftimi i vazhdueshëm për zyrtarët e lartë publikë, si për ata që e kanë përfunduar mandatin, po ashtu edhe për ata të cilën kanë marrë detyra udhëheqëse. Po ashtu, gjatë muajit mars janë njoftuar të gjithë zyrtarët e lartë publikë për deklarimin e rregullt vjetor, ku përfshihen dhjetëra njoftime e takime informuese lidhur me mënyrën e deklarimit të pasurisë.

Ndërkohë në muajin qershor, me kërkesë të AKK-së, i kam dërguar regjistrin çdo zyrtari të lartë publik të Komunës së Gjilanit, (regjistri i është shpërndarë veç e veç secilit zyrtar të lartë publik), përgjegjës që të verifikoj regjistrin nëse ka ndryshime apo gabime teknike gjatë regjistrimit të formularit në Data bazë.
Ndërkaq, pas kërkesës së ZKIE, janë zhvilluar takime me drejtues në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, në Prishtinë e Gjilan, ku edhe janë konkretizuar detyrat e Komunës së Gjilanit për të marrë veprime për mos cenimin e privatësisë.
Në kuadër të detyrës shtesë, si Zyrtar kontaktues për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkufitar, me datë 31.05.2022,kam marr pjesë në punëtorinë "Bashkëpunimi Ndër komunal dhe Demokracia Lokale" e cila është mbajtur në Hotel "Astoria" në Gjilan. Qëllimi i punëtorisë ka qenë hartimi i "Koncept Dokumentit për Bashkëpunim Ndër komunal dhe Demokraci Lokale.
Misioni i Zyrës për integrime evropiane, është që në bashkëpunim me instancat përkatëse, lokale dhe qendrore, të mbështesë Komunën në arritjen e standardeve evropiane dhe përmbushjen e obligimeve të dala nga dokumentet strategjike nacionale për integrim evropian si dhe të koordinojë të gjithë çështjet lokale të procesit të integrimit evropian, përmes respektimit të praktikave dhe rregullave të përcaktuara nga BE-ja.

## IX. Zyra për Komunitete dhe Kthim

**Aktivitetet e punës në komunitet:**

- Stafi i ZKK-së si dhe përfaqësuesit e komunitetit rom në koordinim me stafin e OSBE-së organizuan një takim me znj. Elizabeth Gowing – Këshilltare për Politikat në Komunitet të organizuar në ambientet e Qendrës Arsimore në "Abdulla Preshevë" ku ishin të pranishëm edhe stafi i OSBE-së edhe anëtarët e komunitetitku kishin për qëllim fushën e mbrojtjes sociale, punësimin, kthimin, dokumentacionin personal dhe pasuror, si dhe problemin e bursave dhe nostrifikimi i diplomave dhe certifikatave.
- Takim me anëtarë të komunitetit rom lidhur me organizimin e festimit të 8 Prillit, Ditës Ndërkombëtare të Romëve.
- Shkrimi i një projekti për festimet e 8 prillit, të Ditës Ndërkombëtare të Romëve me një agjendë aktivitetesh
- Realizimi i projektit më 8 prill, Ditën Ndërkombëtare të Romëve, duke luajtur ndeshje futbolli të mbyllur, ku mori pjesë edhe një ekip i përbërë nga punëtorë të komunës me Kryetarin.
- Takim me A.T. lidhur me rregullimin e dokumentacionit personal dhe pasuror të pjesëtarëve të komunitetit rom
- Asistencë me shkrim kërkesat dhe ankesat pranë qendrës për punë sociale për anëtarët e komunitetit rom, të cilët janë të përjashtuar në mënyrë të pajustifikueshme nga fara e kujdesit social.
- Ndarja e pakove ushqimore në bashkëpunim me një anëtar të komisionit për anëtarë të cenuar të komunitetit rom, asistence nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale.
- Takim me stafin e OJQ-së "Sy me Sy" për organizimin e trajnimit për nxënësit e shkollave të mesme anëtarë të komunitetit rom lidhur me trajtimin psiko-social.Trajnim i zhvilluar në ambientet e Shkollës Ekonomike .
- Ndihma në zhvillimin e planit vjetor të punës me Kryesuesin e komitetit për komunitete, të gjitha aktivitetet e planifikuara janë në përputhje me pozitën aktuale të komuniteteve në komunën tonë.
- Koordinimi me stafin e IOM-it, për projektet e stabilizimit të komunitetit, përzgjedhja e përfituesve të mundshëm, si dhe caktimi i një personi kontaktues që do të punojë në projekte të tilla me stafin e IOM-it.
- Katër projekt propozime për stabilizimin e komunitetit janë nënshkruar me stafin e IOM-it, të cilat do të shpërblehen pas zgjidhjes nga stafi i IOM-it në nivel qendror të organizatës.
- Ne i jemi përgjigjur 31 kërkesave nga Gjykata Themelore për informata për vendbanimin e adresës së tyre aktuale për pjesëtarët e komunitetit rom, serb të cilët kanë kontest për pronën e tyre.
- Në takimin me stafin e FSK-së, për konkursin për kadet, u shqyrtua mundësia e informimit të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë për kushtet e konkursit dhe vendin e vijimit të shkollave jashtë Kosovës.
- Kemi lëshuar 4 vërtetime për nacionalitetin turk, për qëllim për regjistrimin në fakultet apo punësim.
- Konsultimet me një anëtar të komitetit për komunitete nga komuniteti rom për asistencë të mundshme në materiale ndërtimore përmes MKK-së, për familjet në

nevojë sociale, për fat të keq kërkesa është pranuar nga MKK-ja por nuk munde të realizohet për shkak të mungesës së buxhetit. këtë qëllimi.

- Takimi me nënkryetarin për komunitete lidhur me angazhimin për vendimin e emërimit të një zyrtari i cili do të jetë përgjegjës për data baze, regjistrimin e te zhvendosurve, përgatitja për dokumentet e nevojshme për aplikim në procesin e kthimit si dhe konsultimi për formimin e komisionit komunal për kthim sipas urdhëresës nga rregullorja 01/2018 dhe këshillat nga stafi i MKK.
- Asistencë për lëshimin e certifikatave të lindjes dhe vendbanimit të pjesëtarëve të komunitetit rom që ndodhen aktualisht jashtë shtetit nëpërmjet administratës dhe personelit të zyrës së gjendjes civile.
- Konsultimet dhe takimet me kryesuesin e komisionit për komunitete për planet dhe aktivitetet e mëtutjeshme në punën e ZKKK dhe Komitetin për Komunitete lidhur me aktivitetet e planifikuara sipas planit vjetor të punës së komitetit për komunitete.
- Pjesëmarrja në trajnim 3-ditor të organizuar nga RYCO-Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor (Zyra Rajonale për Bashkëpunim) me temën Ndërtimi i Paqes, lehtësimi i pajtimit dhe dialogut ndërkulturor.
- Lëshimi i certifikatës së përkatësisë kombëtare për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë për nevojën e regjistrimit në fakultet apo në punësim etj.
- Ndihmë në zgjidhjen e kërkesave për anëtarët e komunitetit Rom, si dhe ofrimin e informacionit se si të aplikoni për pension invalidor, ndihmë në plotësimin e kërkesave, si dhe përgatitjen e gjetjeve dhe raporteve mjekësore, si dhe listat e lirimit nga institucionet ku është kryer trajtimi.
- Shpërndarja e projektit për pjesëtarët e komunitetit serb në projektet për stabilizimin e komuniteteve në fshatin Shillovë. Projekti është Instrumenti muzikor përmes organizatës IOM.
- Pjesëmarrja në takimin buxhetor të K.K Gjilan me qytetarë nga komunitetet jo shumicë, nga të pranishmit janë dhënë rekomandime dhe projekt propozime, në pyetjet lidhur me buxhetin janë përgjigjur zyrtar nga Zyra për Buxhet dhe Financa, si dhe kryetari i Kuvendit dhe drejtori i Bujqësisë.
- Konsultimet dhe takimi me stafin e A.T. (Avancing-Together)-Advancing Together, lidhur me projektet e vogla për komunitetin që do të financohen nga UMNIK, është caktuar personi kontaktues për këtë projekt nga ZKKK, i cili do të koordinojë punën e ekipit që u formua nga Kryetari i Komunës së Gjilanit.
- Takim me stafin e FSK-se, njohje me konkursin për pranimin e kadetëve. Nga ana jonë ka një dëshirë të madhe për të ndihmuar në fushatë. Postera me mbishkrimin e mënyrës së aplikimit dhe datës, aplikacionet shfaqen në vende të dukshme në fshatrat e komunitetit jo shumicë si dhe në ambientet e ZKKK-së.
- Të pranishmit në mbledhjen e komisionit për komunitete iu prezantua një raport shtatë mujor për punën e ZKKK.
- Takim me stafin e A.T. (Përparojmë-Së bashku)-Të përparojmë së bashku, për mungesën e këshillave të fshatrave që nevojiten për zbatimin e projektit për komunitetet. Nga ana jonë është sugjeruar që këshillat e fshatit dhe përfaqësuesit e këshillit të fshatit nuk janë emëruar ende dhe se ZKKK nuk ka autoritet për të emëruar komitetet e fshatrave, por do të informojë Kryetarin e Komunës për të caktuar një grup punues për projektet e komunitetit.
- Takim me stafin e OSECE-së lidhur me hartën sociale të strukturës së popullsisë në komunitetin rom, e cila do t'u referohet më shumë pjesëtarëve të komunitetit rom.
- Kërkesave të Gjykatës iu dhanë përgjigje lidhur me adresën aktuale të vendbanimit të qytetarëve të komunës sonë të cilët janë të zhvendosur dhe që ndodhen jashtë territorit të Kosovës dhe të cilët aktualisht janë duke iu nënshtruar procedurave për zgjidhjen e kontesteve pronësore.

**Raporti për periudhën e punës së ZKKK-së sipas segmenteve dhe përgjegjësive dhe kompetencave të përcaktuara me rregulloren 01/2018 MKK.**

**Aktivitetet e punës në procesin e kthimit të qëndrueshëm:**

- Puna në terren me stafin e AT (përparim-së bashku) lidhur me çështjet e procesit të integrimit të tyre pas kthimit për komunitetet dhe kthimin.
- Shkëmbim i informatave me stafin e MKK-së për prioritetin e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim me qëllim të vazhdimit të mandatit të Komisionit Komunal për Kthim.

- Koordinimi dhe shkëmbimi i informacionit me personelin e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për një vendim që do të nënshkruhet nga Kryetari i Komunës për emërimin e një zyrtari në zyre që të jetë përgjegjës për bashkë themelimin dhe krijimin e bazës së të dhënave të familjeve të kthyera të zhvendosura në ish-RSFJ.
- Shkëmbim informacioni me stafin e AT (përparim-së bashku) lidhur me detyrimin për të hartuar një Plan Veprimi Komunal për kthim.
- Shkëmbim i informatave me Zëvendësministrin për Kthim lidhur me tri ( 3) rastet me prioritet të ndërtimit të shtëpive (dy familje rome dhe një serbe) të cilat janë po ashtu prioritare, dy në rrugën “Abdullah Presheva” të Gjilanit dhe në fshatin Ponesh.
- Organizimi i tanishëm i takimit me përfaqësuesit e UNHCR-së, UNMIK-ut, OSBE-së, A, T. Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale lidhur me kthimin dhe mundësinë e ndarjes së tokës komunale për familjet e kthyera.
- Takimi i organizuar me stafin e OSBE-së -shkëmbim informacioni për familjet rome të kthyera që janë në listën prioritare dhe MKK-ja, e të cilave nuk dëshiron të financojë ndërtimin e shtëpive-të dhënat do të jenë në dispozicion të Ambasadorit të OSBE-së për një takim me Zëvendësministrin për Komunitetet dhe Kthim.
- Takim me A.T. shkëmbim informacioni për gjendjen aktuale të familjes nga radhët e komunitetit rom, e cila është në listën e prioriteteve.
- Puna me palët nga procesi i kthimit - aplikimi për kthim, aplikimi nuk plotësohet, pritet koordinim i mëtutjeshëm i partnerëve të kthyer, si dhe caktimi i punëtorëve për regjistrimin e familjeve të kthyera dhe menaxhimin e data bazës së të dhënave.
- Koordinim me stafin e Sekretariatin të Komunës për pikat nga statuti i Komunës me plotësime dhe ndryshime, të cilat do të përfshihen në vendimin për emërimin e një punëtori nga ZKKK për monitorimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave të të kthyerve dhe regjistrimin e familjeve kujdestare në sistemin elektronik të të dhënave.
- Koordinim me stafin e Zyrës së Kryetarit për përzgjedhjen e personit kontaktues për projektin “Stabilizimi i Komuniteteve” përmes “Organizatës IOM”
- Informimi dhe ndihma lidhur me strehimin e përkohshëm të një familje të komunitetit rom në një shtëpi të braktisur në vendbanimin “Avdulla Preshevë” dhe Elez Agushi, në pritje të financimit të ndërtimit të shtëpisë nga MKK, sepse kjo familje është një  prioritet i Komunës dhe prej shumë vitesh presin ndërtimin e shtëpisë.
- Takimi me familjet që kanë nevojë të ndërtojnë shtëpi nga MKK - të dhëna për trajtimin aktual të kërkesave të tyre në konsultim me stafin e MKK-së, zëvendësministrin për komunitete dhe kthim. Informacioni që morëm nga MKK është se miratimi i ministrit të MKK-së, pritet nisur me ndihmën e dy familjeve rome dhe një serbe, të cilat janë në prioritet.
- Takim me stafin e A.T. (Përparojmë-Së bashku)-Të përparojmë së bashku për të organizuar një takim me pjesëtarët e komunitetit rom për të dhënë informacion për mënyrën e lëshimit të dokumenteve personale dhe pronësore si dhe mënyrën e aplikimit për letërnjoftim të përkohshëm të Kosovës.
- Punohet lista e familjeve të kthyera të projektit të kthimit për nevojat e A.T. Përparojmë-Së bashku
- Takim me stafin e A.T. (Përparojmë-Së bashku)-Të avancojmë së bashku dhe ndihmën juridike falas për të ndihmuar anëtarët e komunitetit rom që të rregullojnë të drejtat në lidhje me apelimet ose çështjet gjyqësore.

**Raporti për periudhën e punës së ZKKK-së sipas segmenteve dhe përgjegjësive dhe kompetencave të përcaktuara sipas rregullores 22/2020 MPB.**

**Aktivitetet e punës në procesin e ripranimit:**

- Organizimi dhe koordinimi me kryesuesin e KKR për mbledhjen e komisionit për shqyrtimin e rasteve nga komisioni.

- Dorëzimi i ftesave me e-mail për anëtarët e komisionit për mbledhjen, shqyrtimi i rastit - kërkesë për rinovim të shtëpisë familjes, anëtari i së cilës është invalid i vuajtur nga pasojat e paralizës cerebrale.
- Takimi OKR - kërkesë për renovim të shtëpisë së familjes së kthyer nga Franca - kërkohet renovimi i banjos, ndërtimi i shtegut për invalidët si dhe riparime

kozmetike në dhoma, po ashtu në paketimin e ushqimeve dhe higjienës si dhe druve të zjarrit dhe trajtimit mjekësor.

- Koordinim me koordinatorin rajonal dhe kryetarin e Komisionit Komunal për Riintegrim me stafin e urbanistikës për nevojat e anëtarëve të pikave nga udhëzimi administrativ për ndërtimin dhe lëshimin e lejes së ndërtimit për personat me nevoja të veçanta.
- Asistencë dhe ndihmë për personat nga ripranimi, rekomandim për koordinatorin rajonal për paketën ushqimore dhe higjienike.
- Asistencë dhe ndihmë për personat nga ripranimi, rekomandim për koordinatorin rajonal për pako ushqimore dhe higjienike për personat me nevoja të veçanta.
- Puna për përgatitjen e të dhënave statistikore për numrin e mbledhjeve të komisioneve dhe numrin e kërkesave për periudhën 2015-2022 për nevojat e Kryetarit të KKR-së. Nga të dhënat statistikore më së shumti kanë qenë kërkesa për akomodim.
- Koordinimi me stafin e IOM-it për projektet e stabilizimit të komunitetit, përzgjedhja e përfituesve të mundshëm, si dhe caktimi i një personi kontaktues që do të punojë në projekte të tilla me stafin e IOM-it.
- Ndihma për tri familje në pakon ushqimore dhe higjienike - me kërkesë dhe rekomandim të ZKKK-së për ndihmë, Rekomandime dhe një grup kërkesash të dorëzuara përmes koordinatorit rajonal në departamentin për riintegrim.
- Në këtë periudhë raportuese, të gjitha aktivitetet që lidhen me procesin e riintegrimit apo riatdhesimit janë në përputhje me Rregulloren aktuale 22/2020 “Të drejtat dhe kriteret për ndihmë” të Ministrisë së punëve të brendshme.
  Në terren kanë qenë edhe zyrtarë të ZKKK-së, me komisionin e Qendrës për Punë Sociale dhe koordinatorin e MPB-së kemi vizituar tri (3) familje. Qëllimi i vizitës ishte përcaktimi i kushteve dhe nevojave si dhe kushteve të banimit. Ne asistuam në ndihmën e paketave dimërore (1) familje, pakove ushqimore tri (3) familjeve dhe rinovimin e shtëpisë së një (1) familjeje. të gjithë anëtarët e komunitetit shqiptar u kthyen nga procesi i ripranimit.
  Përveç aktiviteteve të mësipërme, ne jemi në kontakt të vazhdueshëm me personat e riatdhesuar dhe u ofrojmë të gjitha shërbimet e parashikuara nga Rregullorja.
- Në bashkëpunim me organizatën ndërkombëtare GIZ, kemi punuar në ofrimin e ndihmës në aplikimin për grand për të kthyerit nga programi i riatdhesimit. Një nga kushtet më të rëndësishme për aplikimin për ndihmë është që personi duhet të jetë i regjistruar në sistemin e MPB-së dhe kjo vërtetohet me një certifikatë të lëshuar nga stafi i ZKKK-së.
- Ne mbajtëm një (1) takim me Caritasin e Zvicrës ku pamë një mundësi për të ndihmuar me rregulloret dhe segmentet e përfitimit sipas rregullores 20/2022. Ne ndamë mendime dhe sugjerime që organizata të mbajë një trajnim të mbajtur në restorantin Astoria me zyrtarët e ZKKK.
- Koordinim me stafin e Zyrës së Kryetarit për zgjedhjen e personit kontaktues për projektin “MARDI” për ri integrimin e qytetarëve të kthyer nga ripranimi si dhe të diasporës në organizatë përmes Caritas-it të Zvicrës.
- Pjesëmarrja në trajnimin për rregulloret dhe udhëzimet administrative për trajtimin e të huajve të organizuar nga Ministria e Brendshme, UNHCR, CRP/K.
- Përgatitja e kërkesave nga procesi i ripranimit, renovimi i shtëpisë, ushqimi, ilaçet, akomodimi, pjesët e mobileve, të futura në sistemin elektronik (SMR) për përgatitje dhe ndihmë të mëtejshme.
- Punë në terren, vizita në familjet e kthyera nga procesi i ripranimit, rishikim i plotë i nevojave për rinovim të një shtëpie për një person me aftësi të kufizuar të kthyer nga Franca.
- Takim me drejtorin dhe ekipin juridik të Administratës për Kadastër, Urbanizëm dhe Banim lidhur me vlerësimin e punëve për renovimin e shtëpisë, me kërkesë të Ministrisë së Planifikimit Hapësinor.
- Regjistrimi i personave të ri adresuar në sistemin elektronik (SMR) të kthyer nga procesi i ripranimit dhe të cilët nuk janë kthyer përmes aeroportit në Prishtinë, por përmes pikave alternative kufitare të Kosovës, me ndërprerjen e azilit të dhënë nga autoritetet kompetente të shtetit jashtë vendit. Familjet e tilla kanë edhe dokument udhëtimi (Dokument udhëtimi) të lëshuar nga përfaqësuesit kompetent konsullor të Kosovës.
- Puna në terren me koordinatoren rajonale të MPB-DRPRIH në fshatin Debëlldeh-KK-Viti, ku ka qëndruar në shtëpinë e prindërve pas kthimit nga Suedia.

- Koordinatorit Rajonal të MPB-DRPRIH-së i janë dhënë rekomandime me shkrim nga ZKKK që familjet e kthyera të ndihmohen si nevojë urgjente në ushqim, barna, dru zjarri si dhe pako higjienike.
- Është organizuar takim me organizatën CHF (Caritas Zviceran) në projektin MARDI për treguesit e mundshëm në projekt, përgatitjen e planeve vjetore për riintegrimin e qytetarëve të kthyer nga procesi i ripranimit.
- Pjesëmarrja në një sesion trajnimi përmes CHF (Caritas Zviceran) me temën OJQ-organizatat që ofrojnë ndihmë për personat e kthyer nga procesi i ripranimit.
- Konsultimet me stafin e Administratës Shëndetësore si dhe me administratën e Qendrës për Punë Sociale lidhur me ndihmën për familjet e kthyera nga procesi i ripranimit.
- Puna në terren me koordinatorin rajonal të MPB-DRPRIH, lidhur me vazhdimin e akomodimit për familjet që i përkasin grupit të rrezikuar, të cilat do të financohen nga MPB-DRPRIH.
- Koordinim me kabinetin e presidentit lidhur me vendimin për strehimin e familjeve të kthyera nga procesi i ripranimit.
- Koordinim me Koordinatorin Rajonal të MPB-DRPRIH, lidhur me verifikimin e personave të larguar nga procesi i ripranimit, të cilët nuk janë regjistruar në sistemin elektronik (SMR) dhe të cilët janë dëbuar me forcë nga vendet azilkërkuese.
- Puna ne terren me zyrtarët të ZKKK-së, së bashku me komisionin e Qendrës për punë sociale dhe koordinatorin e MPB-së, vizituam tri familje. Qëllimi i vizitës ishte përcaktimi i kushteve dhe nevojave si dhe kushteve të banimit. Ne ndihmuam (1) familje, në pako ushqimore, pjesëtarë të komunitetit shqiptar të kthyer nga procesi i ripranimit.
- Komisioni Komunal është Komisioni i Riintegrimit ka mbajtur 5 takime dhe shqyrtoi 5 ( pesë ) kërkesa janë miratuar,0
- katër (4) kërkesa për akomodim dhe një kërkesë për renovim të shtëpive të destinuara për personat me nevoja të veçanta).
- Përveç aktiviteteve të mësipërme, ne jemi në kontakt të vazhdueshëm me personat e riatdhesuar dhe u ofrojmë të gjitha shërbimet e parashikuara nga Rregullorja 22/2020
- Në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare GIZ, UNDP, kemi punuar në ofrimin e ndihmës në aplikimin për grante për të kthyerit nga programi i riatdhesimit. Një nga kushtet më të rëndësishme për aplikimin për ndihmë është që personi të jetë i regjistruar në sistemin e MPB- dhe kjo vërtetohet me një vërtetim të lëshuar nga stafi i ZKKK-së.

## Të dhëna statistikore:

•Të dhënat nga Baza Qendrore e të Dhënave të Ministrisë së Brendshme për personat nga programi i riatdhesimit për periudhën 01.01. - 30.06.2022.

| Shteti | Vendi | Data e kthimit | Komuna | Data e largimit | Mënyra e kthimit | Familja | Individuale | M | F | Fëmijët |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Franca | **Gjilan** | **23.03.2022** | **Gjilan** | **08.01.2013** | **Vullnetar** | ✓ | / | 1 | 0 | 0 |
| Franca | **Gjilan** | **03.03.2022** | **Gjilan** | **27.08.2021** | **Vullnetar** | / | ✓ | 2 | 1 | 0 |
| Franca | **Gjilan** | **18.01.2022** | **Gjilan** | **14.12.2014** | **Vullnetar** | / | ✓ | 1 | 0 | 0 |
| Zvicra | **Gjilan** | **10.02.2022** | **Gjilan** | **0.0.2015** | **Me dhunë** | / | ✓ | 1 | 0 | 0 |
| Gjermania | **Gnjilan** | **26.04.2022** | **Gjilan** | **00.05.1995** | **Me dhunë** | / | ✓ | 0 | 3 | 2 |
| Të gjitha: | / | / | / | / | / | **1** | **4** | 5 | 4 | 2 |

## X. Zyra e Avokatit

- Padi kundër Komunës -279,
- Aktgjykime– aktvendime të gjykatës themelore - 842,
- Aktgjykime – aktvendime të gjykatës së Apelit -250,
- Aktgjykime – aktvendime -penale- 6,
- Aktgjykime – aktvendime të gjykatës Supreme – 10,
- Aktgjykime – aktvendime të gjykatës Komerciale -3,
- Pranimi i thirrjeve për seancë – 702,
- Ankesa palës- 70,
- Fjalë përfundimtare – 9,
- Konkluzion –konstatim – 16,
- Njoftime – 18,
- Parashtresa të palëve – 84,
- Përgjigje në ankesë të palëve – 294,
- Ekspertiza – 20,
- Procesverbale – 26,
- Propozim për përmbarim palës – 150,
- Urdhër – 8,
- Revizion i palës -4,
- Ftesa për ndërmjetësim – 6,
- Kundërshtim – prapësim të palës – 2,
- Ankesë kundër shumës së kompensimit – 2.

**Aktivitetet e zyrës:**

- Seanca gjyqësore në çështje juridike të ndryshme - 941,
- Përgjigje në padi - 279,
- Fjalë përfundimtare - 12,
- Ankesa - 537,
- Përgjigje në Ankesë - 11,
- Kundërshtime / Prapësime – 24 ,
- Parashtresa - 69,
- Kërkesa - njoftime drejtorive (email) – 136,
- Propozim për përmbarim -2,

**- Gjithsejtë aktivitete -4,812**

**Sfidat:**

Sfidat për vitin 2022 po i paraqesim si në vijim;

- Numri i madh i lëndëve gjyqësore në raport me Komunën.
- zgjidhja e çështjeve të shpronësimeve që kanë ndodhur para lufte dhe pas lufte.
- Hapja e rrugëve të ndryshme, pa përfunduar shpronësimet dhe pa u bë bartja e tyre në emër të Komunës.
- Përpos kompensimeve për shpronësime, palët në gjykatë po kërkojmë edhe kamatën ligjore dhe kompensimet për avokatë, të gjitha këto e rëndojnë buxhetin e komunës.
- Problem i vazhdueshëm mbeten kërkesat-paditë e ndryshme nga çështja e arsimit të cilat rrjedhin nga Kontratat Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017 si dhe të datës

21.01.2021, siç janë : paga jubilare, kompensimi i shpenzimeve të ushqimit, udhëtimit, diferenca në pagë në të ardhura personal , inflacioni në pagë, kompensimi për klasë të kombinuara si dhe paga e 13 e cila parashihet tash me kontratën e re të datës 22.01.2021, ku në lidhje me këtë është me rëndësi të ju njoftojmë se shumica prej këtyre kërkesave-padive po vendosen në favor të paditësve, sepse një të drejtë të tillë po ja mundësojnë Kontratat e lartcekura.

- Problem në vete në vazhdim paraqiten në gjykatë edhe kërkesat sa i përket kompensimeve për dëmin e pretenduar se ju është shkaktuar palëve të ndryshme kontraktuese në raport me komunën si autoritet publik, për mos zbatim të kontratave apo zbatim të pjesshëm të tyre.
- Gjithashtu sfidë tjetër është numri i madhe i seancave gjyqësore në lidhje me mësimdhënësit, e që në mungesë të përfaqësuesit ligjor të njëjtat përfaqësohen nga zyrtarët e zyrës e që të njëjtit për pos kësaj duhet të merren edhe me punët në zyre.

# Komuna e Gjilanit

Opstina Gnjilane – Municipality of Gjilan

*Komuna – Opstina – Municipality*

Zyra e Kryetarit